

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave ekonomike

Viti XV

2021

Shkodër, 2021

REDAKSIA

Prof. as. dr. Fatbardha Molla (kryeredaktore)
Dr. Ylvije Kraja (sekretare shkencore)
Prof. dr. Arjeta Troshani, prof. as. dr. Albana Begani,
prof. as. dr. Blerta Dragusha, prof.as.dr.Elidiana Bashi,
prof. as. dr. Mirjam Dibra (anëtarë)

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Korrektori dhe punoi në kompjuter:

Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e shkencave ekonomike
Tel fax: 00355 22800651

PASQYRA E LËNDËS

Alba BERBERI, Xhesika PEMAJ

Impakti i Covid -19 mbi aktivitetin e biznesit

Impact of Covid-19 on business activity.....5

Fatbardha MOLLA (BEQIRI), Samina ZAGANI

Roli i kapitalit punues dhe analiza e likuiditetit në njësitë ekonomike shqiptare

The role of working capital and liquidity analysis in Albanian economic units.19

Rudin BEKA

Si mund t'i përdorim hidrocentralet si atraksione turistike: rast studimi kaskada e Drinit

How can i USE hydro power plants as tourist attractions: case study Drin cascade.....31

Albana BUSHATI, Emirjeta BEJLERI

Ndikimi i vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kënaqësinë e punonjësve në administratën shtetërore

The impact of evaluation and self-evaluation on employee satisfaction in the state administration.....41

Xhovana NIKOLLAJ, Fatbardha MOLLA (BEQIRI)

Aplikimi i teknologjisë informative në kontabilitet

Application of information technology in accounting.....53

Fatjon MLLOJA, Sabrina KUÇI

Banesa e Pashko Vasës si pjesë e trashëgimisë kulturore materiale e qytetit Shkodër

Pashko Vasa apartment as a part of material cultural heritage of Shkodra.....71

Liljana ULAJ

Vlerësimi i performances së kompanive farmaceutike shqiptare përmes raporteve financiare

Assessment of the performance of Albanian pharmaceutical companies through financial reports.....89

Aurora KINKA (PULTI), Estela LLESHI

Emigracioni dhe ndikimi i remitancave në zhvillimin ekonomik të vendit

Immigration and the impact of remittances on the economic development of the country.....107

Kleida TUFİ HETA, Gersa RUQI

Kriptomonedhat në Shqipëri njohja dhe përdorimi i monedhave dixhitale në vendin tonë

Cryptocurrencies in Albania awareness and usage of digital currencies in our country.....125

IMPAKTI I COVID-19 MBI AKTIVITETIN E BIZNESIT

Alba Berberi,¹ Xhesika Pemaj²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Administrim – Biznesit,
Unioni Lezha*

ABSTRAKT

Biznesi është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kriza e pandemisë globale e cila erdhi si pasojë e COVID-19. Ajo ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e shitjeve dhe në operimin e biznesit në Shqipëri, duke rritur pasigurinë tek konsumatori si dhe duke ulur ndjeshëm nivelin e shitjeve.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është evidentimi i impaktit të Covid-19 në aktivitetin e disa bizneseve në vend. Për përmbushjen e këtij qëllimi është realizuar një pyetësor dhe shpërndarë online në disa biznese që operojnë në vend.

Rezultatet kanë treguar se Covid-19 ka patur një ndikim të rëndësishëm në operimin dhe në qëndrueshmërinë e biznesit, sidomos në drejtim të sigurimit të lëndës së parë dhe të porosive apo atë të shpërndarjes, nivelin e shitjeve, mënyrën e perceptimit të blerjeve fizikisht dhe atyre online etj.

Edhe pse kriza e pandemisë globale pati ndikimin e vet negativ, ajo ndikoi në mënyrë direkte në krijimin e një tendence të re drejt blerjeve online, sidomos pas daljes nga karantina. Tashmë tregtia online, shihet me bindje si e ardhmja e tregtisë në biznesin ndërkombëtar, pasi krijon mundësitë dhe avantazhet e blerjeve direkte, pa barriera fizike.

Ky studim është i kufizuar në një numër të vogël biznesesh të analizuara dhe mbështetet vetëm në një analizë përshkuese të tyre. Por, mund të shërbejë si një pikënisje për zgjerimin dhe thellimin e studimit, në mënyrë që të realizohet në të ardhmen një panoramë më e qartë e ndikimit të Covid-19 në aktivitetin e biznesit në vend.

Fjalë kyçe: Covid-19, aktiviteti i biznesit, niveli i shitjeve, perceptimi, tregtia online.

¹ Lektore pranë departamentit Administrim-Biznes, Fakulteti Ekonomik, Universiteti I Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

² Ekonomiste dhe administratore pranë Union Lezha, diplomuar në Master shkencor, pranë departamentit Administrim-Biznes.

Impact of covid – 19 on business activity***ABSTRACT***

COVID-19 has directly affected the business operations in Albania, increasing consumer uncertainty and significantly reducing the level of sales.

The main purpose of this study is to identify the impact of COVID-19 on the activity of several businesses in the country. To realize this goal, a questionnaire was conducted and distributed online to several businesses operating in the country.

The results showed that COVID-19 has had a significant impact on the operation and sustainability of businesses, especially in terms of raw material and orders' delivery; sales level; the way of perceiving purchases physically and online; etc.

Although the global pandemic crisis had its negative impact, it directly affected the emergence of a new trend towards online shopping, especially after quarantine. Online commerce is now seen with conviction as the future of commerce in international businesses as it creates opportunities and advantages of direct purchases, without physical barriers.

This study is limited to a small number of businesses analyzed and relies only on a descriptive analysis of them. But, it can serve as a starting point for deepening the study in the future. So, we can have later a clearer picture of COVID-19's impact on business activity in the country.

Key words: COVID-19, business activity, sales level, perception, online trade.

1. Hyrje

Impakti i Covid-19, siç tashmë dihet, nuk ka qenë shumë i madh vetëm në aspektin shëndetësor dhe në jetët e njerëzve, por gjithashtu impakti i tij në ekonomi ka qenë dhe vazhdon të jetë akoma i madh. Pikërisht, nisur nga diskutimet e panumërta mbi këtë çështje, nga studimet e muajve të fundit dhe kërkimet e bëra në fushën e ekonomisë, kanë përcaktuar krizën e Covid-19 si një prej krizave më të mëdha në histori. Ndër efektet e krizës përfshihet dhe impakti që ka pasur Covid-19 mbi biznesin në përgjithësi, ndryshimin e qasjes dhe të menduarit të blerjeve etj. Efekti është përhapur në shkallë të gjerë duke përfshirë edhe biznesin në Shqipëri. Shumë shitës kanë mbyllur përkohësisht dyqanet e tyre, ndoshta për t'i rihapur më vonë. Përveç kësaj, shitësit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë përballuar

me rënien e shitjeve, si pasojë e mungesës së klientëve. Të gjitha këto ndryshime kërkojnë kohë dhe studime specifike për të matur efektin e tyre në aspekte të ndryshme të jetës.

1.1 Kriza e Covid-19

Pjesa më e madhe e ekonomistëve mendojnë se kriza e Covid-19 është një goditje e dyfishtë negative, fillimisht e ofertës e më pas e kërkesës. Kjo krizë lidhet me një “faktor ekzogjen”, jashtë sistemit ekonomik, i cili provokoi një rënie të fortë të prodhimit të sipërmarrjeve dhe konsumit të familjeve dhe individëve. Kjo goditje e fortë e dyfishtë, e shumëfishuar nga izolimi i popullsisë dhe mbyllja e bizneseve, shpjegon dhe rënien brutale të aktivitetit ekonomik.

Në muajin mars 2020, në një artikull të saj mbi krizën e Covid-19, *The Economist* nënvizonte se “*nëse ekonomia do të bjerë në një black-out të zgjatur, dëmet ekonomike e financiare dhe paniku i madh, mund ta çojnë në një krizë ekonomiko-financiare më të rëndë se kriza e vitit 2008*” (Angjeli & Civici, 2020). Në këtë kontekst dhe në mungesë të masave të jashtëzakonshme e agresive të qeverive, bota do të përballet me një rënie të tregjeve dhe depresion të rëndë.

Në mjediset financiare dhe bankare, kriza e Covid-19, u cilësua si një ngjarje krejtësisht e paparashikuar dhe e panjohur, shkatërruese dhe e keqinterpretuar, të paktën në fillimet e shpërthimit të saj. U deshën disa javë që teoria e goditjes ekzogjene të lidhej me funksionimin e kapitalizmit financiar dhe globalizimin. Mjaft studiues evidentuan si fajtor për këtë krizë politikën neoliberalë, globalizimin pa limit dhe politikën publike të mangëta (Keneth, R., 2020).

Tashmë që kjo krizë është e evidente pothuajse në gjithë vendet e botës, të zhvilluara e të pazhvilluara, të pasura e të varfra, ekonomistët dhe shkencëtarët mendojnë se “*ajo është një krizë endogjene e sistemit tonë ekonomik e financiar, se nuk duhet të dyshojmë se ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet shumëfishimit të pandemive dhe defekteve të mëdha të sistemit tonë ekonomik, financiar e mjedisor*” (Angjeli & Civici, 2020).

Kriza e Covid-19, nuk duhet parë vetëm si një problem shëndetësor, por edhe si një problem ekonomik, financiar, ekologjik e social.

1.2 Impakti i Covid-19 mbi biznesin

Ndërkohë që qeveritë globalisht kanë ndërmarrë masa të ndryshme si kundërpërgjigje ndaj Covid-19, bizneset po i kundërpërgjigjen me shpejtësi këtyre ndryshimeve, që të jenë në gjendje t’u përgjigjen kërkesave të konsumatorëve dhe furnitorëve të tyre, në të njëjtën kohë që po përballen

me sfida të mëdha financiare dhe operacionale. Në çdo industri dhe vend gjeografik të prekur, është e vështirë që menjëherë të gjendet rruga drejt suksesit, jo vetëm në përballimin pa humbje financiare të situatës së karantinimit, por edhe në gjetjen e mënyrave dhe mundësive për të qëndruar në treg dhe pse jo për t'u përmirësuar" (Funk et al., 2009).

Ndikimi i Covid-19 ka qenë tepër i madh, me shtrirjen e tij në rang global dhe me shpalljen e Pandemisë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), ekonomia u paralizua përkohësisht si pasojë e masave imediate të marra nga shumë qeveri në botë. Megjithatë impakti mbi sistemin, eksperiencën, operacionet, shitjet, konsumatorët, zinxhirin e furnizimit, lidërshtimin, vendin e punës etj., kanë qenë disa prej diskutimeve të vazhdueshme dhe intensive të specialistëve.

Covid-19 po i shtyn kompanitë që të operojnë me shpejtësi në mënyra të reja dhe rezistenca e sistemeve po testohet si kurrë më parë. Impakti mbi vetë sistemin ka qenë i jashtëzakonshëm. Ndërsa bizneset mbledhin një varg përparësish dhe sfidash të reja të sistemeve, si: rreziqet e vazhdimësisë së biznesit; ndryshimet e papritura në vëllim; vendimmarrja në kohë reale; produktiviteti i fuqisë punëtore; rreziqet e sigurisë, të gjitha këto janë sinjale që udhëheqësit duhet të veprojnë shpejt për të adresuar çështjet e menjëhershme të rezistencës së sistemeve dhe të krijojnë një themel për të ardhmen (He, H. & Harris, L., 2020). Drejtuesit në industrinë e kimikateve, për shembull, po e njohin rezistencën si një faktor kryesor suksesi.

Drejtuesit e IT-ve dhe biznesit duhet të sigurojnë që organizatat e tyre të mund të vazhdojnë të veprojnë përmes kësaj përçarjeje të papritur duke adresuar shpejt stabilitetin e proceseve kritike të biznesit dhe sistemeve themelore (Craighead et al., 2020). Kjo nënkupton parandalimin e ndërprerjeve, zbutjen e ndikimit të tyre ose rikuperimin prej tyre.

1.3 Sfida e menjëhershme: Operimi në një realitet të ri

Kompanitë po veprojnë në një realitet të ri që shtrëngon shumë sistemin e tyre.

- Rreziqet e vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit, ndryshimet e turneve dhe orareve në pikat e shitjes, mungesën e disponueshmërisë së burimeve kritike dhe boshllëqet në protokollet e vazhdimësisë së biznesit" (Jaworski et al., 2020).
- Rritjet në vëllimet e transaksioneve (për shembull, për shkak të një zhvendosjeje nga blerja fizike në atë digjitale) ose rënies së shpejtë të kërkesës.

- Monitorimin, raportimin dhe marrjen e vendimeve me të dhëna në kohë reale për t'iu përgjigjur nevojave të afërta të biznesit në një mjedis dinamik.
- Sfidat e produktivitetit të fuqisë punëtore për shkak të punonjësve që punojnë në distancë, të lidhur me ndërlikohen dhe sigurinë.
- Rreziqet e sigurisë, përfshirë llogaritjen e aktorëve të këqij, të cilët në mënyrë të pashmangshme do të kërkojnë të përfitojnë nga individët dhe organizatat.

Tani është koha për të ndërmarrë veprime për të adresuar çështjet e rezistencës së sistemeve sot dhe të themelojmë bazat për të ardhmen (Jorda et al., 2020). Udhëheqësit e sotëm dhe ata që veprojnë me shpejtësi për të adresuar sfidën e menjëhershme do të kapërcejnë me sukses krizën dhe do të dalin më të fortë.

Covid-19 është ngjarja më e madhe globale dhe sfida e kohërave tona. Si e tillë, po ndryshon qëndrimet dhe sjelljet njerëzore sot dhe i detyron organizatat të përgjigjen. Sidoqoftë, nevoja për t'iu përgjigjur nuk do të përfundojë edhe kur kërcënimi intensiv i virusit të jëtë minimizuar.

Covid-19 ka ndryshuar përgjithmonë përvojën e të qenurit klient, punonjës, qytetar, njeri.

Çfarë do të ketë ndryshuar në mënyrën se si mendojmë? Si do të ndikojë kjo në mënyrën se si ne dizenjojmë, komunikojmë, ndërtojmë dhe drejtojmë përvojat që njerëzit kanë nevojë dhe duan? Përgjigjet e këtyre pyetjeve do të gjenden në mënyrën se si njerëzit reagojnë dhe si individët, familjet dhe grupet shoqërore gjejnë mënyra të reja për të jetuar (Barro et al., 2020).

2. Ndikimi i Covid-19 në biznesin vendas

Nisur nga sa më sipër qëllimi i këtij studimi është zbulimi dhe evidentimi i impaktit të pandemisë së Covid-19 mbi biznesin, duke pasur parasysh periudhën e izolimit dhe pas saj.

Nëse flasim për impakt negativ mbajmë parasysh: pushimin e sistemit; prishjen e zinxhirit të furnizimit apo shpërndarjes; krijimin e pasigurisë konsumatore mbi blerjet; krijimin e vështirësive të tjera operative dhe financiare; uljen e shitjeve etj. Për klientët, ndikimi më i menjëhershëm është frika, jo vetëm për shëndetin e tyre personal, por edhe për ndikimin ekonomik. Në kohë të tilla njerëzit krijojnë pasiguri jo vetëm në burimet financiare, por dhe në aftësinë blerëse.

2.1 Metodologjia e përdorur

Të dhënat parësore janë mbledhur përmes pyetësorit. Nga 80 biznese, të cilëve u është shpërndarë pyetësori, 55 prej tyre kanë kthyer përgjigje dhe kanë ndarë eksperiencat dhe mendimet e tyre mbi impaktin e shpalljes së pandemisë së Covid-19 në biznesin e tyre. Pra, pjesëmarrja ka rezultuar të jetë rreth 69 %. Periudha e zhvillimit të hulumtimit, i referohet periudhës kohore maj-qershor të vitit 2021.

Ky pyetësor është i strukturuar dhe përfshin dy seksione. Në seksionin e parë ka pyetje në lidhje me karakterin e biznesit dhe pozicionin në treg. Në seksionin e dytë ka pyetje specifike mbi impaktin që ka patur shpallja e pandemisë mbi biznesin, duke përfshirë gjithë hallkat e tij.

Për shkak të natyrës së këtij studimi dhe burimeve të disponueshme, disa faktorë kufizues duhet të merren parasysh në interpretimin e rezultateve të studimit. Kryesisht, në mesin e tyre, është numri i kufizuar i kampionit të popullatës së marrë në studim. Gjithashtu, përzgjedhja e kampionit ka qenë e rastësishme.


Faktorë të tjerë mjedisorë, siç janë mënyra personale e përballimit të situatave emergjente, stresi në punë etj., gjithashtu mund të kenë ndikuar në përgjigjet e subjekteve.

2.2 Analiza përshkruese e të dhënave

2.2.1 Të dhëna të përgjithshme

Përgjigjet e mëposhtme janë një panoramë e përgjithshme në lidhje me llojin e biznesit, numrin e punonjësve, pjesëmarrjen në tregun ndërkombëtar, promovimin online dhe shitjet online.

Figura 1. Shpërndarja sipas sektorëve kryesorë të integruar në biznes.



Nga grafiku shohim që sektori i shitjeve me pakicë dhe shumicë zë pjesën më të madhe me 33 % dhe teknologjia e informacionit ka një përqindje prej 25 %.





Figura 2. Shpërndarja sipas numrit të punonjësve me kohë të plotë.

Shohim nga grafiku se alternativa me treguesin më të lartë me 67 % është 1-4 punonjës, pasuar nga bizneset me 5-19 punonjës që zënë 17 %.

Figura 3. Shpërndarja sipas pjesëmarrjes në tregun ndërkombëtar.



Nga grafiku shohim se pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se biznesi ku ata punojnë blejnë dhe shesin brenda vedit me 42 %, përgjigjja në lidhje me pyetjen importojmë, por nuk eksportojmë zë 33 %, ndërsa përgjigjja në lidhje me pyetjen, eksportojmë, por nuk importojmë zë 8 %. Pjesa tjetër importonin dhe eksportonin në 17 % të përgjigjeve.

Figura 4. Shpërndarja sipas promovimit të biznesit përmes platformave online.




Nga grafiku shohim se 67% e aplikojnë promovimin e biznesit përmes platformave online, ndërsa në një përqindje më të vogël 33% përgjigjen negativisht.

Ndërsa, pyetjes nëse bizneset realizojnë shitje online, të gjithë të anketuarit 100 % bëjnë shitje përmes platformave online.

2.2.2 Të dhëna mbi impaktin e Covid-19 mbi biznesin

Fillimisht të anketuarit janë pyetur nëse situata nga Covid-19 u është dukur si diçka kalimtare apo një problem serioz për të ardhmen e biznesit.


Figura 5. Ndikimi i Covid-19 mbi aktivitetin e biznesit.



Nga përgjigjet e dhëna rezulton se është konsideruar një problem serioz, por jo një krizë, nga 52.5 % e të anketuarve. Vetëm 12.9 % e të anketuarve

janë shprehur se kjo është një krizë domethënëse e cila ka pasur një impakt mbi krejt sistemin, 27.7 % e të anketuarve janë përgjigjur që ky është një problem i vogël, ndërsa 6.9 % aspak problem.

Figura 6. Shpërndarja sipas tendencës së të ardhurave për muajt e izolimit.



Shohim nga grafiku se kryeson tendenca sipas parashikimeve me 41%. Pastaj shohim një tendencë lehtësisht nën parashikimet në 25 % të rasteve, dhe në përqindje pak më të vogël dhe të barabartë shohin tendencën në mënyrë të dukshme mbi parashikimet dhe lehtësisht mbi parashikime në 17% të rasteve.




Figura 7. Shpërndarja sipas ndikimit të pandemisë tek operacionet e biznesit.

Sic mund ta shohim në grafik pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se janë ndikuar relativisht shumë nga kjo situatë në 33% të të

anketuarve. Pjesa tjetër e të anketuarve shprehet se janë ndikuar mesatarisht dhe nuk janë ndikuar me rreth 25%. Ndërsa pjesa më e vogël shprehet se janë ndikuar pak me 17%.

Figura 8. Shpërndarja sipas mbylljes së përkohshme të biznesit.



Shohim se pjesa më e madhe, 67%, janë përgjigjur se biznesi ku ata punojnë nuk është mbyllur dhe 33 % të anketuarve shprehen se nuk e kanë vazhduar aktivitetin e tyre normalisht.

Shohim se përgjigjja nuk është mbyllur, kryeson me përqindjen më të lartë rreth 58%, më pak se 1 muaj në 25%. Kurse një përqindje e vogël rreth 8% dhe 9% janë shprehur se janë mbyllur për 2 muaj ose më shumë dhe 1 muaj ose më shumë.





Figura 9. Shpërndarja sipas vështirësisë së blerjes së inputeve dhe/ose shitjen e produkteve/shërbimeve.


Siç mund ta shohim nga grafiku 43% e të anketuarve janë shprehur se kanë pasur vështirësi për të aksesuar lëndën e parë. Kurse 23% janë shprehur se kanë pasur vështirësi në eksport dhe 9% ulje e shitjeve.

Figura 10. Shpërndarja sipas ndikimit të pandemisë në ndërmarrje.




Pjesa më e madhe e të anketuarve rreth 33% janë shprehur se biznesi ku punojnë është mbyllur përkohësisht dhe ka pasur klientë që nuk kanë paguar faturat e tyre.


Figura 11. Shpërndarja sipas strategjive të përdorura për të përballuar krizën.



Pjesa më e madhe rreth 60% kanë zgjedhur si strategji zhvillimin e shitjeve online, 20% janë përgjigjur se kanë reduktuar përkohësisht numrin e punonjësve, 14% e tyre kanë shtyrë kreditë bankare dhe po 6% kanë marrë ndihmë nga furnitorët.

Figura 12. Realizimi i punës nga shtëpia.

Të pyetur nëse gjatë kësaj kohe kanë punuar nga shtëpia, pjesa më e madhe me 58% janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 42% negativisht.

Figura 13. Shpërndarja sipas lehtësisë së aksesimit të informacionit dhe përfitimeve nga programet e NVM-së të lidhura me qeverinë.

Të pyetur nëse aksesimi i informacionit dhe përfitimeve nga programet e qeverisë, kanë qenë të lehtë për t'u arritur ata janë përgjigjur rreth 59% se ka qenë e vështirë dhe 25% normal.

Përfundime dhe rekomandime

Impakti i Covid-19 mbi biznesin ka qenë i thellë, jo vetëm për financat por gjithashtu dhe për mënyrën e operimit dhe operacionet, zinxhirin e furnizimit dhe mënyrën e përballjes me klientët. Përfundimet kryesore të studimit janë si më poshtë:

1. Pandemia globale nga COVID-19, ka ndikuar në mënyrë direkte në nivelin e shitjeve dhe në operimin e biznesit në Shqipëri, duke rritur pasigurinë tek konsumatori si dhe duke ulur ndjeshëm nivelin e shitjeve;
2. Biznesi është prekur dhe ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kriza e pandemisë globale;
3. Pandemia globale, ka ndikuar në mënyrë direkte në operimin dhe në qëndrueshmërinë e biznesit, sidomos në drejtim të sigurimit të lëndës së parë dhe të porosive;
4. Kriza nga pandemia globale, ndikoi në mënyrë direkte në krijimin e një marzhi të ri apo tendence të re drejt blerjeve online, sidomos pas daljes nga karantina;
5. Tregtia online, shihet si e ardhmja e tregtisë në biznesin ndërkombëtar, pasi krijon mundësitë dhe avantazhet e blerjeve direkte, pa barriera fizike.

Rekomandimet në raport me këtë studim janë:

Covid-19 po i shtyn kompanitë që të operojnë me shpejtësi në mënyra të reja, dhe rezistenca e sistemeve po testohet si kurrë më parë. Ndërsa bizneset mbledhin një varg përparësish dhe sfidash të reja të sistemeve rreziqet e vazhdimësisë së biznesit, ndryshimet e papritura në vëllim, vendimmarrja në kohë reale, produktiviteti i fuqisë punëtore, rreziqet e sigurisë, të gjitha këto bëjnë që udhëheqësit duhet të veprojnë shpejt për të adresuar çështjet e menjëhershme të rezistencës së sistemeve dhe të krijojnë një themel për të ardhmen.

1. Kompanitë duhet të kujdesen në drejtim të ofrimit të një marrëdhënieje të ndërveprimit me konsumatorët, për të garantuar në një masë të madhe, cilësinë e produkteve dhe shërbimeve;
2. Duhet të rritet kapaciteti i të mësuarit dhe i përshtatjes së bizneseve në mënyrë që përballja me emergjencat apo me situata të tilla me të cilat po përballemi të jetë më fleksibël, më e natyrshme, më e lehtë.

3. Është e nevojshme që bizneset të shohin përtej mundësive ekzistuese dhe të gjejnë hapësirat e nevojshme dhe mundësitë për kanalizimin e biznesit të tyre ose të ndërrojnë mënyrën me të cilën operojnë.

REFERENCA

- Angjeli, A dhe Civici, A. (2020), “Kriza ekonomike, në kohën e Koronavirusit: Shkaqet, Pasojat, reagimet”, Kristalina-KH, Tiranë, 2020.
- Bartik, A., Bertrand, M., Cullen, Z.O., Glaeser, E. L. Luca, M. and Stanton, C. (2020). The impact of COVID-19 on small business outcomes and expectations. Working Paper 20-102. Retrieved from: www.ssrn.com
- Barro, R. J., Ursúa, J. F. & Weng, J. (2020), The coronavirus and the great influenza pandemic: Lessons from the “Spanish flu” for the coronavirus’s potential effects on mortality and economic activity. (March 2020).
- Cacioppo J.T. & Hawkley, L.C. (2009) “Perceived social isolation and cognition”, *Trends in Cognitive Sciences*, 13 (10) (2009).
- Craighead, C. W Ketchen, D. J. & Darby, J. L (2020). Pandemics and supply chain management research: Toward a theoretical toolbox. *Decision Sciences*.
- Funk et al., (2009), “The spread of awareness and its impact on epidemic outbreaks”. *Proceedings of the National Academy of Sciences*, 106 (16) (2009).
- He, H & Harris, L. (2020), “The impact of the Covid-19 pandemic on corporate social responsibility and marketing philosophy”. *Journal of Business Research* (2020).
- Jaworski et al., (2020), “Market-driven versus driving markets”, *Journal of the Academy of Marketing Science*, 28 (1) (2000).
- Jorda et al., (2020) “Longer-run economic consequences of pandemics”, *National Bureau of Economic Research* (2020).
- Kenneth R., (2020) Deglobalization will hurt growth everywhere, *Project Syndicate*, Jun 3, 2020.
- Muritala, A. T., Awolaja, A. & Bako, Y.A. (2015). Impact of Small and Medium Enterprises on Economic Growth and Development *American Journal of Business and Management*.
- Ozili, P. & Arun, T. (2020). Spillover of COVID 19, impact on the global economy.
- World Bank (2020) - Tazeen FASIH, Harry A. PATRINOSM & Najeeb SHAFIQ - The impact of COVID-19 on labor market outcomes: Lessons from past economic crises; May 20, 2020.
- WHO (2020). Timeline of WHO’s response to COVID-19. *World Health Organization*. Retrieved from www.who.int

ROLI I KAPITALIT PUNUES DHE ANALIZA E LIKUIDITETIT NË NJËSITË EKONOMIKE SHQIPTARE

Fatbardha Molla (Beqiri)¹, Samina Zagani²

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Financë - Kontabilitet, BKT, Shkodër Shqipëri

ABSTRAKT

Arsyeja kryesore e ekzistencës së secilës firmë është maksimizimi i fitimit të saj dhe ofrimi i produkteve që klientët dëshirojnë vërtet. Për ta bërë këtë firma duhet të ndjekë një skemë shumë të mirë financiare. Niveli i parasë dhe likuiditetit është një përcaktues shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet e

¹ Pas mbarimit të studimeve në vitin 1993-1994 kam punuar në **Degën e Thesarit Shkodër si specialiste e të ardhurave .**

Në vitin 2004 e në vazhdim punoj si pedagoge e brendshme pranë këtij Universiteti, për lëndët Analize financiare (leksione e seminare), Financë publike (seminare), Kontabilitet bujqësor (leksione, seminare), Hyrje në financë (seminare).

Aktualisht po punoj me lëndët “Kontabilitet financiar”, “Kontabilitet financiar i avancuar”, “Parime të kontabilitetit”, “Analizë financiare” me leksione dhe seminare dhe gjithashtu kam përpiluar dhe programet e lëndëve të mësipërme. Pas vitit 2011 jam titullare e lëndëve: “Analizë e pasqyrave financiare“, “Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të Kontabilitetit“ në Master shkencor në Kontabilitet dhe “Analize kredie“ në Master profesional Financë – Bankë.

Gjatë vitit mësimor 2007-2008 dhe 2008-2009 kam punuar si pedagoge e jashtme pranë

Universitetit Bujqësor Tiranë në departamentin e Financë-Kontabilitetit në lëndët Kontabilitet i aplikuar dhe Bazat e kontabilitetit.

“**Doktor i shkencave Ekonomike dhe Agrobiznesit**” - 10 korrik 2009, pranë departamentit “Financë –Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor Tiranë.

Grada “Profesor i asociuar i shkencave ekonomike” – 4 korrik 2012. Financë – Kontabilitet, Universiteti Bujqësor Tiranë, Shqipëri.

Grada “Profesor” 12.04.2018, me numrin rendor 416. Financë – Kontabilitet, Universiteti Bujqësor Tiranë, Shqipëri.

Kam marrë pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe autore e shumë artikujve brenda dhe jashtë vendit.

² Master i shkencave në Kontabilitet në 2018-ën, Bachelor në Financë-Kontabilitet në 2016-ën pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. *BKT, Shkodër Shqipëri.*

tij me klientët, furnitorët, punonjësit, qeverinë dhe palë të tjera, të cilët janë të interesuar për firmën.

Kohët e fundit është vënë re se arsyeja kryesore e falimentimit të firmave të ndryshme është mungesa e likuiditetit në kohën e duhur dhe koherenca midis arkëtimeve dhe shpenzimeve.

Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë rëndësinë e likuiditetit për një firmë, si një përcaktues kryesor për ekzistencën e saj financiare. Unë synoj të realizoj edhe një analizë likuiditeti, duke studiuar kapitalin qarkullues për firma të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Kapitali qarkullues konsiderohet të jetë një pjesë shumë e rëndësishme e kapitalit operativ dhe është një nga treguesit më të rëndësishëm dhe më domethënës për analizën e likuiditetit për çdo firmë.

Fjalë kyçe: likuiditet, kapital qarkullues, pasqyrë e ndryshimit të gjendjes financiare, aktivitet investues, aktivitet financues.

The role of working capital and liquidity analysis in Albanian economic units

ABSTRACT

The main reason for existence of each firm is the maximization of its profit and the offering of products that clients really want. To do this, the firm should follow a very good financial scheme. The level of cash and liquidity is a very important determinant in its relationship with clients, suppliers, employees, government and others pairs, that are interested about the firm. Recently, it has been noticed that the main reason for bankruptcy of different firms is the absence of liquidity at the right time and the coherence between collections and expenses.

The purpose of this study is to present the importance of liquidity for a firm, as a main determinant for its financial existence. I aim to realise a liquidity analysis too, studying the working capital for different firms of Shkodra city. The working capital is considered to be a very important part of operating capital and it is one of the most important and significant indicator for the liquidity analysis for each firm.

Keywords: liquidity, working capital, the statement of change of the financial condition, investment activity, financing activity

Hyrje

Arsyeja kryesore e ekzistencës së çdo njësie ekonomike në treg është maksimizimi i fitimit dhe ofrimi i produkteve sipas kërkesave të klientëve, për realizimin e së cilës asaj i nevojitet ndjekja e një skeme të mirë financiare. Niveli i parave dhe likuiditetit në një firmë është një përcaktues kyç në marrëdhëniet e saj me klientët, furnitorët, punonjësit, shtetin dhe palët e treta të interesuara, për të bërë të mundur rritjen e përfitueshmërisë së saj. Kohët e fundit është vënë re se një nga arsyet kryesore të falimentimit të shumë kompanive në botë është mungesa e likuiditetit në kohën e duhur dhe koherenca mes arkëtimeve dhe shpenzimeve. Megjithëse përdorimi i likuiditeteve është relativ dhe varet nga qëllimet e firmës, lloji i aktivitetit që zhvillon si dhe nga kontrolli që firma dëshiron të mbajë mbi likuiditetin, menaxhimi i duhur i tij është një vlerë e shtuar për firmën.

Ky punim synon të paraqesë rëndësinë e likuiditetit në një njësi ekonomike si një pikë kyçe për mirëqenien financiare të saj. Gjithashtu synoj të realizoj një analizë të likuiditetit nëpërmjet studimit të kapitalit punues për firma të ndryshme në rajonin e Shkodrës. Ky i fundit konsiderohet si një pjesë shumë e rëndësishme e kapitalit operativ dhe është një nga treguesit më të rëndësishëm dhe domethënës të analizës së likuiditetit për çdo njësi ekonomike.

1. Roli i analizës së likuiditetit

Me anë të këtij punimi realizojmë një analizë të likuiditetit për një kampion të përbërë nga 10 njësi të sektorëve të ndryshëm të rajonit të Shkodrës, nëpërmjet ndërtimit të pasqyrës së ndryshimit të gjendjes financiare, e cila sipas kërkesave të SNK1³ “Pasqyrat Financiare: Paraqitja” kjo pasqyrë nuk është pjesë përbërëse e PF-ve të publikueshme për qëllime të përgjithshme, por përfshihet te shënimet shpjeguese që duhet të raportohet kur ndërtohen pasqyra financiare të detyrueshme. Qëllimi i ndërtimit është përcaktimi i ndryshimit të fluksit të kapitalit punues nga njëri vit në tjetrin dhe si lidhet ky rezultat me të ardhurën neto, aktivitetin investues dhe financues të njësisë. Rëndësia e kapitalit punues është vitale për ekzistencën dhe mbarëvajtjen e një njësie ekonomike, prandaj dhe ndërtimi i një pasqyre të tillë do t’u vinte në ndihmë drejtuesve /kontabilistëve dhe palëve të treta për të pasur një informacion më të plotë dhe të kompletuar mbi aktivitetin e njësisë ekonomike.


³ Dhamo. S (2000), Kontabiliteti i Avancuar, Tiranë.

Gjithashtu, me anë të intervistave, drejtuar kryesisht drejtuesve /kontabilistit të njësisë, synojmë të vlerësojmë sa të informuara janë këto firma rreth menaxhimit të kapitalit punues dhe politikave për mbajtjen e një niveli optimal të tij, pra synohet të kuptohet nëse këto firma ndjekin një strukturë apo politikë të caktuar lidhur me menaxhimin e kapitalit punues. Roli që ka likuiditeti në ecurinë financiare të njësive ekonomike është jashtëzakonisht i rëndësishëm duke pasur parasysh këtu faktin që mungesa e tij është vendimtare për shmangien e falimentimit të tyre apo pasojave të tjera po aq negative për vazhdimësinë e tyre. Meqenëse likuiditeti është një vlerë e shtuar për njësinë ekonomike, qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet ndërtimit të një pasqyre të re financiare (pasqyra e ndryshimit të fluksit të kapitalit punues), jo të detyrueshme për t'u publikuar nga ana e njësive ekonomike, të përcaktohet roli i kapitalit punues në analizën e likuiditetit për firmat e marra në studim. Gjithashtu rritja e interesit ndaj menaxhimit të likuiditetit dhe kapitalit punues do të marrë një vëmendje të veçantë në këtë punim. Në fund, nëpërmjet realizimit të intervistave me drejtuesit e firmave do të përcaktohet sa të informuar janë ato rreth kapitalit punues dhe nëse ndjekin politika/struktura konkrete për menaxhimin e tij.

2. Analiza e likuiditetit nëpërmjet raporteve dhe kapitalit punues raste praktike.

Janë marrë për studim 10 kompani të ndryshme në mënyrë rastësore të rajonit të Shkodrës, nga ku janë studiuar të dhënat e mëposhtme të harmonizuara me raportet e pasqyrës së ndryshimit të gjendjes financiare.

Grafiku: Mjaftueshmëria e kapitalit punues për sektorë të ndryshëm.
Viti 2016



Ndërsa, ashtu siç shihet nga grafiku për periudhën 2016, njësia që ka raportin me të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit punues është Kompleksi Turistik (sektori shërbimeve). Ky raport edhe pse është në nivele të larta, nuk është shumë i preferuar, pasi edhe pse tregon situatë likuiditeti të konsoliduar, nga ana tjetër tregon tepricë investimesh në aktive afatshkurtra të cilat nuk sjellin përfitueshmëri.

3. Pasqyra e ndryshimit të gjendjes financiare

Gjendja financiare e një njësie ekonomike raportohet nëpërmjet pasqyrave të saj financiare. Megjithatë, për një gjykim më të plotë të gjendjes financiare të njësisë, sidomos në lidhje me fondet dhe përdorimin e tyre këto pasqyra nuk janë të mjaftueshme. Pasqyra e ndryshimit të gjendjes financiare konsiderohet si *një pasqyrë e fondeve*⁴. Ajo pasqyron burimet dhe përdorimet e fondeve nga njësia ekonomike gjatë një periudhe kontabël. Njësia fillimisht ka nevojë për fonde për të kryer aktivitetin e saj operativ, fonde të cilat i siguron nga aktiviteti i saj operativ pra nga kapitali punues, huatë afatgjata, emetimi i letrave me vlerë të kapitalit etj.

Tabela 3 – Pasqyra e ndryshimit të gjendjes financiare.

<i>1- Fondet financiare janë siguruar nga :</i>	
a) Aktiviteti – Fitim/ humbje vitit	
b) Rezultate të jashtëzakonshme	
c) Burime të tjera	
Gjithsej fonde të siguruara	<input type="text"/>
<i>2 – Fondet financiare janë përdorur për :</i>	
a)Për blerjen e pajisjeve	
b).....etj	
Gjithsej fonde të përdorura	<input type="text"/>
<i>Ndryshimi në fluksim kapitalin punues</i>	
+/-	

Burimi: Dhamo. S, Kontabiliteti i Avancuar, faqe 225.

⁴ Dhamo. S, Kontabiliteti i Avancuar, Tiranë.

Analiza e likuiditetit nëpërmjet ndërtimit të pasqyrës së ndryshimit të gjendjes financiare (studimi i kapitalit punues) – Gjetje kërkimore
Studimi është bazuar në një mostër prej 10 njësive të sektorëve të ndryshëm në rajonin të Shkodrës, nga të cilat janë siguruar të gjitha pasqyrat financiare për një periudhë prej 5 vitesh 2012-2016, në mënyrë që të studiohet ecuria e kapitalit punues nga një vit në tjetrin dhe arsyet që kanë çuar në rritjen apo zvogëlimin e tij. Gjithashtu do të shohim nëse ky ndryshim pozitiv apo negativ ka lidhje me përfitueshmërinë e firmës dhe likuiditetin e saj. Kam marrë vetëm si rast sektorin e ndërtimit.


Sektori – Ndërtim⁵

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit punues	2013	2014	2015	2016
1- Fondet financiare janë siguruar nga:				
EAN	-2627563	139078	791910	737619
Shpenz. zhvlerësimi	29500	19750	33851	44100
	-2598063 (1)	158828 (1)	825761 (1)	781719 (1)
2- Fluksi i MM nga/përdorur në akt. Investues :				
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve.	0	0	0	0
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve.	0	0	0	0
Pagesa për blerjen e AAGJ .	0	0	0	0
Arkëtime nga shitja e AAGJ materiale.	0	0	0	0
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera.	0	0	0	0
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera.	0	0	0	0
Interes të arkëtuar.	0	0	0	0
	0 (2)	0 (2)	0 (2)	0 (2)
3- Fluksi i MM nga/përdorur në akt. financues :				
Arkëtime nga emetimi i	0	0	0	0
	0	0	0	0
	0	0	0	0

⁵ ROZAF 94.

kap.aksioner	0	0	0	0
Arkëtimi nga emetimi i aks të përd. si kolateral.				
Hua të arkëtuara.	0	0	0	0
Pagesa e kostove të transaks. që lidhen me kreditë dhe huatë.	0	0	0	0
Riblerje e aksioneve të veta.	0	0	0	0
Pagesa e aks. të përdorura si kolateral.	0	0	0	0
Pagesa e huave.				
TA nga huamarrja.				
Interes i paguar.				
Dividentë të paguar.				
	0 (3)	0 (3)	0 (3)	0 (3)
Ndryshimi në fluksin e kapitalit punues (1) + (2) + (3)	<u>-2598063</u>	<u>158828</u>	<u>825761</u>	<u>781719</u>

Grafiku - Ndryshimi në fluksin e kapitalit punues, EAN, Akt. Investues, Akt. Financues.




Burimi - Autori

Siç shihet nga grafiku dhe pasqyra e ndërtuar ndryshimi në kapitalin punues nga njëri vit në tjetrin ka lidhje të drejtpërdrejtë me të ardhurën neto (ndryshimi mes tyre është shumë i vogël). Për sektorin e ndërtimit dhe firmën e marrë në studim shohim që për një periudhë 5- vjeçare nuk ka as investime dhe as financime, që do të thotë, se fluksi i kapitalit punues është financiar totalisht nga e ardhura neto për vitin dhe shpenzimet e zhvlerësimit, të cilët ndonëse nuk janë flukse dalëse, përfaqësojnë në vetvete fond. Viti 2013 ka rezultat negativ me EAN = -2 627 563 lekë, dhe detyrimisht edhe fluksi i kapitalit punues është negativ për këtë vit. Rritja në fluksin e kapitalit punues për vitet e ardhshme siç shohim edhe nga pasqyra ka çuar në rritjen e të ardhurës neto.

Përfundimi: Kapitali punues është i lidhur direkt me Të Ardhurën Neto (përfitueshmërinë e firmës), ne rastin kur nuk kemi as financime apo investime.

Grafiku 9 - Ndryshimi në fluksin e kapitalit punues, EAN, Akt. Investues dhe Financues, agjenci turistike.



Burimi - Autori

Për subjektin me veprimtari kryesore agjenci turistike, kompleks turistik dhe këmbim valutor vëmë re se ndryshimi në fluksin e kapitalit punues ka ardhur kryesisht nga veprimtaria investuese e subjektit dhe ajo e financimit (burimet dhe përdorimet e fondeve). Për rastin në fjalë kapitali punues është financuar kryesisht nga aktiviteti financiar (meqenëse arkëtimi i të ardhurave nga huamarrjet afatgjata është më i madh se pagesat e ndryshme të akt.financues). Përshembull në vitin 2015 niveli negativ i kapitalit punues, që do të thotë jo vetëm mungesë likuiditeti, por ka çuar edhe në rënien e përfitueshmërisë, të ardhurës neto në nivele negative.

Nga intervistat e zhvilluara u vu re se shumica e drejtuesve të firmave nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur likuiditetit apo konkretisht kapitalit punues. Ata thjesht “punojnë” në rrjedhën e përditshme të biznesit, duke arkëtuar për shitjet me para në dorë dhe përdorin këto arkëtime për të mbuluar detyrimet e tyre afatshkurtra /afatgjata si dhe duke shmangur shitjet me arkëtim të mëvonshëm duke qenë se vonesat në mbledhjen e tyre janë ndër shkaktarët kryesorë të mungesës së likuiditetit.


Ndërsa në lidhje me llogaritë e pagueshme pothuajse të gjithë u shprehën që nuk kishin një politikë të mirëfilltë apo një strukturë të posaçme që ndiqnin për pagesën dhe planifikimin e tyre duke qenë se nuk mundën të përcaktojnë paraprakisht se si dhe kur do të bëhet pagesa e faturave të furnitorëve.

Gjithashtu, ajo çfarë u nxor në përfundim nga intervistat e realizuara në lidhje me çështjen nëse bizneset në fjalë i zbatojnë afatet e zbritjeve të shprehura në faturë, gjobat në rastet e pagesave të vonuara, është se asnjëra nga këto kompani nuk i zbatonte ato parimisht dhe praktikisht. Shumica e tyre operojnë sipas “mënyrës së tyre” duke pritur “pa afat” për shlyerjen e faturave nga ana e klientëve. Njëri nga bizneset e marra në studim “sektori – Tregtim karburanti, bar, hotel, restorant”, i cili ka treguesit më të këqij të kapitalit punues pohon se arsyeja e mungesës së likuiditetit vit pas viti është pikërisht mungesa në arkëtimin e klientëve nga njëra periudhë në tjetrën, duke e çuar kështu nivelin e kapitalit punues në vlera negative.

Gjithashtu njëra nga pyetjet e zhvilluara në intervista ishte lidhur më rëndësinë që drejtuesit e firmave u jepnin zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare dhe a planifikonin ato një shumë të paracaktuar /buxhet vjetor lidhur me to.

Përgjigjet e marra i kemi grupuar si më poshtë:

	Planifikimi vjetor i zërave më të rëndësishëm të PF-ve.	
	Subjekte të intervistuar	% e planifikimit
Cash	10	71%
Llogaritë e arkëtueshme	10	90 %
Llogari të pagueshme	10	63.2%
EAN	10	70.56%
Inventari	10	85.4%



Përgjigjet rreth planifikimit paraprak të një shume të përafërt vjetore të zërave më të rëndësishëm të pasqyrave financiare u siguruan nga të gjithë subjektet në studim. Ajo që u nxor në përfundim është se llogaritë e arkëtueshme janë zëri më i planifikueshëm dhe më “në dorë” i bizneseve. Kjo për arsye se ato mundohen të shmangin me sa të jetë e mundur shitjet me arkëtim të mëvonshëm ndërsa siç e shohim nga grafiku zëri me nivelin më të ulët të planifikimit janë llogaritë e pagueshme. “Pagesat e faturave” detyrimeve janë më pak të parashikueshme nga firmat për arsye se ato nuk mund të përcaktojnë me saktësi nivelin e likuiditetit që do të kenë në vitet

në vazhdim, ky i fundit shërben pikërisht për shlyerjen e llogarive të pagueshme.

Gjithashtu të pyetur për metodat që firmat përdorin për të menaxhuar kapitalin punues ato janë përgjigjur si më poshtë:

- Rëndësia kryesore bie mbi llogaritë e arkëtueshme, të pagueshme dhe inventarin, që do të thotë se pothuajse të gjitha firmat përcaktojnë afate dhe limite në lidhje me arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, pagimin e furnitorëve dhe mbajtjen e inventarit.
- Gjithashtu përcaktimi paraprakisht në nivelin e shitjeve që do të bëhen me arkëtim të mëvonshëm dhe ato me para në dorë.
- Përmirësimin e planifikimit, kontrollit të inventarit si dhe parashikimit të shitjeve.
- Përcaktimin e afateve limit për për pagimin e furnitorëve si dhe shumën minimale dhe atë maksimale të lejuar për mbajtjen e inventarit.
- Përcaktimin në bazë të llogaritjeve të ndryshme në çmimin e shitjes së produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga ato.

Konkluzione dhe rekomandime

Si përfundim, nga intervistat e realizuara, u nxor në konkluzion që firmat e marra në studim jo vetëm që nuk janë të informuara rreth kapitalit punues dhe menaxhimit të tij, por ato gjithashtu nuk ndjekin apo zbatojnë politika të mirëfillta për menaxhimit të tij.

Shumë probleme që lidhen me mungesën e likuiditetit, të cilat siç u studiuan edhe më lart nuk janë të pakta, kanë ardhur si pasojë e mungesës së menaxhimit të likuiditetit. Kjo ka sjellë vonesa në pagesën e furnitorëve, vonesa në shlyerjen e huave etj., dhe në qoftë se ky problem nuk merr vëmendjen e duhur, do të vazhdojë të çojë raportimin e një të ardhure neto më të ulët dhe të përkeqësuar ndër vite.

Duket që kapitali punues, likuiditeti dhe menaxhimi i tyre është diçka që teorikisht ekziston në politikën e këtyre firmave, por asnjëherë në realitet nuk gjen përdorimin që në të vërtetë duhet të ketë.

Njësitë ekonomike që operojnë në qytetin e Shkodrës, kryesisht ato të marra në studim nuk janë të informuara mbi kapitalin punues si dhe ato nuk ndjekin politika konkrete për menaxhimit të tij. Gjithashtu shumica prej tyre nuk ka një plan konkret për menaxhimit të hyrjes dhe daljes së parasë në kohën e duhur.

Pasqyra e ndryshimit të gjendjes financiare është një pasqyrë jo e detyrueshme për t'u publikuar, e cila paraqitet në shënimet shpjeguese, përdorimi i së cilës siguron informacion në lidhje me aktivitetin investues

dhe financiar të njësisë ekonomike dhe që tregon nëse njësia ka prodhuar ose jo fonde nga aktiviteti i saj gjatë periudhës kontabël.

Gjithashtu nga intervistat e realizuara kryesisht me drejtuesit e firmave u nxor në përfundim se arsyeja kryesore për mbajtjen e likuiditeteve është se ato shihen si mënyra më e mirë për të parandaluar mungesën e ardhshme të flukëse rrjedhëse të parasë dhe mbajtja e tyre rrallë ndodh për motive strategjike apo fitimprurëse.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm lidhet me ndërgjegjësimin nga ana e bizneseve rreth rolit që luan menaxhimi i likuiditeteve për ecurinë financiare të firmës. Mungesa e njohurive dhe e përvojës nga ana e tyre përbëjnë faktorin kryesor të mungesës dhe zhvillimit jo të mjaftueshëm të modeleve për drejtimin dhe menaxhimin e likuiditetit.

REFERENCA :

- Belt.B (1979), *Working capital policy and liquidity in the small business*, Journal of Small Business Management, 43, 1979.
- Charles Dickens, Mr. Mantalini in Nicholas Nicleby, ch. 17, p. 207 (1839).
- Dhamo. S (2005), *Kontabiliteti i Avancuar*, Tiranë.
- Erich A. Helfert “Techniques of financial analysis” 6th, Universal Book Stall, New Delhi 1989, p.22.
- Myers, S. C., 1984, *The capital structure puzzle*, Journal of Finance, 39, 575 -592.
- Keynes. J.M (1936), *The general theory of employment, In: Interest and Money*. Harcourt Brace, London.
- Hill.R.A, (2013), *Working Capital Management – Theory and Strategy (1th ed)*, Ventus Publishing ApS.
- Jan Lytheke – Jorgensen (February 2017), *Net Eörking Capital*, Implement Consulting Group, p.2-8.
- Saunders M., Lewis P. dhe Thornhill A (2007), *Research Methods for Business Students (4th ed)*, United Kingdom, Prentice Hall.
- Shuli. I dhe Perri. R (2008), *Analiza e Pasqyrave Financiare*, Tiranë, Albpaper.
- Tirole J., *The theory of corporate finance*, Princenton University Press, 2006.
- William J Baumol, James Tobin, 1989, *The optimal cash balance proposition: Maurizo Allais’ priority*, Journal Of Economic Literature, 1160 – 1162.
- QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit (www.qkr.gov.al)

SI MUND T'I PËRDORIM HIDROCENTRALET SI ATRAKSIONE TURISTIKE: RAST STUDIMI KASKADA E DRINIT

Rudin Beka¹

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Marketing-Turizmit

ABSTRAKT

Qëllimi – Në kaskadën e Drinit ndodhen tre nga hidrocentralet më me vlerë që Shqipëria ka, duke e bërë këtë një destinacion shumë të rëndësishëm ekonomik dhe industrial. Studimi aktual ndalet në identifikimin e mundësive për krijimin e produkteve inovative turistike që do të zhvillojnë ekonomikisht zonën dhe do ta kthenin atë nga një zonë të karakterit vetëm industriale në atë turistike.

Dizajni/metodologjia – Ky është një rast studimor mbi kaskadën e Drinit i fokusuar në punime teorike dhe praktike të mëparshme mbi turizmin industrial. Punimi bazohet në kërkimin primar me intervista me aktorët kryesorë të zonës dhe vizita në terren.

Gjetjet – Autorët propozojnë që kaskada e Drinit ofron një mundësi të jashtëzakonshme dhe jo të konkurrueshme për aplikimin e turizmit industrial me ture edukative dhe ato panoramike, për krijimin e turizmit natyror, atij rekreativ dhe mundësinë e aplikimit të turizmit sportiv.

Implikimet praktike – Konceptet dhe rekomandimet e studimit kanë mundësi të mira të aplikohen në praktikë, ku do t'i shërbejnë KESH, kompanive turistike në destinacion si dhe bashkisë së Vau të Dejës.

Origjinaliteti i punimit – Fusha e kërkimit të turizmit industrial nuk ka marrë vëmendjen e duhur në Shqipëri dhe ky studim është ndër të parët që adreson nevojën për të kuptuar më mirë rëndësinë e turizmit industrial dhe

¹ Dr. Rudin Beka është lektor pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Lëndët e mësimi që ai jep janë Marketing Shërbimesh, Komunikim i Integruar dhe Menaxhim Evenimentesh. Ai zotëron një doktoraturë në dizajnin ambiental dhe interesat kryesore të kërkimit fokusohen rreth fushës së impresionizmit të produktit, inovacionit në turizëm dhe simbolika e markës. Ka eksperiencë të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, është ideator start-upesh si dhe ka punuar për disa vite si konsulent marketingu për industrinë e turizmit dhe atë të ushqimit.

diversifikimin e produktit turistik nëpërmjet veprave të rëndësisë së veçantë siç janë hidrocentralet.

Fjalët kyçe – Turizëm industrial, turizëm rekreativ, turizëm edukativ, kaskada e Drinit.

How can i USE hydro power plants as tourist attractions: case study Drin cascade

ABSTRACT

Objective – In Drini cascade there are three hydropower with huge values, bringing this destination as an important one from an economical point of view. The actual study identifies the potential of industrial tourism, developing new and innovative products which could have an immense economic impact for locals, promoting the area not only from an industrial perspective, but also as a touristic destination.

Methodology – This is a case study, understanding the tourism potential of Drini cascade, focusing on theoretical previous studies and practical applications regarding industrial and modern tourism. Interviews and fields trips are the main research method used in the paper.

Findings – The author propose that the Drini cascade offer and enormous potential to develop industrial tourism, combining it with panoramic, sportive, educative, recreational, and natural tourism, making the destination a unique one in Albania.

Practical application – The paper can be used from KESH Albania and tourism agencies together with Vau Dejes municipality, in developing new and innovative tourism strategies to promote this destination.

Originality – There is a lack of studies in Albania for industrial tourism and this paper is the first one researching on the topic and addressing the need for product diversification and the importance of using hydropower as tourism destination.

Key words – Industrial tourism, recreative tourism, educative tourism, Drini cascade.

Hyrje

Turizmi është një fenomen social dhe ekonomik me impakt multidimensional në zhvillimin e rajonit. Me turizmin modern sot po shohim gjithnjë e më shumë zbulimin e destinacioneve të reja dhe eksperiencave unike. Kjo industri, përbën një nga fushat më me shumë rritje duke ia kaluar eksporteve të naftës, ushqimeve apo eksporteve të makinave në nivel global. Gjithashtu, turizmi po krijon mundësi të mëdha punësimi dhe zhvillimi në sektorë të ndryshëm duke u nisur që nga ndërtimi, bujqësia e deri tek telekomunikacioni. Në këtë aspekt, as Shqipëria nuk ka ngelur mbrapa, duke iu dhënë një prioritet shumë i madh si nga investitorët ashtu dhe nga aktorët e politikave strategjike.

Zhvillimi i turizmit në vendin tonë po fokusohet më shumë tek agroturizmi, turizmi malor dhe ai detar. Është interesante të studiohet se si mund të diversifikojmë zhvillimin e turizmit dhe në zona të reja, me produkte unike dhe fokus turizmin e eksperiencave. Në këtë drejtim, kaskada e Drinit, përbën një mundësi shumë të mirë për zhvillimin e turizmit, ku përfitimi do të ndihej ndjeshëm jo vetëm në zonën e Vaut të Dejës, por në të gjithë Veriun e Shqipërisë.

Objektivi i kërkimit

Punimi aktual është një rast studimor i karakterit praktik, ku vizitat në terren, diskutimet me palët e interesit dhe krijimi i një koncepti të ri turistik për kaskadën, janë qëllimi i këtij kërkimi. Më poshtë do të diskutohen format e ndryshme të zhvillimit të turizmit në këtë destinacion, duke patur si bazë turizmin industrial dhe duke u përqendruar në tri pikat si më poshtë:

- Si mund të zhvillohet në aspektin turistik kaskada e Drinit?
- A është turizmi industrial një produkt turistik që mund të bëhet bazë për tërheqjen e vizitorëve?
- Cili mund të jetë profili arkitekturor dhe ai turistik që përshtatet me zhvillimin e zonës?

Kaskada e Drinit

Drini është lumi më i gjatë në Shqipëri, me një gjatësi të degës kryesore 160 km ku shtrati i tij është shndërruar në një zinxhir rezervarësh artificialë duke përfshirë Fierzën, Komanin dhe Vaun e Dejës, të cilët furnizojnë me ujë tre hidrocentrale të mëdhenj të kaskadës. Vau i Dejës është hidrocentrali i parë i ndërtuar mbi lumin Drin dhe ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë. Ndërtimi i tij filloi në vitin 1967 dhe ishte

pjesërisht funksionues në vitin 1970 dhe plotësisht në 1975-ën, me një kapacitet 250MW. I dyti dhe më i sipërmi është hidrocentrali i Fierzës i cili ishte operativ në vitin 1978, i ndjekur nga hidrocentrali i Komanit në 1985-ën (KESH, 2015).

Por kjo zonë nuk njihet vetëm për hidrocentralet. Ajo ka një potencial të larmishëm natyror dhe me një biodiversitet të lartë mjedisor. lumi Drin është shumë i rëndësishëm edhe për ekonominë dhe jetesën e banorëve të zonës, ku sot është burim kryesor i gjenerimit të të ardhurave që vijnë nga energjia, akuakultura, peshkimi e turizmi (Aarhus, 2017). Nga numri i lartë i turistëve që po vizitojnë zonën në vitet e fundit, janë krijuar dhe destinacione të reja siç është lumi i Shalës me plazhet mahnitëse dhe natyrën e egër që ai afron.

Turizmi industrial

Turizmi industrial është krijuar si koncept rreth viteve 60-të, ku bota e zhvilluar pësoi një ndryshim rrënjësor ekonomik duke e kthyer atë nga një ekonomi me fokus në industrinë e rëndë në një ekonomi me fokus në të mirat fizike. Kjo solli mbylljen e bizneseve të shumta në fushën e tekstileve, minierave dhe ato të prodhimit të hekurit.

Në këto kushte, u krijua nevoja për t'i kthyer këto pika në destinacione të historisë dhe prodhimit, ku sot njihen me termin e “trashëgimisë industriale” (Hospers, 2002). Me kalimin e kohës dhe diversifikimin e agjencive turistike, filluan të krijoheshin ture të ndryshme për të sjellë turistë në këto ish- fabrika. Këtu lindi dhe koncepti i turizmit industrial, duke e kthyer industrinë e prodhimit industrial në një industri shërbimi turistik (Choe, Ling, Yen, Hwang, 2016). Benefitet e të krijuarit të një destinacioni me bazë turizmin industrial janë të shumta. Marrja e njohurive të reja, pjesëmarrja në aktivitete, rritja e ndërgjegjësimit të markës si dhe mundësia për të shitur produkte dhe shërbime inovative janë disa nga benefitet që krijohen nga zhvillimi i këtij turizmi (Mitchell & Orwig, 2002; Mcboyle, 1994). Nga ana tjetër, Otgaar (2012), analizon impaktin që kjo qoshe zhvillimi turizmi ka në destinacion duke sjellur turistë në zonë dhe duke rritur shpenzimet për turistë. Gjithashtu, edukimi i gjeneratave të reja për punën e madhe që kanë bërë brezat e mëparshëm, është një eksperiencë e veçantë nostalgjike dhe ndihmon të mbajmë gjallë të kaluarën siç është dhe rasti i krijimit të hidrocentraleve në kaskadën e Drinit që sot njihen si vepra të rëndësishme të veçantë.

Një nga modelet teorike interesante mbi impaktin e turizmit industrial është tabela më poshtë e punuar nga Lin (2019). Ai ka krijuar një sistem impakti që ka zhvillimi i kasaj kategorie të turizmit, ku e ka ndarë efektin në katër

shkallë. E para zhvillimi i turizmit industrial ndikon në rritjen e besimit të konsumatorit për produktin, e dyta ndikon në rritjen e imazhit të kompanisë dhe kuptimin e nevojave të konsumatorit, e treta lidhet me ndikimin që ajo ka në krijimin e eksperiencave unike dhe e mbyll me impaktin që turizmi industrial ka në edukim dhe mundësinë për të trashëguar historinë në brezat e ardhshëm. Më poshtë paraqitet tabela ku për efekt shkurtimi termi i Turizmit Industrial është zëvendësuar me TI.

Tabela.1 Përshkrimi i sistemit të eksperiencës në shërbimin e turizmit industrial.

Aspektet	Përshkrimi
1. Ekspozimi i Produkteve	
Tregimi i procesit të prodhimit	TI mund të rrisë besimin e konsumatorit duke i treguar procesin.
Paraqitja e produktit	TI mund të ambientojë shpejt konsumatorin me korporatën
Aplikime alternative	TI mund të plotësojë një nevojë ndryshe të një target grupi.
Verifikimi i materialeve	TI mund të rrisë besimin e konsumatorit duke treguar lëndën e parë.
2. Promocioni Marketing	
Përshkrimi i produktit	TI ndihmon konsumatorin të kuptojë shërbimin nga shpjegimi.
Ndarja e eksperiencës	TI ndihmon konsumatorin të ndajë eksperiencën me të tjerë.
Zgjerimi i shportës së produktit	TI mund të ndihmojë korporatën të kuptojë nevojat e konsumatorit.
Rritja e ndërgjegjësimit të markës	TI mund të rrisë imazhin e markës së kompanisë.
3. Eksperienca me Shërbimin	
Ndjesia e perceptimit	TI i jep mundësi konsumatorit të prekë vetë shërbimin.
Pjesëmarrja në proces	TI i jep mundësi konsumatorit të bëhet pjesë e prodhimit.
Eksperienca në terren	TI i jep mundësi konsumatorit të ndjekë direkt procesin.
Rritja e kreativitetit	TI i jep mundësi konsumatorit të rrisë kreativitetin e tradicionales.
4. Edukimi mbi Trashëgimin	
Transmetimi i njohurive	TI i rrit njohuritë konsumatorit për fusha të caktuara.
Trashëgimi artistike	TI ruan trashëgiminë e prodhimit artistik për gjeneratat e ardhshme.
Suport i komunitetit pritës	TI ndihmon në krijimin e një identiteti për zonën lokale.
Komunikimi kulturor	TI ndihmon në komunikimin e trashëgimisë kulturore.

burimi: Lin, 2019

Raste Studimi të zhvillimit të turizmit industrial

Muzeu i Energjisë, Danimarkë

Muzeu i ndërtuar në vitin 1920 është një destinacion i veçantë sidomos për familjarët dhe fëmijët. Turistët kanë mundësi të shohin dhomat e demonstrimit, të zhvillojnë aktivitete edukative apo konkurse mes shkollave.



dhoma e turbinave



dhoma e fëmijëve



dhoma e demonstrimit

burimi: <https://energimuseet.dk/>, gjetur me 04,2021

Muzeu i Energjisë Santral, Turqi

Muzeu i këtij hidrocentrali fokusohet në organizimin e panairëve, konferencave shkencore, trajnimeve si dhe shfaqje artistike duke e kthyer në një destinacion turistik ndryshe për zonën.



muzeu nga jashtë



zona e aktiviteteve



dhoma e kontrollit

burimi: <https://www.santralistanbul.org/>, gjetur me 04,2021

Muzeu i Energjisë EDF, Francë

Muzeu i ndërtuar në vitin 1985, ka si bazë kombinimin e artit me shkencën. Turistët kanë mundësi të shohin muzeun e historisë, piramidën e kohës, dhomën e pajisjeve dhe të realizojnë barbique në ambientet e jashtme.

muzeu nga jashtë



piramida e kohës



dhoma e demonstrimit



burimi: <https://www.musee-edf-hydrelec.com/> , gjetur me 04,2021

Krijimi i një destinacioni të ri turistik për kaskadën e Drinit

Zhvillimi i turizmit në kaskadën e Drinit është mëse i mundshëm duke përdorur si bazë turizmin industrial. Kjo kategori turizmi lidhet me krijimin e aktiviteteve atraktive në një fabrikë, park shkencor, objekt prodhimi apo destinacion tjetër i cili nuk ka qëllim primar turizmin. Në këtë kategori turizmi, produkti kryesor i interesit është vetë prodhimi, trashëgimia dhe vetë njerëzit që punojnë (Leroux, 1988). Turizmi industrial ka një sërë benefitesh, por më kryesori është ai promovimit të destinacionit dhe rritja e imazhit nëpërmjet marrëdhënieve me publikun (Richards, 1996). Janë tri kategori kryesore që janë të interesuara për të vizituar destinacione të tilla. E para është kategoria e turistëve që kanë interes edukimin, janë kureshtarë dhe të hapur ndaj eksperiencave të reja që lidhen me fenomene dhe procese prodhimi. Kategoria e dytë është ajo e turistit biznesmen që viziton dhe investon në eksperiencë unike tashmë dhe jo veç në të mira fizike si dhe kategoria e tretë është ajo e turistëve të organizuar, ku futen shkollat, familjet, grupet e ndryshme dhe institucionet që kërkojnë të kalojnë një ditë ndryshe.

Por kaskada e Drinit ka potencialin të ofrojë dhe një diversitet tjetër produkti turistik, që do të mbështeste dhe më shumë dëshirën për të vizituar destinacionin. Duke parë tipologjinë e zonës, relievin dhe natyrën, konsumatorin aktual që e viziton si dhe duke u ndalur në trendet e turizmit global për të ardhmen, janë disa koncepte turistike të përshtatshme për kaskadën e Drinit. Do të ishte e përshtatshme të zhvillohej turizmi me bazë natyrën, duke u ndalur në mundësinë e ecjes në natyrë me veçanti parkun e Blinit apo ecjen nëpër shtigje me pamje panoramike përgjatë gjithë rrugës të Vaut të Dejës – Koman. Një kategori tjetër turizmi që i përshatet zonës është dhe turizmi arkeologjik, ku zona njihet për numrin e madh të

shpellave ku më e njohura është ajo e Kaurit në zonën e Pukës. Vizita në kalanë e Sardës ose ishullin e Shurdhahut janë një tjetër potencial që lidhet me historinë dhe kulturën e Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës. Nga ana tjetër, është interesante të shohësh që zona ka një potencial dhe për zhvillimin e turizmit alpin me ngjitje në mal dhe aplikimin e alpinizmit panoramik ku mund të shijosh kënaqësinë e bukurisë që të jep pjerrësia e malit në të dy anët e liqenit me lartësi që shkon deri në 1200 m. Turet e peshkimit në rezervatet artificiale të peshkut, ciklizmi aventuresk, safari me barka, shëtitjet me kayak, gastronomia e zonës, bashkë me mundësinë për të shfrytëzuar plazhin dhe marrjen e rrezeve të diellit, janë shërbime të tjera që mund të ofrohen për të diversifikuar produktin turistik të zonës me bazë turizmin industrial.

Të promovosh dhe nxjerrësh në pah infrastrukturën e mahnitshme të ndërtimit të HECve në kaskadën e Drinit, të informosh turistët për mënyrën e organizimit të punës dhe edukosh mbi procesin e prodhimit të energjisë, është një eksperiencë më vete që çdo turist i cili viziton atë zonë do të kishte interes ta shihte të paktën një herë në jetën e tij. Duke ndërthurur edukimin mbi HECet dhe pamjet panoramike që ato afrojnë, krijohet një produkt atraktiv për turistin. Më poshtë jepen dhe disa propozime konkrete shumë interesante të bëra nga Hernandez (2020) për një projekt që pritet të financohet shumë shpejt nga KESH për kaskadën e Drinit.

Koncept propozim për kaskadën e Drinit

Propozimet e bëra nga Hernandez (2020) lidhen me tipologjinë e arkitekturës dhe dizajnit e disa prej produkteve turistike që mund të aplikohet në kaskadën e Drinit



1.

Pavioni i Ujit

Pavioni propozohet të ndërtohet në hidrocentralin e Komanit, në pjesën ku lidh turbinat me pjesën e rrjedhshme të liqenit.

Ky pavion, mund të shërbejë si panair për promovimin e produkteve të zonës, mund të jetë si pikë referimi dhe relaksi për turistët si dhe komunikon historinë se si kaskada e Drinit është kthyer në një fuqi të prodhimit të energjisë.



2. Muzeu i Hidrocentraleve

Ideimi i muzeut si një hapësirë publike në pjesën e hyrjes së hidrocentralit të Vaut të Dejës.

Muzeumi do të shërbejë për të parë nga afër mënyrën e operimit të turbinave, historikun e ndërtimit, guida në hidrocentrale dhe aktivitete të ndryshme edukimi dhe rekreacioni.



burimi: casanova + hernandez architects / EU bridges, 2020

3. Rrugëtimi drejt Energjisë

Koncepti i kësaj arkitekture është të krijohet një rrugë këmbësorësh prej 2.5 km me 130m e lartë që lidh hidrocentralin me pjesën e liqenit.

Turistët këtu kanë mundësi të sodisin ambientin, të bejnë fotografi dhe të relaksohen me peizazhin e bukur që ofron kaskada e Drinit

Konkluzione

Turizmi industrial nuk është një formë e re aplikimi turizmi, por që kohët e fundit po merr një vëmendje të madhe në industrinë turistike me aplikime inovative. Në Shqipëri kjo fushë është akoma në fazat e para dhe janë të rralla destinacionet që po e promovojnë atë. Ky punim lidhet me mundësinë e zhvillimit të zonës së kaskadës së Drinit në fushën e turizmit, duke investuar në produkte të ndryshme turistike me bazë turizmin industrial. Nga analiza e zonës dhe potencialit që ajo ka, shihet qartë që tre

hidrocentralet që ndodhen në Vaun e Dejës, Koman dhe Fierze kanë mundësinë të përdoren dhe si destinacione edukimi, rekreacioni dhe trashëgimie industriale përveç qëllimit të prodhimit të energjisë që ato kanë. Kjo do t'i jepte një pamje tjetër destinacionit dhe do të sillte një numër të madh turistësh që do të kishin kureshtjen për të mësuar më shumë rreth historisë së hidrocentraleve, por jo vetëm. Fëmijët dhe familjarët do të kishin mundësinë të argëtoheshin dhe të kalonin një fundjave ndryshe me muzeun e hidrocentraleve apo në parkun e energjisë. Nga ana tjetër, puna e madhe që është bërë për ndërtimin e HECve dhe procesi aktual i prodhimit të energjisë, do të vlerësohej më shumë nga brezat e ardhshëm. Bukuria dhe diversiteti turistik i zonës të jep mundësinë të zhvillosh dhe aktivitete të tjera turistike, duke e kthyer kaskadën e Drinit në një destinacion unik dhe me shumë impakt për ekonominë e qarkut të Shkodrës.

REFERENCAT

- Aarhus, (2017), Identifikimi dhe hartëzimi i faktorëve ndotës të lumit Drin, Bashkia e Vau të Dejës me Bashkinë Shkodër.
- Choe, H., Ling, G. J., Yen, Hwang, K. P., (2016), Building brand equity through industrial tourism, *Asia Pacific Management Review*, 1-10
- Hospers, G.-J. (2002), Industrial heritage tourism and regional restructuring in the European Union. *European Planning Studies*, 10(3), 397-404
- Hernandez, J. (2020), Assessment of potentials & proposals for development along the drin river cascade, Casanova + Hernandez architects / EU bridges
- KESH, 2015, Informacion i përmbledhur për Vaun e Dejës, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
- Leroux, R.R, (1988), Make way of the tourism homo faber, *Vue Tourisfique*, 1, 3
- Lin, C. L., (2019), The analysis of sustainable development strategies for industrial tourism based on IOA-NRM approach, *Journal of Cleaner Production* 241, 118-131
- McBoyle, G. (1994), Industry's contribution to Scottish tourism: The example of malt whisky distilleries. In A. Seaton (Ed.), *Tourism: The state of the art*, 517-528
- Mitchell, M. A., & Orwig, R. A. (2002), Consumer experience tourism and brand bonding, *Journal of Product & Brand Management*, 11(1), 30-41
- Otegaar, A. (2012), Towards a common agenda for the development of industrial tourism. *Tourism Management Perspectives*, 4, 86-91
- Richards, G. (1996). Production and consumption of European cultural tourism. *Annals of Tourism Research*, 23 (2), 261-283

NDIKIMI I VLERËSIMIT DHE VETËVLERËSIMIT NË KËNAQËSINË E PUNONJËSVE NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

¹Albana Bushati, Emirjeta Bejleri²

¹*Institucioni i Prefektit Qarku Shkodër, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
departamenti i Administrim-Biznesit*

²*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Administrim-Biznesit*

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të identifikohet mënyra se si ndikojnë niveli i vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kënaqësinë në punë të punonjësve që janë të angazhuar në administratën shtetërore të cilët operojnë në qytetin e Shkodrës.

Me anë të analizimit të këtyre faktorëve nëpërmjet pyetësorit të organizuar për punonjësit e administratës shtetërore do të arrihet të mblidhen të dhëna të hollësishme në lidhje me vlerësimin, vetëvlerësimin dhe ndikimin në nivelin e kënaqësisë së tyre. Të dhënat do të analizohen me software

¹ Diplomuar në korrik të vitit 2017 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës në Bachelor Administrim Biznes. Në korrik të vitit 2019 mori titullin Master i Shkencave në Administrim- Biznes pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Që në vitin 2019, punon në Institucionin e Prefektit Qarku Shkodër, si specialiste e burimeve njerëzore. Gjithashtu, po në këtë vit, është bërë pjesë e stafit akademik si pedagoge e jashtme, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik.

² Pedagoge me kohë të plotë e Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Në 1997 ka kryer studimet bachelor në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”. Në 2002 ka përfunduar studimet në Master në Administrim-Biznes, Universiteti i Illinoisit Jugor, ku është nderuar për Rezultate të Shkëlqyera – Anëtare e Shoqatës së Nderit Phi Kappa Phi e përzgjedhur nga Southern Illinois University at Carbondale. Aktualisht zotëron titullin Ph.D. në Shkenca Ekonomike, titull i fituar në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës në 2009. Ka kryer trajnime e specializime në fusha ekonomike pranë universiteteve, si: Coimbra Group Universities Splitit Kroaci, Qendra Trajnuese CEFAL Bologna Itali, Central European University Budapest Hungari, Universiteti i Grazit Austri. Ka realizuar botime shkencore dhe ka qenë pjesëmarrëse në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

statistikorë SPSS, me anë të përdorimit të analizës faktoriale, analizës korrelacionare dhe regresionit.

Rezultoi që ndikim më të madh në nivelin e kënaqësisë së punonjësve kishte vlerësimi, që siguronte një rritje të nivelit të kënaqësisë me 0.752 pikë.

Fjalë kyçe: kënaqësi në punë, vlerësim, vetëvlerësim.

The impact of evaluation and self-evaluation on employee satisfaction in the state administration

ABSTRACT

The main purpose of this paper is to identify how the level of evaluation and self-evaluation affect the job satisfaction of employees who are engaged in state administration operating in the city of Shkodra.

By analyzing these factors through a questionnaire organized for state administration employees will be able to collect detailed data regarding the assessment, self-assessment and the impact on their level of satisfaction. Data will be analyzed with SPSS statistical software, using factor analysis, correlation analysis and regression.

It turned out that the biggest impact on the level of employee satisfaction had the rating, which provided an increase in the level of satisfaction by 0.752 points.

Keywords: job satisfaction, evaluation, self-evaluation.

Hyrje

Vlerësimi i performancës konsiderohet si një nga fushat më të rëndësishme të aplikueshmërisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (Kane et al., 1995). Sot, të gjitha institucionet që bëjnë pjesë në administratën publike dhe atë shtetërore, si dhe bizneset private, madje edhe organizmat joqeveritare realizojnë një vlerësim të performancës së punonjësve të tyre. Procesi i vlerësimit të performancës interpretohet si një funksion i 3 sistemeve ndërvepruese: konteksti organizativ, sistemi i përpunimit të informacionit të punonjësit që po vlerësohet dhe sistemi i tij i sjelljes.

Vlerësimi i performancës nuk realizohet vetëm nga institucioni, biznesi apo organizata ku punon, por edhe nga vetë individi. Të jesh në gjendje të rishikosh performancën është një aftësi thelbësore për t'u zhvilluar, edhe

përtej procesit të vlerësimit të performancës. Kjo gjë i nxit të gjithë punonjësit të njohin atë që kanë arritur tashmë, çfarë mund të ishte bërë më mirë dhe ku mund të dëshirojnë të përqendrojnë zhvillimin për të ardhmen (Abdel-Khalek, 2016). Të dy këto faktorë shfaqin një interes në nivelin e kënaqësisë së punonjësve për të realizuar punën e tyre të caktuar dhe detyrat funksionale.

RISHIKIMI I LITERATURËS

1.1 Vlerësimi i performancës në administratën shtetërore

Boice dhe Kleiner (1997) theksojnë se objektivat organizative duhet të përcaktohen fillimisht përpara se të fillohet të ndërtohet një sistem i menaxhimit të performancës në mënyrë që të bëhet efektiv. Aktualisht, vlerësimi i performancës është menduar mirë si një tipar shumë i rëndësishëm në administrimin e kapitalit njerëzor dhe një element i procesit të kontrollit në menaxhim (Najafi et al., 2010).

Vlerësimi i performancës ka për qëllim që të zbulojë se cilat janë anët e forta dhe të dobëta të të gjithë punonjësve (Lu et al., 2021), konkretisht në studimin tonë të atyre që bëjnë pjesë në administratën shtetërore.

Sipas VKM nr. 109, datë 26.02.2014 (i ndryshuar) me VKM nr. 252, datë 30.3.2016, paraqitet mënyra që do të realizohet vlerësimi në punë i punonjësve të administratës shtetërore. Theksi vihet në elemente si:

- *Sjellje profesionale* që identifikon mundësinë e realizimit të punës me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë.
- *Gabimet/saktësia në punën e kryer* që identifikon se sa i lartë është niveli i saktësisë që është karakteristike për punën e kryer.
- *Realizimi në kohë i punës* që identifikon numrin e rasteve, në të cilat puna e kryer është bërë më shpejt ose më ngadalë sesa pritej.
- *Kolegjialiteti i marrëdhënieve* që përfaqëson marrëdhëniet me kolegët.
- *Gatishmëria për punën në grup* që tregon se në çfarë mase nëpunësi konsiderohet pjesëmarrës i gatshëm dhe produktiv në punën në grup.

Të gjitha elementet e sipërpërmendura ndikojnë në vlerësimin e punonjësve në administratën shtetërore. Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik, pra dy herë në vit.

Në mënyrë të përmbledhur, vlerësimi i rezultateve në punë ka të bëjë me:

- a) vlerësimin e realizimit të objektivave,
- b) vlerësimin e sjelljes profesionale.

Në sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë, për secilin nga elementet e mësipërme përdoren katër nivele të shkallëzuara vlerësimi:

- a) *Shumë mirë*, atëherë kur nëpunësi ka realizuar shumë mirë të gjitha objektivat dhe ka treguar një sjellje e qëndrim profesional të dalluar nga të tjerët.
- b) *Mirë*, kur nëpunësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim të mirë profesional.
- c) *Kënaqshëm*, kur nëpunësi ka realizuar kënaqshëm objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të kënaqshëm.
- d) *Jokënaqshëm*, kur nëpunësi nuk ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale (VKM nr 109, datë 26.02.2014).

1.2 Vetëvlerësimi i performancës

Vetëvlerësimi (Self Assesment) mund të plotësojë vlerësimet e performancës së realizuara nga eprorët direkt. Vetëvlerësimi mund të përdoret gjithashtu për të ndihmuar punonjësit të përmirësojnë performancën e tyre të punës (Campbell & Lee, 1988).

Termi vetëvlerësim, shpesh përdoret për të përshkruar vlerën personale të vetë personit. Ai shikohet si:

- ✓ një tipar personaliteti,
- ✓ një shumëllojshmëri besimesh rreth vetes, të tilla si vlerësimi i pamjes, besimeve, emocioneve dhe sjelljeve.

Sipas modelit të vetëvlerësimit (Core self-evaluations) për të matur nivelin e vetëvlerësimit përfshihen disa faktorë, që mund të jetë e mundur të ndikojnë në kënaqësinë në punë. Këto faktorë janë:

- **vetefikasiteti**. Nëse një individ pëlqen të marrë detyra sfiduese, të përmirësohet shpejt nga gabimet dhe të tregojë përkushtim më të fortë ndaj interesave, thuhet se ka vetefikasitet të fortë (Bandura, 1977),
- **lokusi i kontrollit** i cili tregon një tendencë që individët t'i atribuojnë ngjarjet që i ndodhin veprimeve të tyre ose forcave të jashtme që janë jashtë kontrollit të tyre (Adeyemi-Bello, 2001),
- **stabiliteti emocional** përfshin eksperiencën emocionale të të gjithë njerëzve gjatë aktiviteteve të përditshme dhe rrjedhimisht edhe në punë (Watson, 2000),
- **vetëbesimi** përfaqëson besimin që individit ka për punën e kryer (Tharenou, 1979).

Sipas një studimi niveli i lartë i vetëvlerësimit të një individi do të kontribuojë vetëm në sjelljen mbrojtëse, humbjen e krenarisë në punë dhe nivele më të ulëta të performancës së punës (Meyer, 1980).

1.3 Kënaqësia në punë

Kënaqësia në punë mund të përkufizohet si reagim emocional i një punonjësi ndaj kushteve në të cilat punonjësi punon (Baluyos et al., 2019). Nëse një punonjës është i lumtur për punën që ushtron dhe mbi të gjitha edhe me mjedisin e vendit ku punon, thuhet se është i kënaqur me punën e tij. Kënaqësia në punë nga autorë të ndryshëm përkufizohet si gjendje e dëshirueshme emocionale ose e këndshme në përgjigje të përvojave të punës ose vlerësimeve të punës (Judge & Locke, 1993). Sipas Herzberg (1968) e kundërta e kënaqësisë përfaqësohet nga mungesa e kënaqësisë ose jokënaqësia.

Në një krahasim të vlerësimit tradicional të performancës të përgatitur nga menaxheri apo eprori me vlerësimin e performancës të përgatitur nga vetë punonjësi, në një studim të realizuar nga Basset & Meyer (1968). U zbulua se vetëvlerësimi ishte i preferueshëm nga shumica e pjesëmarrësve dhe rezultoi në një ndikim të rëndësishëm në kënaqësinë në punë.

Rezultatet në kërkimin e realizuar të Farh dhe Arthur, treguan se kishte një marrëdhënie pozitive midis vetë vlerësimeve dhe atyre nga eprori si dhe të dy vlerësimet kishin nivele të moderuara deri në të larta të pikëve të grumbulluara në lidhje me elementet e përfshira (Farh et al., 1988).

Në një studim të realizuar në fushën e psikologjisë, rezultoi se pjesëmarrësit dhanë një gjykim për vlerësimin e performancës së marrë nga eprorët (e cila ishte ose shumë e mirë ose mesatarisht e dobët) pas marrjes së informacionit të vetëvlerësimit (i lartë ose i ulët). Vetëvlerësimet paraprake ndikuan në kënaqësinë në punë për performuesit e mirë, por jo për performuesit e dobët (Shore & Tashchian, 2002).




Figura 1: Modeli Konceptual

Në figurën e mësipërme, në përmbledhje të analizës teorike paraqitet modeli konceptual në përputhje me hipotezat e mëposhtme. Pra,

do të identifikojmë ndikimin e vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kënaqësinë në punë.

Në bazë të faktorëve të mësipërm që ndikojnë në kënaqësinë në punë të punonjësve, më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar hipotezat e këtij punimi:

Hipoteza e parë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis nivelit të vlerësimit dhe kënaqësisë në punë.

Hipoteza e dytë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis nivelit të vetëvlerësimit dhe kënaqësisë në punë.

METODOLOGJIA

2.1 Mbledhja e të dhënave

Metodologjia e përdorur për të realizuar këtë punim është anketimi. Në këtë studim të dhënat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorit, i cili është shpërndarë në mënyrë direkte në institucionet e administratës shtetërore në qytetin e Shkodrës që përbën popullatën. Është përzgjedhur pyetësi, pasi ofron më tepër lehtësi në menaxhimin e të dhënave dhe akses te punonjësit. Kampioni i marrë në shqyrtim në mënyrë të rastësishme është i barabartë me 124 të punësuar në qytetin e Shkodrës, të cilët kthyen përgjigje për pyetje të caktuara.

Pyetësi është i ndarë në disa pjesë:

Pjesa I, konsiston në informacionet e përgjithshme për të punësuarin në lidhje me: gjininë, moshën dhe nivelin e studimeve.

Pjesa II, përfshin pyetje në lidhje me vlerësimin e punonjësve nga eprori për 6 -mujorin e fundit, konkretisht janar - qershor 2021 të matura me shkallën Likert nga 1-4 në rend rritës. Në këtë pjesë janë blloqet e pyetjeve sipas modelit të vlerësimit të performancës. Faktorët e marrë në studim janë pikërisht ato që përcaktohen në VKM nr.109, datë 26.02.2014, ku përcaktohet modeli i formularit të vlerësimit të punës. Gjithashtu përfshihen elementet e vetëvlerësimit, pra 4 faktorët që ndikonin në vetëvlerësim të matura me shkallën Likert nga 1-5 në rend rritës. Janë përdorur instrumente matjeje të gatshëm, pikërisht ata faktorë që kanë shanse të ndikojnë më shumë në vetëvlerësim.

Pjesa III, përfshin pyetje në lidhje me kënaqësinë në punë të punonjësve. Janë ndërtuar blloqe pyetjesh të matura me shkallën Likert nga 1-5 në rend rritës.

Të dhënat janë analizuar me software statistikor SPSS versioni 20. Me përdorimin e analizës faktoriale do të identifikohen se cilat janë pohimet e rëndësishme në mënyrë statistikisht domethënëse për secilin nga elementet e mësipërme: vlerësim, vetëvlerësim dhe kënaqësia në punë. Me anë të

regresionit të shumëfishtë do të identifikohet se si ndikojnë dhe në çfarë mase, vlerësimi dhe vetëvlerësimi në kënaqësinë në punë.

ANALIZA E REZULTATEVE

3.1 Statistika përshkruese

Me anë të statistikës përshkruese do të identifikohen të dhëna të përgjithshme të kampionit tonë në lidhje me variablat demografikë.

Tabela 1: Statistika përshkruese.

Variablat	N	%
Gjinia		
Femra	79	63.7%
Meshkuj	45	36.3%
Total	124	100%
Mosha		
20-30	12	9.7%
30-40	32	25.8%
40-50	42	33.9%
50-60	25	20.1%
60-65	13	10.5%
Total	124	100%
Niveli i edukimit		
I mesëm	2	1.6%
I lartë	122	98.4%
Total	124	100%
Eksperiencia në punë		
0-10 vite	22	17.7%
10-20 vite	46	37.1%
20-30 vite	43	34.7%
Më shumë se 30	13	10.5%
Total	124	100%

Nga tabela e mësipërme rezulton që pjesa më e madhe e të anketuarve janë femra, 63.7% prej tyre dhe pjesa tjetër janë meshkuj, 36.3% prej tyre. Pjesa më e madhe e të punësuarve në administratën shtetërore janë të moshës 40 deri në 50 vjeç, me një përfshirje në nivelin afërsisht 34% ndërsa pjesa më e ulët janë punonjësit në moshën më të re 20-30 vjeç me një frekuencë 9.4%.

Për sa i përket nivelit të edukimit rezultoi se pothuajse të gjithë punonjësit e anketuar janë me nivel të lartë arsimor, gjë që përbën një ndër kushtet e punësimit në administratën shtetërore. Vetëm 1.6% janë punonjës me nivel të mesëm edukimi, ku mund të përfshihen specialistë që mund të kenë realizuar vetëm kurse të veçanta për pozicionin e tyre të punës.

Në lidhje me eksperiencën në punë, shohim që pjesa më e madhe e të anketuarve kanë eksperiencë pune 10-20 vjet dhe 20-30 vjet, konkretisht 37% për kategorinë e parë dhe 35% për kategorinë e dytë. Pjesa më e vogël, 10.5% e tyre, kanë eksperiencë më shumë se 30 -vjeçare, e lidhur drejtpërdrejt edhe me variablin moshë, ku rezultoi e njëjta frekuencë e shfaqur.

3.2 Analiza faktoriale

Dy elementet që mund të ndikojnë në kënaqësinë në punë janë vlerësimi dhe vetëvlerësimi. Me anë të analizës faktoriale do të identifikohen nëse këto faktorë janë statistikisht domethënës dhe nëse blloqet e pyetjeve janë gjithashtu domethënëse. E njëjta gjë vlen edhe për variablin tonë të varur, kënaqësia në punë. Konkretisht, niveli i të Cronbach Alpha për secilin nga faktorët duhet të jenë më të larta se 0.7 (Santos, 1999) dhe peshat faktoriale për secilin pohim ose nënfaktor duhet të jenë më të larta se 0.4 (Costello & Osborne, 2005).

Më poshtë do të identifikohen sa nga këto kushte plotësohen.

Tabela 2: Analiza faktoriale.

Faktorët/Nënfaktorët	Cronbach Alpha/ Pesha faktoriale
Vlerësimi	0.896
Objektivat e përmbushura	0.534
Rezultatet e Synuara	0.845
Sjellja Profesionale	0.654
Vetëvlerësimi	0.782
Vetëbesimi	0.656
Lokusi i kontrollit	0.488
Stabiliteti Emocional	0.559
Vetefikasiteti	0.698
Kënaqësia në punë	0.852 (0.857)
Kushtet në punë	0.654 (0.687)
Paga	0.754 (0.789)
Mundësi për trajnim/zhvillim	0.563 (0.587)
Liria në punë	0.325 -----
Mundësia për bashkëpunim	0.664 (0.678)

Burimi: SPSS

Siç mund të shohim nga tabela e mësipërme faktorët vlerësim dhe vetëvlerësim edhe nivelet e Cronbach Alpha janë më të larta se 0.7, konkretisht 0.896 për vlerësimin dhe 0.782 për vetëvlerësimin. Ndërsa të

gjithë nënfaktorët, 3 për vlerësimin dhe 4 për vetëvlerësimin kanë pesha faktoriale më të larta se 0.4.

Për variablin kënaqësia në punë, niveli i cronbach alpha është më i lartë se 0.7, por nivelet e peshave faktoriale nuk janë të gjitha më të larta se 0.4. Konkretisht nënfaktori, liria në punë ka një peshë faktoriale prej 0.325 që tregon se nuk është statistikisht domethënëse për variablin kënaqësia në punë dhe në vijim do të procedohet analiza në mungesë të tij. Numrat në kllapa simbolizojnë nivelet e reja të Cronbach Alpha që rezultojnë të gjitha më të mëdha se 0.4.

3.3 Regresioni i shumëfishtë

Me anë të analizës së regresionit do të testojmë në paralelizëm dy hipotezat e para, për të parë nëse vlerësimi dhe vetëvlerësimi ndikojnë në nivelin e kënaqësisë në punë.

Tabela 4: Modeli i regresionit të shumëfishtë

Modeli	Koeficienti R	Koeficienti R ²	F (Sig)
Regresioni	0.725	0.525	35.63 (0.000)

Variabli i varur: Kënaqësia në punë

Variablat e pavarur: Vlerësimi, vetëvlerësimi

Burimi: SPSS

Në tabelën e mësipërme jepet informacion për koeficientat e korrelacionit dhe të regresionit. Koeficienti i korrelacionit, $R=0.725$, është një koeficient pozitiv, që na tregon që ka një lidhje të fortë pozitive midis variablave të pavarura (vlerësim & vetëvlerësim) dhe variablit të varur (kënaqësia në punë). Kurse koeficienti R^2 , i determinacionit, tregon se variacioni i variablit të varur, kënaqësia në punë, shpjegohet në një masë 52.5% nga kontributi i variablave të pavarura që janë të përfshira në studimin tonë: vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Pjesa tjetër përbën elementet që nuk janë të përfshira në këtë studim, por që mund të ndikojnë në nivelet e kënaqësisë në punë të punonjësve të administratës shtetërore. Shohim që vlera F e testit Fisher të Regresionit të shumëfishtë është në vlerën 36.63 dhe ka një nivel të sig=0.000 që tregon që është një test i rëndësishëm në mënyrë statistikore. Para, do të thotë që të paktën një nga variablat e pavarura, vlerësimi apo vetëvlerësimi ndikon në mënyrë statistikisht domethënëse në kënaqësinë në punë, që është variabli jonë i varur.

Tabela 3: Regresioni i shumëfishtë.

Modeli	Koeficienti B	T	Sig.
(Konstantja)	1.235		0.000
Vlerësimi	0.752	0.658	0.002
Vetëvlerësimi	0.639	0.758	0.001

Variabli i varur: Kënaqësia në punë

Variablat e pavarur: Vlerësimi, vetëvlerësimi

Burimi: SPSS

Për të konkretizuar nëse vlerësimi dhe vetëvlerësimi ndikojnë apo jo në mënyrë statistikisht domethënëse në kënaqësinë në punë duhet që niveli i signifikancës të testit T Studenti, të jenë më të vogla se 0.05. Me radhë shohim që:

- Konstantja: Sig=0.000 < 0.05; i rëndësishëm statistikisht.
- Vlerësimi: Sig=0.002 < 0.05; i rëndësishëm statistikisht.
- Vetëvlerësimi: Sig=0.001 < 0.05; i rëndësishëm statistikisht.

Si përfundim të tre variablat, duke përfshirë edhe konstanten janë të rëndësishme në mënyrë statistikore. Nga të dhënat e koeficientave Beta mund të shkruajmë ekuacionin e regresionit shumë:

Kënaqësia në punë=1.235+0.752(**vlerësim**) +0.639 (**vetëvlerësim**)

Shohim që të dy koeficientat Beta janë pozitiv që do të thotë se ekziston një lidhje pozitive midis secilit prej variablave të pavarur me atë të varur.

Konkludojmë që me rritjen e nivelit të vlerësimit të performancës së të punësuarve në administratën shtetërore me 1 pikë; kënaqësia e tyre në punë rritet afërsisht me 0.752 pikë (me të tjera të pandryshuara).

Me rritjen e nivelit të vetëvlerësimit me 1 pikë; kënaqësia e tyre në punë rritet afërsisht me 0.639 pikë (me të tjera të pandryshuara). Kontribut në rritjen në pikë të kënaqësisë në punë, e shprehur nga nëpunësit e administratës shtetërore, ka më tepër niveli i vlerësimit të punonjësve nga eprorët e tyre sesa nga vetëvlerësimi.

Si përfundim, hipoteza e parë dhe e dytë pranohen. Pra, ekziston një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis vlerësimit dhe kënaqësisë në punë (hipoteza 1) dhe vetëvlerësimit dhe kënaqësisë në punë (hipoteza 2).

Përfundime

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte analizimi i vlerësimit, vetëvlerësimit dhe kënaqësisë së punonjësve që punojnë në administratën shtetërore në qytetin e Shkodrës. Me anë të analizës faktoriale rezultuan që faktorët:

vlerësim, vetëvlerësim dhe kënaqësi në punë janë të rëndësishëm statistiki. Gjithashtu u analizua kontributi i vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kënaqësinë e nëpunësve publikë. Rezultoi që kënaqësia në punë varet në një masë 52.5% nga niveli i vlerësimit të punonjësve dhe vetëvlerësimit të tyre. Lidhja që ekziston midis të dy faktorëve dhe kënaqësisë në punë të punonjësve rezultoi pozitive.

Me rritjen e nivelit të vlerësimit të performancës së të punësuarve në administratën shtetërore rritet edhe kënaqësia e tyre në punë, konkretisht me 0.752 pikë. Me rritjen e nivelit të vetëvlerësimit rritet edhe kënaqësia e tyre në punë afërsisht me 0.639 pikë.

Rekomandime

Duke qenë se vlerësimi dhe vetëvlerësimi janë disa nga faktorët që ndikojnë në kënaqësinë në punë, në angazhimin e tyre, eprorët e administratës shtetërore duhet të kenë në vëmendje këtë proces. Me të vërtetë realizohet vetëm dy herë në vit, në formate shkresore, por kuptojmë që ndikon në mirangazhimin dhe kënaqësinë në vendin e tyre të punës. Sa më të kënaqur të jenë aq më mirë do të performojnë.

Ata mund të realizojnë vlerësime të brendshme më të shpeshta në mënyrë që të kenë vlerë për kënaqësinë e tyre.

Në këtë studim në të ardhmen, mund të përfshihen më tepër elemente që mund të ndikojnë në kënaqësinë në punë. Gjithashtu mund të përfshihet një kampion relativisht më i madh në mënyrë që të konkretizohet më në detaje ndikimi i vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kënaqësinë në punë.

Limitimet e punimit

Gjatë përgatitjes së këtij punimi dhe analizës së rezultateve të gjeneruara nga pyetësi shfaqen edhe problematika të caktuara:

- Madhësia e kampionit të marrë në studim ishte relativisht e vogël (124).
- Të dhënat janë mbledhur në një periudhë kohore prej 2 muajsh gjë që nuk na lejon të kuptojnë ndryshimin në kohë.
- Ekzistojnë faktorë të tjerë të cilët mund të ndikojnë në kënaqësinë në punë të punonjësve të cilët nuk janë marrë në shqyrtim.

BIBLIOGRAFIA

- Abdel-Khalek, A. (2016). *Introduction to the Psychology of self-esteem* (pp. 1–23).
- Adeyemi-Bello, T. (2001). Validating Rotter's (1966) locus of control scale with a sample of not-for-profit leaders. *Management Research News*, 24(6/7), 25–34. <https://doi.org/10.1108/01409170110782865>
- Baluyos, G. R., Rivera, H. L., & Baluyos, E. L. (2019). Teachers' Job Satisfaction and Work Performance. *Open Journal of Social Sciences*, 07(08), 206–221. <https://doi.org/10.4236/jss.2019.78015>
- Bandura, A. (1977). Self-efficacy: Toward a unifying theory of behavioral change. *Psychological Review*, 84(2), 191–215. <https://doi.org/10.1037//0033-295x.84.2.191>
- Basset, G. A., & Meyer, H. H. (1968). Performance appraisal based on self-review. *Personnel Psychology*, 21(4), 421–430. <https://doi.org/10.1111/j.1744-6570.1968.tb02042.x>
- Boice, D. F., & Kleiner, B. H. (1997). Designing effective performance appraisal systems. *Work Study*, 46(6), 197–201. <https://doi.org/10.1108/00438029710367622>
- Campbell, D. J., & Lee, C. (1988). Self-Appraisal in Performance Evaluation: Development Versus Evaluation. *Academy of Management Review*, 13(2), 302–314. <https://doi.org/10.5465/amr.1988.4306896>
- Costello, A. B., & Osborne, J. W. (2005). Best Practices in Exploratory Factor Analysis: Four Recommendations for Getting the Most From Your Analysis. *Exploratory Factor Analysis*, 10(7), 9.
- Farh, J.-L., Werbel, J. D., & Bedeian, A. G. (1988). An Empirical Investigation of Self-Appraisal-Based Performance Evaluation. *Personnel Psychology*, 41(1), 141–156. <https://doi.org/10.1111/j.1744-6570.1988.tb00636.x>
- Herzberg, F. (1968). *One More Time: How Do You Motivate Employees?*
- Judge, T. A., & Locke, E. A. (1993). Effect of dysfunctional thought processes on subjective well-being and job satisfaction. *Journal of Applied Psychology*, 78(3), 475–490. <https://doi.org/10.1037/0021-9010.78.3.475>
- Kane, J. S., Bernardin, H. J., & Wiatrowski, M. (1995). Performance Appraisal. In *Psychology and Policing*. Psychology Press.
- Lu, H., Zhao, P., & Liu, S. (2021). *Research on Performance Appraisal Method in Internet-based Working*. 1815(1), 012003. <https://doi.org/10.1088/1742-6596/1815/1/012003>
- Meyer, H. H. (1980). Self-appraisal of job performance. *Personnel Psychology*, 33(2), 291–295. <https://doi.org/10.1111/j.1744-6570.1980.tb02351.x>
- Najafi, L., Hamidi, Y., Vatankhah, S., & Purnajaf, A. (2010). *Performance appraisal and its effects on employees' motivation and job promotion*. 4, 6052–6056.
- Santos, J. R. A. (1999). Cronbach's Alpha: A Tool for Assessing the Reliability of Scales. *Journal of Extension*, 37(2). <https://www.joe.org/joe/1999april/tt3.php>
- Shore, T. H., & Tashchian, A. (2002). Accountability forces in performance appraisal: Effects of self-appraisal information, normative information, and task performance. *Journal of Business and Psychology*, 17(2), 261–274. <https://doi.org/10.1023/A:1019689616654>
- Tharenou, P. (1979). Employee self-esteem: A review of the literature. *Journal of Vocational Behavior*, 15(3), 316–346. [https://doi.org/10.1016/0001-8791\(79\)90028-9](https://doi.org/10.1016/0001-8791(79)90028-9)
- VKM nr 109. (n.d.). *VENDIM Nr. 109, datë 26.2.2014*.
- Watson, D. (2000). *Mood and temperament* (pp. xi, 340). Guilford Press.

APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË KONTABILITET

Xhovana Nikollaj¹, Fatbardha Molla (Beqiri)²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Master shkencor Kontabilitet,
departamenti i Financë - Kontabilitetit*

ABSTRAKT

Sistemi i informacionit kontabël është informacioni i cili jepet mbi rrjedhat kontable ose nga rrjedhat kontable, ku në rastin e dytë ky informacion ndihmon në marrjen e vendimeve rreth biznesit. Nisur nga rëndësia e sistemit të informacionit kontabël në këtë punim do të trajtohet aplikimi i teknologjive informative në kontabilitet në bizneset e qytetit të Shkodrës.

¹ Në periudhën 2016-2019 kam mbaruar studimet në Univeristetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik, dega Financë – Kontabilitet (Bachelor). 2019 - 2021 Master shkencor (Kontabilitet) pranë këtij Universiteti.

²Pas mbarimit të studimeve në vitin 1993-1994 kam punuar në **Degën e Thesarit Shkodër si specialiste e të ardhurave .**

Në vitin 2004 e në vazhdim punoj si pedagoge e brendshme pranë këtij Universiteti, për lëndët Analize financiare (leksione e seminare), Financë publike (seminare), Kontabilitet bujqësor (leksione, seminare), Hyrje në financë (seminare).

Aktualisht po punoj me lëndët “Kontabilitet financiar”, “Kontabilitet financiar i avancuar”, “Parime të kontabilitetit”, “Analizë financiare” me leksione dhe seminare dhe gjithashtu kam përpiluar dhe programet e lëndëve të mësipërme. Pas vitit 2011 jam titullare e lëndëve: “Analizë e pasqyrave financiare“, “Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të Kontabilitetit“ në Master shkencor në Kontabilitet dhe “Analize kredie“ në Master profesional Financë – Bankë.

Gjatë vitit mësimor 2007-2008 dhe 2008-2009 kam punuar si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Bujqësor Tiranë në departamentin e Financë-Kontabilitetit në lëndët Kontabilitet i aplikuar dhe Bazat e kontabilitetit.

“**Doktor i shkencave Ekonomike dhe Agrobiznesit**” - 10 korrik 2009, pranë departamentit “Financë –Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor Tiranë.

Grada “Profesor i asociuar i shkencave ekonomike” – 4 korrik 2012. Financë – Kontabilitet, Universiteti Bujqësor Tiranë, Shqipëri.

Grada “Profesor” 12.04.2018, me numrin rendor 416. Financë – Kontabilitet, Universiteti Bujqësor Tiranë, Shqipëri.

Kam marrë pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe autore e shumë artikujve brenda dhe jashtë vendit.

Qëllimi i studimit është të tregojë ndikimin e aplikimit të teknologjisë informative në kontabilitet, të indentifikojmë dallimet kryesore të kontabilitetit manual dhe atij kompjuterik dhe gjithashtu nëse këto sisteme ndikojnë apo jo produktivitetin e punonjësit. Punimi është realizuar duke u bazuar te kërkimi primar. Kërkimi primar bazohet në një pyetësor drejtuar bizneseve. Për kryerjen e analizës së studimit është përdorur analiza përshkruese. Studimi është përqendruar vetëm në qytetin e Shkodrës. Sipas gjetjeve kemi arritur në disa rezultate, SIT kanë rritur cilësinë e punës duke ulur gabimet në regjistrimin e transaksioneve dhe nxjerrjen e një rezultati të saktë. Sistemet informative në kontabilitet janë komplekse, punonjësit kanë treguar se shpeshherë gjejnë vështirësi në gjetjen e opsioneve apo ikonave të duhura gjatë punës. Shumica e punonjësve janë mesatarisht dakord që sistemet informatike në kontabilitet kanë mangësi, ata treguan se do të donin që këto sisteme të kishin një opion në sistemin financiar i cili tregon në mënyrë direkte artikullin më të shitur në market apo një opion i cili shfaq në mënyrë të menjëhershme datën e maturimit në lidhje me pagesën e një furnitori dhe në lidhje me ndryshimin e çmimit të shitjes së një artikulli, të ketë akses vetëm financiar lidhur me magazinën përkatëse. Kufizimet e hasura në këtë studim nuk kanë qenë të pakta. Ndër to mund të përmendim: mungesën e literaturave të ngjashme për të bërë një krahasim më të thellë apo fakti që studimi është realizuar vetëm për qarkun e Shkodrës. Nëse studimi do të kishte përfshirë edhe biznese në qarqet e tjera, mundësitë për rezultate sa më të sakta dhe reale që të përfaqësojnë fenomenin që po studiojmë do të ishin të larta. Studimi mund të paraqesë një vlerë modeste për studime më të thelluara në fushën e sistemeve informatike kontabël, si dhe inkurajon studiuesit e fushës për të pasuruar më shumë literaturën në lidhje me këtë temë. Gjithashtu, ky punim do të shërbejë si udhërrëfyes për identifikimin e barrierave që hasin bizneset e ndryshme gjatë përdorimit të SIK. Së fundi, ky punim mund të nxisë diskutimin për gjetjen e rrugëzgjdhjeve të mundshme dhe pakësimin e këtyre gabimeve dhe barrierave në të ardhmen.

Fjalët kyçe: teknologji informative, sistemi i informacionit kontabël, sistem i bazuar kompjuterik, fiskalizim.

Application of information technology in accounting

ABSTRACT

The accounting information system is the information which is given on the accounting flows or from the accounting flows, where in the second case

this information helps in making decisions about the business. Given the importance of the accounting information system in this paper will be addressed the application of information technologies in accounting in businesses of the city of Shkodra. The purpose of the study is to show the impact of the application of information technology on accounting, to identify the main differences between manual and computer accounting and also whether or not these systems affect employee productivity. The paper is based on primary research. Primary research is based on a business questionnaire. Descriptive analysis was used to perform the study analysis. The study focused only on the city of Shkodra. According to the findings we have achieved some results, SITs have increased the quality of work by reducing errors in recording transactions and issuing an accurate result. Information systems in accounting are complex, employees have shown that they often find it difficult to find the right options or icons at work. Most employees on average agree that accounting information systems have shortcomings, they indicated that they would like these systems to have an option in the financial system which directly shows the best selling item in the market or an option which displays so immediate maturity date in connection with the payment of a supplier and in connection with the change of the selling price of an item, only the financier has access to the relevant warehouse. The limitations encountered in this study have not been few. Among them we can mention: the lack of similar literature to make a deeper comparison or the fact that the study was conducted only for the region of Shkodra. If the study had included businesses in other counties, the chances for the most accurate and realistic results to represent the phenomenon we are studying would be high. The study may present a modest value for more in-depth studies in the field of accounting information systems, as well as encourage researchers in the field to further enrich the literature on the subject. Also, this paper will serve as a guide for identifying the barriers that different businesses face when using the ICS. Finally, this paper can stimulate discussion about finding possible solutions and reducing these errors and barriers in the future.

Keywords: information technology, accounting information system, computer based system, fiscalization.

1.Fiskalizimi dhe ndikimi në kontabilitet

Në vendin tonë, më 01 janar 2021, filloi implementimi i sistemit të ri tatimor. Ky sistem ka disa karakteristika, si: sigurimi i një certifikate

elektronike nga AKSHI, dërgimi elektronikisht i informacionit mbi vendet e ushtrimit të veprimtarisë, operatorët, mirëmbajtësin e softwarit, vendosjen çdo ditë elektronikisht të gjendjes fillestare të arkës, kontrollin çdo muaj të librave të paraplotësuar të shitjeve dhe blerjeve, si dhe TVSH-së. Ndryshe nga sistemi aktual që blihen fatura të printuara ose kërkohet leje nga DPT për të lëshuar fatura nga një pajisje elektronike, bëhet instalimi i kasave të certifikuara për lëshimin e kuponave tatimorë, dërgohet në fund të çdo dite raporti total nga kasa, dërgimi i librit të shitjeve dhe blerjeve dhe dërgimi i deklaratës së TVSH-së. Procesi i fiskalizimit mund të përkthehet edhe në rritje të shkallës së automatizimit të marrëdhënieve mes biznesit dhe shtetit, ndërmjet bizneseve me njëri-tjetrin, apo edhe ndërmjet biznesit dhe bankave të nivelit të dytë. Informacioni do të shkëmbehet në kohë reale. Në nivelin menaxherial, i gjithë informacioni për të drejtat apo detyrimet nga/ndaj palëve të treta do të shfaqet në kohë reale. Gjithashtu me fiskalizimin e faturave shoqëruese të mallrave, edhe gjendja e magazinave do të raportohet në kohë reale në masën 100% tek organet tatimore. Kjo do të shmangë nevojën e raportimit dhe dorëzimit të inventarit analitik tek tatimet çdo datë 10 janar, siç është kërkuar vitet e fundit. Nëse do të arrijë të zbatohet me sukses edhe faza e fundit e fiskalizimit, që përfshin integrimin e deklaratave doganore për importin e mallrave, apo e bankave të nivelit të dytë dhe urdhërpagesat për çdo faturë elektronike, atëherë edhe për hartimin e bilancit do të mbetet shumë pak punë dhe veprime sistemuese sipas ligjit për ekonomistët e kompanive. Por i gjithë ky proces do të kërkojë një kohë të gjatë përshtatjeje të bizneseve dhe mbi të gjitha, një klimë të favorshme ekonomike, në mënyrë që t'i lejojë të gjithë aktorëve publikë dhe privatë të përfshihen maksimalisht në këtë rrugëtim që kërkon jo pak burime njerëzore, teknologjike dhe financiare.

3. Analiza konkluzione dhe përfundime nga studimi

Studimi më poshtë do të na japë një ide më afër realitetit të efektit të Sistemit të Informacionit në Kontabilitet dhe do të na ndihmojë që të kuptojmë edhe më mirë përgjigjet e pyetjeve mbi të cilin është ndërtuar ky projekt. Kjo analizë përshkruese synon që të paraqesë një tablo përmbledhëse në lidhje me opinionet e bizneseve për pyetjet e drejtuara me anë të pyetësorit. Ky pyetësor, drejtuar bizneseve, ka për qëllim marrjen sa më shumë të informacionit, prandaj ky i fundit ka pasur vetëm pyetje në të cilat përgjigjet përcaktohen lehtë.

2.2.2 Përmbledhje mbi të anketuarit

• Pyetja 1: Moshë e të anketuarve


		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	nën 30	29	55.8	55.8	55.8
	31-40	18	34.6	34.6	90.4
	41-50	4	7.7	7.7	98.1
	51-60	1	1.9	1.9	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig2.1 Moshë e të anketuarve.

Burimi: Të dhënat primare.

Moshë që pranuan më së shumti t'i përgjigjen pyetësorit është moshë nën 30 vjeç dhe ishte një nga moshat më të disponueshme për t'u përgjigjur dhe gjithashtu moshë më e përhapur në bizneset e Shkodrës.

Fig 2.2 Paraqitja grafike mbi moshën e të anketuarve.



Burimi: Të dhënat primare.

Të anketuarit tonë siç shihet edhe nga figura 55.80% i përkasin moshës nën 30 vjeç, nga moshë 31-40 vjeç e kanë plotësuar 34.60%, 7.7% e të anketuarëve tanë i përkasin moshës 41-50 vjeç dhe vetëm 1.9% kemi për moshën 51-60 vjeç.

• Pyetja 2: Gjinia e të anketuarve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	femër	41	78.8	78.8	78.8
	mashkull	11	21.2	21.2	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.3 Gjinia e të anketuarëve.

Burimi: Të dhënat primare.

Punonjësit që kanë plotësuar pyetësorin i përkisnin kryesisht gjinisë femërore, pra 41 punonjëse femra dhe 11 meshkuj.




Fig 2.4 Paraqitja grafike mbi gjininë e të anketuarëve.

Burimi: Të dhënat primare.

E shprehur me përqindje kemi që pyetësori është plotësuar nga: 21.20% meshkuj dhe 78.80% femra. Kjo nuk ishte vetëm një rastësi, por në bizneset e Shkodrës më të shumtë në numër janë punonjëset femra.

• **Pyetja 3: Pozicioni i të anketuarve në biznesin ku ato punojnë.**


		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	ekonomist	20	38.5	38.5	38.5
	menaxher	9	17.3	17.3	55.8
	kontabilist	11	21.2	21.2	76.9
	pozicion stafi	12	23.1	23.1	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.5: Pozicioni i të anketuarve në biznesin ku ato punojnë.

Burimi: Të dhëna primare.

Këtu kemi të rënditur pozicionet e të anketuarëve tanë, ku pjesa më e madhe janë ekonomistë, 20 prej tyre. Pas ekonomistëve kemi punonjësit në pozicion stafi, kontabilistë kemi 11 dhe 2 prej kontabilistëve mbajnë titullin Kontabël i Miratuar. Dhe të anketuarit më të paktë në numër janë menaxherët që janë vetëm 9 prej tyre.

Fig 2.6 Paraqitja grafike mbi pozicionin e të të anketuarve në biznesin ku ata punojnë.



Burimi: Të dhënat primare.

Të shprehur dhe me përqindje kemi 39% ekonomistë, 23% punonjës në pozicion stafi, 21% në pozicion kontabilisti dhe 17% e të anketuarve janë menaxherë.

- **Pyetja 4: Niveli i arsimit.**


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid nivel universitar	20	38.5	38.5	38.5
nivel pasuniversitar	32	61.5	61.5	100.0
Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.7 Niveli i arsimit

Burimi: Të dhënat primare

Niveli i arsimit për punonjësit që kanë plotësuar këtë pyetësor është 20 në nivel universitar dhe 32 në nivel pasuniversitar.

Fig2.8 Paraqitja grafike mbi nivelin e arsimit



Burimi: Të dhëna primare.

Ose e shprehur me përqindje 62% e të anketuarve janë në nivel pasuniversitar, shumica e tyre ishin me nivel masteri dhe nuk kishin interes apo kërkesa të vazhdonin studime më tutje. Dhe 38% e tyre ishin në nivel universitar.

- **Pyetja 5: Vitet në tregun e punës.**


		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1-5	21	40.4	40.4	40.4
	6-10	20	38.5	38.5	78.8
	11-20	10	19.2	19.2	98.1
	mbi 21	1	1.9	1.9	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.9 Vitet në tregun e punës.

Burimi: Të dhënat primare.

Siç e shohim edhe nga tabela eksperiencia më e përhapur e punës është 1-5 vjet, këta punonjës i përkisnin moshës së re dhe ishin komfort në pozicionin e tyre të punës.

Fig 2.10. Paraqitje grafike mbi vitet në tregun e punës.



Burimi: Të dhënat primare.

E shprehur me përqindje kemi që 40.4 % e punonjësve kanë 1-5 vjet punë dhe ajo më pak është mbi 21vjet punë që përfaqësohet nga 2% e të anketuarve.


- **Pyetja 6: Sektori i punës.**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid privat	52	100.0	100.0	100.0

Fig 2.11 Sektori i punës

Burimi: Të dhënat primare.

Fig24.12 Paraqitja grafike mbi sektorin e punës.



Burimi: Të dhënat primare.

Siç shihet edhe nga tabelat më lart punonjësit që pranuan t'i përgjigjen pyetësorit tonë i përkasin 100% sektorit privat.

4.2.3 Përmbledhje mbi ndikimin e aplikimit të teknologjive dhe sistemeve informative në kontabilitet

- **Pyetja 7: Aplikimi i teknologjive në kontabilitet ka rritur cilësinë e punës.**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid mesatarisht	7	13.5	13.5	13.5
dakord	21	40.4	40.4	53.8
shume dakord	24	46.2	46.2	100.0
Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.13 Ndikimi i teknologjisë në aspektin e cilësisë në kontabilitet.

Burimi: Të dhënat primare

Në pyetjen e radhës që lidhet me rritjen e cilësisë së punës nga aplikimi i teknologjisë në kontabilitet, 24 punonjës janë shumë dakord që SIT kanë rritur cilësinë e punës duke ulur gabimet në regjistrimin e transaksioneve dhe nxjerrjen e një rezultati të saktë.




Fig 2.14 Paraqitja grafike mbi ndikimin e teknologjisë në cilësinë e kontabilitetit.

Burimi: Të dhënat primare

Duke parë edhe grafikun e mësipërm asnjë nga 52 punonjësit nuk ka shënuar dy alternativat e para “aspakt dakord” dhe “nuk jam dakord” duke na lënë të kuptojmë që realisht aplikimi i teknologjisë në kontabilitet ka rritur cilësinë e punës duke dhënë rezultate të sakta.

- **Pyetja 8: Aplikimi i teknologjive në kontabilitet ka ndikuar në kryerjen e sa më shumë detyrave në një kohë më të shkurtër.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	mesatarisht	12	23.1	23.1	23.1
	dakord	22	42.3	42.3	65.4
	shume dakord	18	34.6	34.6	100.0
Total		52	100.0	100.0	

Fig 2.15 Ndikimi i teknologjisë në kohën e punës

Burimi: Të dhënat primare.

Duke parë dhe tabelën e mësipërme shohim që punonjësit janë dakord që SIT kanë ndihmuar në kryerjen e më shumë detyrave në kohë më të shkurtër

gjë që kjo ndikon edhe në efektivitetin e punës. Janë 12 punonjës që janë përgjigjur mesatarisht dakord duke na lënë të kujtojmë që SIT nuk kanë bërë ndonjë ndryshim të madh në punën e tyre. Dhe shumë dakord janë përgjigjur 18 punonjës.




Fig 2.16 Paraqitja grafike e ndikimit të teknologjisë në kohën e punës.

Burimi: Të dhënat primare.

Ashtu edhe si në rastin e mëparshëm dy alternativat e para nuk janë përzgjedhur nga punonjësit, duke treguar se SIT ndikon procesin e punës duke reduktuar punën.

- **Pyetja 9: Sistemet informative në kontabilitet janë komplekse.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak dakord	1	1.9	1.9	1.9
	nuk jam dakord	10	19.2	19.2	21.2
	mesatarisht	19	36.5	36.5	57.7
	dakord	12	23.1	23.1	80.8
	shume dakord	10	19.2	19.2	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.17 Kompleksiteti i sistemeve informative në kontabilitet.

Burimi: Të dhënat primare.

10 punonjës janë shumë dakord që sistemet informative në kontabilitet janë komplekse, ata kanë treguar se shpeshherë gjejnë vështirësi në gjetjen e

opsioneve apo ikonave të duhura gjatë punës. Dhe vetëm një person ka dhënë përgjigjen që këto programe nuk janë komplekse dhe se duhet vetëm vëmendje gjatë punës me to.




Fig 2.18 Paraqitja grafike e kompleksitetit të sistemeve informative në kontabilitet.

Burimi: Të dhënat primare

36.5% punonjësve janë mesatarisht dakord që sistemet informative në kontabilitet janë komplekse duke zënë dhe peshën më të madhe të përgjigjeve e pasuar nga përgjigjja dakord me 23.1%.

• **Pyetja 10: Sistemet informative në kontabilitet kanë mangësi.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak dakord	4	7.7	7.7	7.7
	nuk jam dakord	7	13.5	13.5	21.2
	mesatarisht	19	36.5	36.5	57.7
	dakord	15	28.8	28.8	86.5
	shume dakord	7	13.5	13.5	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.19 Mangësitë e sistemeve informative në kontabilitet.

Burimi: Të dhënat primare.

Shumica e punonjësve janë mesatarisht dakord që sistemet informatike në kontabilitet kanë mangësi, ata treguan se do të donin që këto sisteme të kishin një opsion në sistemin financiar i cili tregon në mënyrë direkte artikullin më të shitur në market apo një opsion i cili shfaq në mënyrë të

menjëhershme datën e maturimit në lidhje me pagesën e një furnitori dhe në lidhje me ndryshimin e çmimit të shitjes së një artikulli, të ketë akses vetëm financiarë lidhur me magazinën përkatëse.




Fig 2.20 Paraqitja grafike e mangësive të sistemeve informative në kontabilitet.

Burimi: Të dhënat primare.

Pra shohim edhe nga grafiku se 7.7% e të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord dhe 13.5% janë përgjigjur nuk jam dakord këta të anketuar kishin si nivel arsimit pasuniversitar. Kjo tregon se niveli i lartë i arsimit ndihmon në përdorimin e këtyre sistemeve.

- **Pyetja 11: Këto sisteme rrisin produktivitetin e punonjësve.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak dakord	6	11.5	11.5	11.5
	nuk jam dakord	6	11.5	11.5	23.1
	mesatarisht	17	32.7	32.7	55.8
	dakord	12	23.1	23.1	78.8
	shume dakord	11	21.2	21.2	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.21 Ndikimi i sistemeve informative në produktivitetin e punonjësve.

Burimi: Të dhënat primare.

Nga tabela shohim se kryesisht këto sisteme rrisin nivelin e produktivitetit tek punonjësit. Disa nga punonjësit nuk mund ta kenë të kuptueshme shumë mirë manualisht se si funksionon kontabiliteti apo regjistrimet e transaksioneve dhe tregojnë që këto sisteme i kanë ndihmuar për të kuptuar më shumë rreth kontabilitetit dhe i kanë motivuar për të kryer punën.




Fig 2.22 Paraqitja grafike e ndikimit të sistemeve informative në produktivitetin e punonjësve.

Burimi: Të dhënat primare.

Mesatarisht dakord është përgjigjja më e zgjedhur nga të anketuarit me 32.7% duke treguar se këto sisteme i vijnë në ndihmë punonjësve për të kryer një punë më efektive.

- **Pyetja 12: Bizneset ndërmarrin veprime për trajnimin e punonjësve për përdorimin e sistemeve informatike.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak dakord	1	1.9	1.9	1.9
	nuk jam dakord	8	15.4	15.4	17.3
	mesatarisht	10	19.2	19.2	36.5
	dakord	20	38.5	38.5	75.0
	shume dakord	13	25.0	25.0	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.22 Trajnimi i punonjësve mbi sistemet informative.

Burimi: Të dhënat primare.

Shumica e bizneseve në Shqipëri ndërmarrin veprime që lidhen me trajnimet e punonjësve, kryesisht bankat. Vetëm një i anketuar është përgjigjur aspak dakord dhe 13 janë përgjigjur shumë dakord.




Fig 2.23 Paraqitja grafike e trajnimit të punonjësve mbi sistemet informative.

Burimi: Të dhënat primare

Përqindjen më të lartë të përgjigjeve e mban përgjigjja dakord me 38.5% e pasuar me përgjigjen shumë dakord me 25%.

• **Pyetja 13: Faktorët që ndikojnë në cilësinë e SIK.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	mjedisi i jashtem, mjedisi i brendshem, cilesia e te dhenave, edukimi dhe formimi profesional	8	15.4	15.4	15.4
	mjedisi i jashtem	4	7.7	7.7	23.1
	mjedisi i brendshem	6	11.5	11.5	34.6
	cilesia e te dhenave	14	26.9	26.9	61.5
	edukimi dhe pervoja e punes	20	38.5	38.5	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.24 Faktorët që ndikojnë në cilësinë e SIK.

Burimi: Të dhënat primare.

Në përngjasim me rastin e shqyrtuar për të gjithë Republikën e Shqipërisë edhe vetëm për qytetin e Shkodrës kemi arritur në përfundimin që edukimi dhe përvoja e punës ndikojnë më së shumti në cilësinë e SIK. Kjo tregon se mësimi në universitete, kurset, trajnimet, por edhe eksperiencat në tregun e punës na ndihmojnë të përdorim më së miri SI. E pasuar kjo zgjedhje me cilësinë e të dhënave, që do të thotë në bazë të cilësisë së tyre rritet dhe cilësia e një pune të kryer duke përdorur SIK.




Fig 2.25 Paraqitja grafike e faktorëve që ndikojnë në cilësinë e SIK.

Burimi: Të dhënat primare

Ose e shprehur me përqindje themi se 38.5% kanë zgjedhur edukimi dhe përvoja e punës, 26.9% kanë zgjedhur cilësia e të dhënave dhe vetëm 7.7% kanë zgjedhur mjedisin e jashtëm, kjo është dhe alternative më pak e zgjedhur. Kjo tregon se politikat qeveritare, legjislati apo konkurrenca nuk ndikojnë mjaftueshëm tek cilësia e SIK.

- **Pyetja 14: Avantazhi më i madh i fiskalizimit.**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	parandalon rënien ekonomike	21	40.4	40.4	40.4
	kontroll me te mire ndaj punetoreve	22	42.3	42.3	82.7
	kontroll me te mire ndaj financave	9	17.3	17.3	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.26 Avantazhi më i madh i fiskalizimit.

Burimi: Të dhënat primare.

Ndryshe nga rasti i Kroacisë në Shkodër avantazhi më i lartë i sistemeve të fiskalizimit është kontrolli më i mirë i punëtorëve, për të shmangur “hilet” gjatë punës, e pasuar kjo nga parandalimi i rënies ekonomike të vendit dhe avantazhi i fundit njësoj si Kroacia është kontrolli më i mirë ndaj financave.



Fig 2.27 Paraqitja grafike e avantazhit më të madh të fiskalizimit.

Burimi: Të dhënat primare.

40.4% e të anketuarve zgjedhën parandalimin e rënies ekonomike dhe me një diferencë të vogël 42.3% e tyre zgjedhën kontroll më të mirë të punonjësve.

• **Pyetja 15: Disavantazhi më i madh i sistemeve të fiskalizimit.**


		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	kosto te larta	27	51.9	51.9	51.9
	stres psikologjik per shkak te problemeve teknike	25	48.1	48.1	100.0
	Total	52	100.0	100.0	

Fig 2.28 Disavantazhi më i madh i sistemeve të fiskalizimit.

Burimi: Të dhënat primare.

Ndryshe nga rasti i parë këto rezultate i përngjasojnë rastit të Kroacisë, ku me një diferencë të vogël të anketuarit shohin si disavantazh të sistemeve të fiskalizimit kostot që duhen për instalimin apo riparimin e tyre.

Fig 2.29 Paraqitja grafike e disavantazhit më të madh të sistemeve të fiskalizimit.



Burimi: Të dhënat primare.

E shohim edhe nga grafiku që diferenca është mjaft e vogël, bizneset që kishin probleme me internetin zgjodhën stresin psikologjik ndërsa pjesa tjetër kosto të larta.

BIBLIOGRAFIA

- Alenka Tot (2014): Implementation of Cash Transaction Fiscalization Procedure in Businesses: Case of Croatia.
- Butler, John E (2008): Innovate with Complex Information Technologies: A Theoretical Model and Empirical Examination, The Journal of Computer Information System: Fall, Vol.49, No.1, ProQuest Computing, p. 27-36.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: Fiskalizimi
- Elham B (2011): The Impact of IT on Modern Accounting System.
- Georghiou L, and Rossner D (2000): Evolving technology programs tools and methods, 657-678.
- Hasan, Bassam (2007): Examining the Effect of Computer Self-Efficacy and System Complexity on Technology Acceptance, Information Resources Management Journal, Vol. 20, p 76-88.
- Hendrickson, Harvey (2009) "Accounting. " Encyclopedia of Business and Finance".
- Hysen Hoda (2015): Faktorët që ndikojnë në rritjen e cilësisë së Sistemit të Informacionit Kontabël. Rasti i bizneseve në Shqipëri.
- Micheal J. Handel (2013): Implications of information technology for employment, skills and wages: A review of recent research.
- Reene Greene (2017): The Impact of Information Technology on Jobs.
- Surbhi S (2018): Diference Between Manual and Computerized Accounting.
- Yacht, C. (2008). Computer accounting with Peachtree Complete 2008, Release 15. 0 (12th ed) New York: McGraw-Hill.

BANESA E PASHKO VASËS SI PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE E QYTETIT SHKODËR

¹Fatjon Mlloja, Sabrina Kuçi²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Turizmit
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër*

ABSTRAKT

Ky punim trajton trashëgiminë kulturore materiale, konkretisht banesën ku lindi Pashko Vasa. Qëllimi kryesor i punimit është të identifikojë vlerat kulturore materiale që lidhen me banesën dhe vlerat jomateriale që lidhen me figurën dhe veprimtarinë e Pashko Vasës. Tipologjia e kësaj banese është ajo e banesës me “çardak” në ballë, e cila ishte varianti më i përhapur në Shkodër. Ky studim provon se kjo banesë shquhet për shkallën e lartë të mjeshtërisë me të cilën ajo është realizuar, për ndërthurjen harmonike të materialit natyror “gur” dhe atij vegjetal “dru”, si dhe për elementet dekorative të ambienteve të brendshme. Ndryshimet e viteve 90’, ndikuan negativisht te kjo banesë, duke e bërë atë të harrohet nga komuniteti lokal. Shkaku për këtë është i dyanshëm: mos pozicionimi brenda zonës historike të qytetit dhe mungesa e sinjalistikës. Metodologjia e përdorur është ajo e

¹ M. Sc. Fatjon Mlloja ka kryer studimet bachelor pranë Universitetit të Palermos- Itali në degën “Restaurim, Rikuperim dhe Rikualifikim të Arkitekturës” në vitin 2014. Më pas në vitin 2016 ka përfunduar studimet Master Shkencor në “Trashëgimi Kulturore”, Universiteti i Shkencave të Aplikuara “Anhalt”, Gjermani. Ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në fushën e restaurimit dhe të trashëgimisë kulturore. Aktualisht punon si specialist arkitekt restaurator pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, sektori i Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. Që nga viti 2019 është i angazhuar si pedagog i jashtëm pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, departamenti i Turizmit.

² M. Sc. Sabrina Kuçi ka përfunduar studimet e larta 5-vjeçare në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës në degën Urbanistikë, Tiranë. Pas përfundimit të studimeve të larta ka punuar për një periudhë 4-vjeçare, pranë Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, në pozicione të ndryshme duke filluar si specialiste deri tek Përgjegjëse për Sektorin e Legalizimit dhe Urbanizimit. Sot, prej 3 vitesh, punon si specialiste arkitekte pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Sektorin e Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. Përgjatë viteve ka marrë pjesë në trajnime, projekte dhe konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

rishqyrtimit të literaturës dhe analizës krahasuese të të dhënave, pasi evidenton ndryshimet nga projektet e mëparshme të restaurimit dhe konservimit. Ky studim ka si qëllim të provojë që kjo banesë është një ndër shembujt e paktë jo të tjetërsuar të banesës shkodrane, dhe si e tillë ajo duhet të ruhet. Falë vlerave të saj arkitekturore, kjo shtëpi duhet të përfshihet në guidën turistike të qytetit si një destinacion i ri vizitash për turistët, prandaj duhet të vendosen tabela informuese që tregojnë vendndodhjen e saj. Ndër të tjera, duhet konsideruar mundësia e adoptimit të kësaj banese në muze siç ka qenë para viteve 1990.

Fjalët kyçe: Trashëgimi, Banesa shkodrane, Pashko Vasa, Arkitekturë, Turizëm.

**Pashko Vasa's house as part of the tangible cultural heritage
of Shkodra city**

ABSTRACT

This paper focuses on the tangible cultural heritage, specifically, Pashko Vasa's house in Shkodra. The purpose of this paper is to identify the tangible values related to the building itself and the intangible values associated with the figure and the activity of Pashko Vasa. The typology of this house is that of a "porch-house", a house with a porch placed in the front, the most common typology of houses in Shkodra. This paper reveals that this house is distinguished for the high degree of craftsmanship, the harmonious combination of natural material "stone" and plant material "wood", as well as the decorative elements of the interiors. The changes of the 90s had a negative impact on this house by putting it into oblivion, out of the attention of the local community. The reason for this is two-fold, its location out of the historic area of the city and the lack of a signpost. The methodology used is that of the literature review and data comparative analysis as it brings to the fore changes from previous restoration and conservation projects. This paper intends to prove that this house is one of the few unaltered examples of Shkodra's traditional house and as such it should be preserved. Thanks to its significant values, this house should be included in the tourist city guide as a new tourist destination, therefore, a signpost indicating the house location should be placed. Besides, a possible adaptation of the house into a museum, just as it used to be before the 1990s, should be considered.

Key words: Heritage, Shkodra's traditional house, Pashko Vasa, Architecture, Tourism.

Hyrje

Për arkitekturën e banesës shkodrane dhe vlerat e saj arkitektonike ka shkrime të shumta nga arkitektë, studiues dhe ekspertë në fushën e trashëgimisë kulturore. Banesa tradicionale që ruajnë karakteristika arkitektonike në qytetin e Shkodrës janë të shumta, një ndër këto është edhe ajo ku lindi rilindasi Pashko Vasa. Qëllimi i këtij shkrimi shkencor është të paraqesë në mënyrë më specifike vlerat, ndërhyrjet restauruese dhe rëndësinë e banesës së Pashko Vasës për qytetin e Shkodrës. Çështjet që ky punim trajton janë: Vështrim i shkurtër mbi zhvillimin e banesës shkodrane, Pashko Vasa si figurë e shquar kombëtare, Rast studimor mbi banesën e Pashko Vasës, Vështrim kronologjik i ndërhyrjeve restauruese dhe përfundimet. Metodologjia e përdorur është ajo e rishikimit të literaturës përsa i përket kësaj banese dhe nga analizimi in situ i banesës.

Vështrim i shkurtër mbi zhvillimin e banesës shkodrane

Ndërtimet në qytetin e Shkodrës u përkasin periudhave të ndryshme dhe ato datojnë që nga periudha ilire deri në ditët e sotme. Lagjet përreth kalasë “Rozafa” formonin qytetin e vjetër i cili shtrihej në veriperëndim me ndërtime të ngritura mbi rrënoja të ndërtimeve të periudhës ilire, romakobizantine, veneciane pa harruar edhe ato të periudhës osmane (Bushati, 1998). Sipas Dibrës (2018) pikërisht në lagjet përreth kalasë kanë filluar të ndërtohen dhe banesat e para popullore.

Fjala banesë së pari përmendet tek Bogdani si “të bana”, dhe tregon një ndërtim brenda të cilit jeton familja (Çabej, 1976, cituar në Riza, 2009, fq. 141). Sipas Rizës (2009) ndërtimi i banesës për qëllime strehimi të bashkësive familjare, ka fillesa shumë të largëta në kohë dhe evoluon paralelisht me zhvillimin e jetës njerëzore. Krahas tipologjisë së banesës në trashëgiminë arkitektonike të qytetit përfshihen dhe ndërtimet e karakterit social, si: hanet, veprat e kultit, pusët etj. (Dibra, 2018). Në Riza (2009) përsa i përket banesës qytetare shqiptare analizuar duke u bazuar nga ana kompozicionale mund të dallohen disa nën tipologji të ndryshme ku bën pjesë dhe banesa me çardak tipike për qytetin e Shkodrës. Kjo tipologji banese zhvillohet në qytetet shqiptare të shek. XV-XIX. Elementi “çardak” në shpërndarjen planimetrike të hapësirave është një element i njohur në artikullimin e hapësirës jo vetëm në atë mesdhetare, por dhe më gjerë (Riza, 2016). Tipologjia e këtij ndërtimi përmendet që në Regjistrin e Kadastrës të vitit 1416 ku cekën disa të dhëna banesash, dëshmi kjo e ndërtimit të saj të pandikuar paçka ardhjes së turqve pas vitit 1479 dhe fillimin e ndërtimeve

në stilin e tyre (Dibra, 2018). Një nga faktorët kryesorë për përhapjen e kësaj tipologjie banese, sigurisht është edhe zgjerimi i qytetit në shekullin e XVIII-XIX duke krijuar kështu hapësirat e nevojshme për implementimin e saj (Riza, 2009). Kjo tipologji banimi ka qenë mbizotëruese në Shkodër si rezultat i ndryshimit të jetës shoqërore dhe rëndësisë që mori banesa si njësi kryesore e jetës shoqërore (Luzati, 1998). Banesa me çardak së bashku me një numër zgjidhjesh planimetriko-arkitektonike vazhdoi të ndërtohej deri në gjysmën e parë të shek. XIX dhe u bë strehë edhe për shtresën e mesme të asaj kohe (Riza, 2009). Në kontekstin e një ekonomie feudale ku secila familje siguronte të ardhura për të jetuar nga puna individuale e secilit anëtar, banesa duhej të mbulonte disa aspekte: atë të strehimit të familjeve me pjestarë të shumtë, aspektin bujqësor dhe blegtoral si kultivimin e krimbit të mëndafshit ose mbjelljes së perimeve dhe frutave, shfrytëzimin e ahureve për mbajtjen e bagëtive të imta dhe të trasha, aspektin mikpritës me krijimin e ambientit të dhomës së miqve, aspektin relaksues duke i kushtuar vëmendje mirëmbajtjes dhe dekorimit të oborreve me lule, gryka pusi të gdhendura etj. (Dibra, 2018). Elemente karakteristike të banesës shkodrane në përgjithësi janë: dimensionet e saj të mëdha, kemi të bëjmë kryesisht me ndërtim dykatësh dhe ajo çfarë bie në sy është streha e dalë e çatisë e cila shërben si për mbrojtje nga shiu, por edhe për të krijuar hije (Parruca, 2001). Element tjetër dallues është vendosja planimetrike e banesës në një truall të gjerë rrethuar nga të katër anët me mure (Riza, 1972). Fasada kryesore e banesës është e orientuar nga ana jugore ku përpara saj ndodhet oborri i dekoruar me lule, ndërsa në pjesën e pasme kryesisht ose në atë anësore kultivohen perime stinore (Parruca, 2001).

Pashko Vasa – figurë e shquar kombëtare.

Pashko Vasa u lind në Shkodër me 17 shtator 1825, në një familje me origjinë nga Mirdita. Studimet e para i kreu në vendlindje. Kontributi i tij njihet në fushën e letërsisë me veprat si “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” e përkthyer në shqip nga Mehdi Frashëri, përmbledhjen me poezi italisht “Rose e spine” përkthyer në shqip “Trëndafila dhe gjemba”, “Bardha e Temalit”, “Bosnja dhe Hercegovina gjatë misionit të Xhevdet Efendiut”, “Skicë historike mbi Malin e Zi sipas traditave të Shqipërisë”, veprën në gjuhën frënge “Gramatika e shqipes”. Duhet nënvizuar fakti se kontributi i tij nuk është fokusuar vetëm në fushën e letërsisë. Ai ka dhënë një kontribut domethënës edhe në fushën politike. Që në moshë të re, rreth të njëzetave, vihet re angazhimi i Pashko Vasës si sekretar i Konsullatës Britanike, duke e shfrytëzuar si mundësi për të përmirësuar aftësitë e tij.

Karriera e tij ushtarake zë fill pas vitit 1847, vit i cili shënon edhe largimin e tij nga Shqipëria. Që nga ky vit e deri në 1892, kur edhe ndërroi jetë, për shkak të detyrave dhe posteve të ndryshme ka lëvizur në vende të ndryshme, si: në Stamboll, Bosnje, Beirut etj. Një çështje me rëndësi të veçantë për të ishte mbrojtja e të drejtave të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, kontributin e të cilit e shohim përgjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit, ku dhe ka qenë një zë i fuqishëm në memorandumet apo protestat e kohës. Së bashku me të tjera figura të rëndësishme të Shqipërisë, si Jani Vreto, Hasan Tahsin etj., luajtën një rol të rëndësishëm në krijimin e një alfabeti të vetëm shqip. Sot, përveç gjithë këtyre veprave, kemi dhe një tjetër pasuri të trashëguar nga Pashko Vasa, banesa ku ai lindi dhe kaloi vitet e para të rinisë së tij.

Rast studimor: banesa e Pashko Vasës

Sipas Feilden (2003) një ndërtesë historike, është ai ndërtim që na lë të mahnitur dhe na shtyn që të dimë më shumë për njerëzit dhe kulturën që e ka ndërtuar atë. Ajo ka një sërë vlerash nga ato arkitekturore, historike, arkeologjike estetike, sociale, politike, ekonomike ashtu si dhe ato shpirtërore dhe simbolike.

Një shembull mjaft i mirë i ndërthurjes së vlerave historike, socialkulturore dhe arkitektonike është banesa e Pashko Vasës në Shkodër. Shtëpia ku lindi Pashko Vasa është një ndërtim arkitektonik i shekullit XVIII-XIX me status Monument Kulture i kategorisë së parë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me numër vendimi 1886, datë 10.06.1973. Kjo është shtëpia e familjes ku Pashko Vasa kaloi rininë e tij, shtëpi të cilën do ta trashëgonte vëllai i tij pas largimit të tij nga Shqipëria (Prifti, 1978). E ndodhur në pjesën lindore të qytetit, konkretisht në lagjen Perash banesa kufizohet ende nga ndërtime të tjera të ngjashme që krijojnë atmosferën e lagjeve të shekullit XIX. Ashtu siç ka ndodhur dhe me banesat e tjera të qytetit, ndryshime të ndodhura në kohë të elementëve arkitektonikë dhe estetikë ka pësuar dhe kjo banesë (Prifti, 1978). Në genplanin e paraqitur në figurën 1, vërejmë se banesa shkodrane është e dimensioneve të mëdha me një zhvillim horizontal planimetrik. Duke iu referuar genplanit (Fig.1) mund të themi me përafërsi se 2/3 e gjithë sipërfaqes së tokës i dedikohet kultivimit të perimeve dhe pemëve frutore, ndërsa 1/3 e zë sipërfaqja e shtëpisë.

Fig. 1. Genplan i banesës.**Burimi: Harta nga ASIG, përpunuar nga autorët.**


Banesa është e rrethuar nga mure perimetrale të lartë prej guri, dhe një mur ndarës i një lartësie më të ulët i pajisur me një derë të vogël “arkapi” (Dibra, 2018) që lidh oborrin me kopshtin, duke krijuar kështu dy ambiente të ndara. Bahçja për përdorim familjar dhe oborri para shtëpisë si ambient dekorativ, relaksues dhe rekreativ. Porta hyrëse dykapakëshe prej druri që të shpie në banesë është e ndërtuar me qemer guri dhe e pajisur me çati dy ujëse me strehë të gjerë. Pjesa e oborrit përpara shtëpisë është e pajisur me elemente karakteristike që banesa shkodrane ka, si lugu, pusi (Fig. 2). Referuar tipologjive të banesave, kjo banesë përfshihet tek banesat me çardak të pozicionuar në ballë të saj siç shihet dhe në figurat më poshtë. Kemi të bëjmë me një ndërtim dykatësh, ku materiali kryesor i ndërtimit është guri dhe lënda drusore. Muret e katit përdhe arrijnë trashësi të konsiderueshme deri në 65 cm, ndërtuar me gur kave dhe lumi lidhur me llaç gëlqere (Prifti, 1978). Përsa i përket anës funksionale, banesa nuk ka ndryshim me banesat e tjera të kësaj periudhe ku në katin përdhe janë vendosur ambientet ndihmëse dhe në të parin ato të banimit. Katet e banesës lidhen me njëra-tjetrën me shkallë druri me një rampë, ku këmbët e para janë rrethore prej guri të latuar.

Fig. 2. Foto aktuale e fasadës kryesore të banesës.



Burimi: Foto e autorëve.


Fig. 3. Vizatim i fasadës kryesore (jo në shkallë).



Burimi: Arkivi IKTK Tiranë. Fletë teknike nga projekti i restaurimit i vitit 1976-1978, hartuar nga Ark. Shpresa Prifti. Rivizatim i autorëve.

Përsa i takon kompozimit planimetriko-volumor (Fig. 4, 5), banesa përbëhet nga tri volume të formës së çrregullt. Shkak për këtë janë bërë shtesat dhe ndryshimet që janë bërë ndër vite.

Fig. 4. Planimetria aktuale e katit përdhe (jo në shkallë).



Burimi: Arkivi IKTK Tiranë. Fletë teknike nga projekti i restaurimit i vitit 1976-1978, hartuar nga Ark. Shpresa Prifti. Rivizatim i autorëve.

Siç shihet sipër tek Fig. 4, element kryesor i katit përdhe, është hajati i cili lidh ahurin në pjesën e mbrapme me ambientin e krahut të djathtë. Hyrja në ahurin e krahut të djathtë bëhet nëpërmjet një dere me qemer guri me hark të sheshtë. Sipërfaqja e ahureve dhe e hajatit është e shtruar me kalldrëm. Në krahun e majtë gjenden ambientet që përdoren për banim. Volumi i parë në krah të majtë komunikon me ahurin mbrapa nëpërmjet një dere.

Çardaku në katin e parë zë vendin e hajatit në katin përdhe përsa i takon shpërndarjes së ambienteve dhe artikulimin e planimetrisë. Në këtë kat gjenden 5 ambiente: 3 në pjesën e përparme dhe 2 në pjesën e mbrapme.

Vendin e kolonave të gurit, në pjesën e çardakut e zënë shtyllat prej druri (Fig. 3) të cilat lidhen me njëra-tjetrën nga arkitrarë druri të pajisur me

jastekë të gdhendur (Riza, 1972). Muret ndarës në këtë kat janë kryesisht mur çatme që konsiston në skelet druri me shtylla kryesore mbajtëse çdo 2 m dhe elementë vertikalë lidhës të suvatuara me llaç me përzierje kashte si dorë e parë dhe me llaç gëlqereje për drejtim të sipërfaqes.

Fig. 5. Planimetria aktuale e katit të parë (jo në shkallë).



Burimi: Arkivi IKTK Tiranë. Fletë teknike nga projekti i restaurimit i vitit 1976-1978, hartuar nga Ark. Shpresa Prifti. Rivizitim i autorëve.

Referuar figurës 5, mund të themi se në këtë kat ndodhen ambientet më përfaqësuese të banesës. Ambienti në të djathtë “Oda e miqve” është ai më karakteristik përse i përket trajtimit arkitektonik të hapësirës, por edhe përse i përket elementeve dekorative. Sapo hyn në këtë dhomë vihet re oxhaku dekorativ me allçi (Fig. 6) dhe në pjesën fundore të dhomës gjendet elementi karakteristik prej druri të gdhendur musandër-trapazan (Fig. 7). Hijeshinë kësaj dhome ia shton edhe tavanit tip kazan (Prifti, 1978) siç shihet në Fig. 8 ku pjesa qendrore e tij ka formë tetëkëndëshi dhe është e ndërtuar në stuko relief dhe konturohet nga dërrasa të gdhendura ku gjithashtu në secilën qoshe gjendet nga një trekëndësh i gdhendur. Pjesa qendrore e tavanit është e ndërtuar me dërrasë të thjeshtë.

Fig. 6. Foto e oxhakut




Burimi: Foto e autorëve.

Fig. 7. Foto e volumit musandër-trapazan.



Burimi: Foto e autorëve

Fig. 8. Foto e tavanit



Burimi: Foto e autorëve

Ambient tjetër që paraqet elemente dekorative me rëndësi është “Oda e mirë”. Element kryesor është tavanit i dekoruar, ku pjesa qendrore tetëkëndëshe është e dekoruar me rombe dhe në qendër ka një rozetë tetëkëndëshe të gdhendur me shumë finesë. Edhe këtu në të katër qoshet e tavanit gjenden trekëndësha të gdhendur me shumë mjeshtëri (Fig. 9).

Fig. 9. Foto e tavanit



Burimi: Foto e autorëve

Pjesë e dekoracionit të dhomës është edhe rafti i gdhendur i murit. Ambienti i “Odës së zjarrit” nisur edhe nga funksioni i tij nuk ka elemente dekorative (Prifti, 1978). Karakteristikë tjetër është edhe qoshku i ngritur mbi nivelin e dyshemesë së çardakut.

Fig. 10. Foto e qoshkut.



Burimi: Foto e autorëve.

Vështrim kronologjik i ndërhyrjeve restauruese

Projektet e konservimit dhe restaurimit përsa i takon gjinisë së banesës, janë bërë paralelisht me evidentimin dhe listimin me status mbrojtje për vlera të spikatura formale dhe estetike. Këto ndërhyrje sipas Dibrës (2018) u intensifikuan edhe më tepër me krijimin në vitin 1965 të institucionit të Monumenteve të Kulturës (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore sot). Ndër vite banesa ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme restauruese, konservuese. Në shpjegim të kësaj termi "*Restaurim*" është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. (Ligji nr.27/2018).

Banesa e marrë në studim në aspektin ligjor, është në pronësi të personave fizikë privat (neni 4, ligji nr.27/2018). Si e tillë bazuar në ligjin nr.27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” shprehet qartazi në

nenet 21 dhe 22 të drejtat dhe detyrimet që i linden pronarëve apo poseduesve të Pasurive Kulturore³, Monumente Kulture të Kategorisë së Parë⁴ Ndërhryjet në këto pasuri me vlera kulturore, arkitektonike apo urbanistike kryhen nga institucione të specializuara, referuar legjislacionit në fuqi. Në shpjegim të kësaj institucioni rajonal i specializuar, tekniko-administrativ, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore është Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër


Ndërhryja restauruese e vitit 1976-1978, projektuar nga Ark. Shpresa Prifti, ka ndryshuar formën e banesës në tërësi. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i një faze studimore kryer nga vetë ajo, duke studiuar, vrojtuar dhe duke bërë sondazhe sipas rastit (Prifti, 1978). Në përfundim të fazës studimore të kryer për të gjithë banesën, rezultoi se ajo mund të ketë tri faza ndërtimi (Fig. 11). Fazës së parë të ndërtimit i përket seksioni në të majtë, ku vihet re se teknika e ndërtimit është më e hershme se sa pjesa tjetër. Faza e dytë është pjesa e pasme dhe pjesa qendrore deri te kolona e dytë. Faza e tretë është seksioni në të djathtë i objektit, i cili nuk ka vetëm faza të ndryshme ndërtimi, aty gjejmë edhe rikonstruksione në ambientet e çardakut dhe të ambienteve karakteristike të katit të banimit (Prifti, 1978). Këto pohime Prifti i bazon në pesë argumente që dalin si rezultat i krahasimit të mënyrës së ndërtimit të banesës më çardak në përgjithësi, të volumit të ndërtuar, organizimit planimetriko-volumor, elementeve të ndryshme që kanë dalë në pah gjatë studimit.

Po të hedhim një vështrim mbi gjendjen ekzistuese të planimetrisë para këtij restaurimi vërejmë se ahuri ashtu si dhe ambientet e banimit kanë pësuar shumë ndryshime, duke u ndarë në kthina, korridore apo ambiente më të vogla për të plotësuar nevojat e kohës për familjen. Ndaj pas fazës studimore ndërhryja u bë në dy drejtime: njëri ishte ruajtja e elementeve që mbartin vlera dhe që kishin lidhje organike me objektin dhe tjetri në rast kur nuk plotësohej ky kusht ato elemente u hoqën.

³ “Pasuri kulturore materiale” është tërësia e pasurive të luajshme e të paluajshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51, të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve – Ligji nr.27, datë 17.05.2021

⁴ “Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen – Ligji nr.27, datë 17.05.2021.

Fig. 11. Planimetria e Katit përdhe, evidentim i ndryshimeve 1976-1978.




Burimi: Arkivi IKTK Tiranë. Fletë teknike nga projekti i restaurimit i vitit 1976-1978, hartuar nga Ark. Shpresa Prifti. Rivizitim i autorëve.

Referuar kësaj logjike veprimi, ndryshimi kryesor, ishte kthimi i dy ambienteve qendrore në formën e tyre fillestare, pra të hajatit dhe të çardakut (Figura 12). Ndërtimi i këtij të fundit u realizua në afërsi të dhomës së miqve dhe u pajis me qoshkun, element karakteristik i tij (Prifti, 1978). Ambientet në të majtë të objektit, që i korrespondojnë edhe fazës së parë të ndërtimit u kthyen në oda zjarri. Gjithashtu u shtua një dritare në fasadën kryesore të këtij seksioni. Në pjesën e pasme ndryshimet e bëra sollën krijimin e dy ambienteve, “Oda e zjarrit” dhe “Oda e mirë. Në “Odën e zjarrit” kemi ndërtimin sipas gjurmëve ekzistuese të oxhakut, të raftit të murit apo kamares së derës. Te ambientet e seksionit në të djathtë të objektit kemi heqjen e mureve ndarës dhe krijimin e një ambienti të vetëm për “Odën e miqve”. Në këtë dhomë kemi ndërtimin e një oxhaku, dekori dhe forma e të cilit i përshtatet oxhaqeve karakteristike të kohës ndërtuar në ambiente të ngjashme. Në katin përdhe të këtij seksioni kemi heqjen e të

gjithë mureve të brendshme, duke krijuar kështu një hapjat të hapur, të suvatuar sipas teknikës të kohës (Prifti, 1978).

Fig. 12. Planimetria e Katit të parë, evidentim i ndryshimeve 1976-1978.



Burimi: Arkivi IKTK Tiranë. Fletë teknike nga projekti i restaurimit i vitit 1976-1978, hartuar nga Ark. Shpresa Prifti. Rivizitim i autorëve.

Gjatë këtij restaurimi u bënë edhe shumë punime të tjera, si: suvatimi i mureve të jashtme, rindërtimi i dyshemesë, rikonstruksioni i çatisë, restaurimi i dritareve të drurit, rindërtim i shkallës së drurit në ambientet e jashtme, sistemimi i oborrit apo elementeve karakteristike të pozicionuara aty, si lugu, pusi etj., restaurimi i kalldrëmit të hajatit.

Pas zbatimit të këtij projekti të plotë restaurimi dhe me shumë rëndësi për banesën, ky objekt u përdor si muze në prag të 100- vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Tri nga dhomat karakteristike e me vlera arkitektonike të banesës u vunë në funksion të muzeut. Ambienti i parë i kushtohej periudhës së Rilindjes me dokumentet në lidhje me këtë periudhë. Ambienti i dytë trajtonte mbrojtjen e territorit të Plavës e Gucisë nga shkodranët.

Ambienti i tretë i dedikohet Pashko Vasës, veprës dhe kontributit të tij. Ky muze ka funksionuar deri rreth viteve 1990 (Bushati, 1998).

Ndërhyrjet restauruese dhe punimet mirëmbajtëse kanë qenë të vazhduara në këtë banesë, projektet e të cilës janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe financuar përmes fondeve të buxhetit të shtetit. Të tilla ndërhyrje janë ato të vitit 2010, 2012 dhe 2018. Në secilin nga këto projekte të miratuara dhe zbatuara punimet kanë pasur karakter mirëmbajtës. Në vitin 2010 ndërhyrjet janë fokusuar tek çatia, shkalla e jashtme e drurit së bashku me parmakun, çardaku dhe suvatime në disa ambiente të shtëpisë. Vlen të theksohet fakti se këto ndërhyrje kanë qenë në zona të ndryshme të banesës, në varësi të shkallës së degradimit, konstatuar nga specialistët të cilët kanë hartuar projektin. Në vazhdim të kësaj ndërhyrjeje, në vitin 2012, është bërë faza e dytë e projektit e cila ka konsistuar në ndryshimin e elementeve drusore, si trarë, binarë apo dërrasa të ndërkatit, ndërhyrje kjo e pjesshme vetëm në zonat e përcaktuara në fletët teknike të projektit. Në këtë vit është bërë restaurimi i elementëve dekorativë drusorë, karakteristike për këto banesa. Në këtë projekt një vend të veçantë zë dhe ndërhyrja restauruese në ambientet e jashtme. Këto ndërhyrje konsistojnë në sistemimin, rregullimin dhe restaurimin e kalldrëmit të oborrit, si dhe atë të portës hyrëse të oborrit. Këto projekte pasohen nga ai i vitit 2018, ku ndërhyrja kryesore është përqendruar tek “Oda e zjarrit”. Për realizimin e kësaj ndërhyrjeje është bërë çmontimi i të gjithë tavanit të dhomës, seleksionimi i elementeve drusore ende në gjendje të mirë dhe zëvendësimi i atyre të degraduar. Ajo që duhet theksuar, dhe është specifike për ndërhyrjet restauruese është se zëvendësimet apo vendosja e elementeve të rinj bëhet konform atyre ekzistues, duke mos ndryshuar formën, masën, ngjyrën, apo normat e ruajtjes së integritetit të pasurive kulturore.

Përfundime

Objekt i këtij punimi është banesa ku lindi Pashka Vasa. Teknika e lartë e ndërtimit dhe cilësia e materialeve të përdorura për ndërtimin e banesës, ka bërë që ajo të vijë e plotë deri në ditët tona. Nga pikëpamja e vlerave historike, socialkulturore si dhe arkitektonike që ky ndërtim mbart, banesa duhet të ruhet. Pas rishikimit të literaturës, evidentimit në terren të këtyre vlerave, u konstatua që banesa, mbart gjithashtu dhe vlera të trashëgimisë jomateriale, që lidhen me veprimtarinë dhe kontributin e Pashko Vasës. Për këto arsye është e domosdoshme që ajo të ruhet për

kujtesën kolektive të qytetit. Vështrimi kronologjik i ndërhyrjeve restauruese tregon për rëndësinë, që kjo banesë ka, këtë e faktojnë dhe projektet e restaurimit të hartuara dhe zbatuara. Vlen të evidentohet projekti i plotë i restaurimit në vitet 1976-1978, i cili bëri një ndryshim rrënjësor të banesës si nga aspekti arkitektoniko-volumor, atij strukturor si dhe në përmirësimin e elementeve karakteristike të objektit. Kjo ndërhyrje bëri të mundur kthimin në identitet të odave tradicionale, heqjen e mureve ndarës të panevojshëm, riformulimin e hapësirave si dhe plotësimin e arredimit të brendshëm me elemente karakteristike të banesës shkodrane. Me anë të këtij punimi duam të ndërgjegjësojmë autoritetet lokale për përfshirjen e kësaj banese në guidën turistike të qytetit për vlerat arkitektonike, historike e shoqërore që ky studim provoi se ajo ka, si dhe vendosjen e tabelave informuese si pjesë e sinjalistikës rrugore, që tregojnë vendndodhjen e saj. Vlen të përmendet edhe mundësia e kthimit të kësaj banese në muze dedikuar figurës së shquar kombëtare Pashko Vasa, siç ka qenë para viteve 90'. Kjo do të i rikthente kësaj banese rëndësinë e duhur dhe do të ishte një muze më shumë për qytetin për t'u vizituar nga turistët vendas dhe ato të huaj.

BIBLIOGRAFIA

- Bala, V. (1979). *Pashko Vasa: portret-monografi*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Bushati, H. (1998). *Shkodra dhe motet: Traditë, Ngjarje, Njerëz* (Vëllimi I). Shkodër: Rozafat.
- Bushati, H. (1999). *Shkodra dhe motet: Traditë, Ngjarje, Njerëz* (Vëllimi II). Shkodër: IDROMENO.
- Dibra, Z. (2015). *Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane: I. (A-K)*. Lezhë: Gjergj Fishta.
- Dibra, Z. (2016). *Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane: II. (L-ZH)*. Lezhë: Gjergj Fishta.
- Dibra, Z. (2018). *Qyteti që lindi nga një kështjellë: Histori ndërtimore e qytetit të Shkodrës*. Lezhë: Gjergj Fishta.
- Feilden, B. M. (2003). *Conservation of Historic Buildings* (Botim i 3-të). Oxford: Architectural Press.
- Ligji 17 maj 2018, n.27, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".
- Luzati, S. (1998). Ndërtimi dhe arkitektura e Shkodrës gjatë shekujve. *Shkodra në Shekuj*, (1, fq. 253-260). Shkodër: Rozafat.
- Parruca, A. (2001). *Shkodra bastion i qytetërimit shqiptar*. Tiranë: ILAR.
- Prifti, Sh. (1978). Restaurimi i banesës së patriotit të Rilindjes Kombëtare Pashko Vasa. *monumentet*, (15-16, fq. 5-24). Tiranë: Mihal Duri.

- Riza, E. (1972). *Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX. monumentet*, (4, fq. 141-184). Tiranë: Mihal Duri.
- Riza, E. (2009). *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare e shek. XV-XIX*. Tiranë: Dita 2000.
- Riza, E. (2016). *Banesa qytetare gjatë shek. XIX*. Në A. Meksi, A. Baçe, E. Riza, Gj. Karaiskaj & P. Thomo (Përkuj). (Botim i 2-të i rip.), *Historia e arkitekturës në Shqipëri: nga fillimet deri në vitin 1912* (fq. 675-736). Tiranë: Kristalina-KH.
- Shpuza, G. (2008). Pashko Vasa dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. *Studime historike*, (1-2, 175-184). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË KOMPANIVE FARMACEUTIKE SHQIPTARE PËRMES RAPORTEVE FINANCIARE

Liljana Ulaj¹

Banka Kombëtare Tregtare Tiranë

ABSTRAKT

Në ditët e sotme kompanitë përballen me shumë sfida për të mbijetuar në treg. Për të siguruar ekzistencën e tyre, dhe për më tepër për të qendruar konkurrese, drejtuesit e këtyre kompanive duhet të vlerësojnë vazhdimisht performancën e tyre. Ata duhet të monitorojnë industrinë në të cilën bëjnë pjesë, për të rregulluar çmimet, kostot, nivelet e inventarit, borxhin dhe efikasitetin e aseteve.

Kjo mikrotezë synon të vlerësojë performancën e disa kompanive farmaceutike në Shqipëri bazuar në analizën e raporteve financiare të tyre, ku përmendim: raportet e likuiditetit, të menaxhimit të aseteve, të përfitueshmërisë dhe të menaxhimit të borxhit, të cilat na sigurojnë informacion mbi situatën aktuale dhe na ndihmojnë në analizimin e të ardhmes së këtyre kompanive. Të dhënat kryesore janë mbledhur nga pasqyrat financiare vjetore për kompanitë përkatëse nga faqja e Qendrës Kombëtare të Biznesit, për një periudhë prej 6- vjeçare, nga viti 2015 deri në vitin 2020. Metoda e mbledhjes së të dhënave bazohet në dy kritere: 1) kompani farmaceutike që e kanë filluar aktivitetin e tyre para vitit 2015 dhe e vazhdojnë akoma, edhe në periudhën e studimit; 2) kompani farmaceutike që i kanë të raportuara pasqyrat financiare për periudhën tonë të interesit.

Analiza e raporteve është e rëndësishme për vendimmarrjen dhe zbatimin e strategjive nga drejtuesit. Në bazë të rezultateve, mund të bëjmë krahasimin e kompanive për periudhën para pandemisë me atë pas saj, për të kuptuar se si ka ndikuar situata aktuale e vendit tek to, krahasimin ndërmjet tyre dhe me mesataren e industrisë, ku do mund të dallojmë pikat e dobëta dhe të

¹ Master i shkencave në Kontabilitet 2019-2021; Bachelor në Financë – Kontabilitet 2016-2019 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Aktualisht jam e punësuar me kohë të plotë në Bankën Kombëtare Tregtare, Dega Hoxha Tahsin.

forta, dhe gjithashtu për të dhënë sugjerime, që i mundësojnë atyre rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm.

Fjalë kyçe: raporte financiare, pasqyra financiare, performancë, likuiditet, borxh, kompani farmaceutike.

Assessment of the performance of Albanian pharmaceutical companies through financial reports

ABSTRACT

Nowadays, companies face many challenges to survive in the market. To ensure their existence, and moreover to stay competitive, the executives of these companies must constantly evaluate their performance. They need to monitor the industry they belong to, to adjust prices, costs, inventory levels, debt and asset efficiency.

This thesis aims to evaluate the performance of some pharmaceutical companies in Albania based on the analysis of their financial ratios, where we mention: liquidity, asset management, profitability and debt management ratios, which provide us with information on the current situation and help us analyze the future of these companies. The main data are collected from the annual financial statements for the respective companies from the website of the Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), for a period of 6 years, from 2015 to 2020. The method of data collection is based on two criteria: 1) pharmaceutical companies which started their activity before 2015 and still continue, even in the period of study; 2) pharmaceutical companies that have reported the financial statements for our period of interest.

Analysis of reports is important for decision making and implementation of strategies by managers. Based on the results, we can compare companies for the period before the pandemic with those after it, to understand how the current situation of the country has affected them, to make the comparison between them and the average of the industry, where we can distinguish their strengths and weaknesses, and also to give suggestions to help them grow and develop further.

Keywords: financial ratios, financial statements, performance, liquidity, debt, pharmaceutical company.

1. Hyrje

1.1 Parathënie

Qëndrueshmëria, rritja dhe zhvillimi afatgjatë i një kompanie kërkojnë vendime të mira dhe performancë të jashtëzakonshme (Phuong Dao 2016). Një matës për vlerësimin e performancës janë pasqyrat financiare të raportuara në një bazë të rregullt kohore dhe që përmbajnë të dhëna të sakta dhe të besueshme, të cilat mundësojnë përlogaritjen e raporteve financiare, me interes të madh për palët e jashtme, siç janë investitorët, kreditorët, klientët, qeveria etj. Analiza e bazuar në këto raporte është metoda më e rëndësishme për vlerësimin e situatës financiare të kompanive gjatë një periudhe të caktuar. Ato ndryshojnë nga një industri në tjetrën për shkak të karakteristikave të ndryshme të biznesit, por analiza e tyre është thelbësore dhe e rëndësishme nëse krahasimi bëhet brenda industrisë. Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar (FASB) (1978) theksoi se fokusi kryesor i pasqyrave financiare është fitimi, kështu që informacioni në to duhet të ketë aftësinë për të parashikuar fitimin në të ardhmen. Analiza e raporteve financiare mund të ndihmojë palët e interesuara në vlerësimin e gjendjes së kaluar financiare të kompanisë, asaj të tashme, dhe në projektimin e rezultateve apo fitimeve të ardhshme (Juliana & Sulardi, 2003).

Industria farmaceutike është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe ka një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo luan një rol aktiv në politikat rreth kërkimit, zbulimit dhe zhvillimit të ilaçeve të reja. Kompanitë farmaceutike përpiqen vazhdimisht të sjellin trajtime të reja dhe inovative që ndihmojnë njerëzit të jetojnë më shëndetshëm dhe më gjatë. Këto trajtime prodhohen, tregtohen dhe shpërndahen në të gjithë botën nga kompanitë farmaceutike çdo ditë.

Industria farmaceutike ka kontribuar në rritjen e jetëgjatësisë për femrat dhe meshkujt në të gjithë botën. Është raportuar se avancimet farmaceutike përbënin rreth 73% të rritjes totale të jetëgjatësisë në 30 vende në zhvillim dhe me të ardhura të larta që morën pjesë në një studim për periudhën 2000 – 2009. Në vitin 1900, jetëgjatësia globale ishte vetëm 32 vjet, dhe falë përparimeve në ilaçe, kjo është më shumë se e dyfishuar, sot jetëgjatësia mesatare është 72 vjet. (John Wu, 2017). Inovacionet farmaceutike kanë ndikuar pozitivisht në të gjitha vendet, duke bërë që pabarazia globale në jetëgjatësi të ulet. Çrrënjësja e sëmundjeve është qëllimi kryesor kur zhvillohen trajtime dhe kjo është arritur falë ilaçeve që prodhohen dhe shpërndahen në të gjithë botën nga kompanitë farmaceutike. Këto kompani janë përgjegjëse për miliona vende pune përgjatë gjithë botës, si rezultat ato janë një aset thelbësor për ekonominë e çdo vendi. Në mënyrë të

përmbledhur, kompanitë farmaceutike luajnë rol të rëndësishëm në ndihmën që i japin çdo individ dhe komuniteteve në përgjithësi. Ato ofrojnë më shumë sesa kura dhe trajtime, ato krijojnë gjithashtu vende pune dhe ushqejnë ekonominë globale (Hannah Burke, 2020).

Ky studim përbën një përpjekje për të analizuar performancën e 5 prej këtyre kompanive në vendin tonë (FLORIFARMA, DELTA PHARMA, PROFARMA, REJSI FARMA, MEGAPHARMA) nëpërmjet raporteve financiare dhe studimin se si ndikojnë këto raporte në rritjen e përfitimeve të tyre. Gjithashtu, duke pasur parasysh situatën e krijuar nga COVID 19 gjatë vitit 2020 në të gjithë botën, është me interes njohja se si ka ndikuar ajo në mbarëvajtjen dhe performancën e kompanive farmaceutike. Për këtë, do të bëjmë një krahasim për Shqipërinë, për periudhën 2015-2019 me vitin 2020.

1.2 Objektivat e studimit

Objektivat e këtij studimi janë:

1. Vlerësimi i performancës së 5 kompanive më të mëdha farmaceutike shqiptare, duke u bazuar në pasqyrat dhe raportet financiare të tyre. Krahasimi ka të bëjë me performancën nga viti 2015 deri në vitin 2020. Thelbi është të kuptojmë se sa mirë kanë performuar, sa të qëndrueshëm kanë qenë dhe t'i ndihmojmë palët e interesuara në zgjedhjen e kompanive për t'u marrë në konsideratë.
2. Krahasimi i vijueshmërisë së aktivitetit të kompanive farmaceutike për periudhën para pandemisë (Covid 19) me atë gjatë saj. Si ka ndikuar pandemia në zërat e pasqyrave financiare të tyre.

1.3 Rëndësia e studimit

Ky punim fokusohet në analizën e raporteve financiare, pra ku vërehet lidhja mes zërave të paraqitur në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga perspektiva e menaxhimit, ata mund të bazohen në raportet financiare për të hartuar politika dhe për të marrë vendime të mira në lidhje me kompaninë e tyre. Në bazë të studimit të kryer më poshtë, ata vlerësojnë se si ndikojnë zërat e ndryshëm në performancën e kompanisë, dhe nëse duhen ndërmarrë hapa për të bërë ndryshime. Investitorët vlerësojnë ecurinë e kompanisë dhe në bazë të raporteve kuptojnë se sa të sigurta janë investimet e tyre. Analiza e raporteve gjithashtu i ndihmon kreditorët për të kuptuar aftësinë e kompanisë për të shlyer borxhet ndaj tyre dhe nëse duhet të vazhdojnë t'i japin borxh asaj. Së fundmi, qeveria është e interesuar për raportet mesatare të industrisë. Duke pasur

informacion për shumë kompani në një industri, ajo mund të bëjë një vlerësim të saktë se çfarë masash duhet të ndërmarrë për t' i ndihmuar ato.

1.4 Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore, mbi bazën e të cilave është ngritur studimi janë:

1. Si po performojnë kompanitë farmaceutike në Shqipëri, bazuar tek raportet e likuiditetit, të menaxhimit të aseteve, të menaxhimit të borxhit dhe të përfitueshmërisë?
2. Si ka ndikuar situata e Covid 19 në ecurinë e aktivitetit të këtyre kompanive?
3. A janë përdorur strategjitë e duhura për rritjen e fitimeve të këtyre kompanive?

1.5 Metodologjia e studimit

Ky punim konsiston në kërkimin sekondar. Të dhënat janë marrë nga informacionet e raportuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga libra dhe nga faqet e internetit. Për analizimin e të dhënave janë përdorur raportet financiare, analiza përshkruese dhe llogaritjet matematikore. Studimi përfshin disa nga kompanitë farmaceutike të rankuara si më të mirat në Republikën e Shqipërisë në platformën Google, sipas vlerësimit të publikut, për të cilat kemi mundur të grumbullojmë informacion financiar për periudhën 2015 – 2020.

1.6 Kufizimet e studimit

Përpos rëndësisë që ka ky studim, jemi ndeshur me disa kufizime të cilat ishin të pashmangshme.

Së pari, në studim kemi përfshirë vetëm 5 kompani farmaceutike, për arsye të mungesës së informacionit të tyre financiar në faqen e QKB. Nëse kampioni do të ishte më i madh, kjo do të çonte në arritjen e rezultateve më të sakta.

Së dyti, të dhënat përfshijnë një hark kohor prej 6 vjetësh (2015-2020), nga pamundësia për të siguruar informacion për vitet e mëparshme.

1.7 Historik i shkurtër

- Kompania *Florifarma* është një biznes familjar i themeluar në vitin 1995, me seli në qytetin e Lezhës. Deri në vitin 2000, kompania ka vepruar në Lezhë si Distributor Rajonal. Në janar 2001, selia e kompanisë është transferuar në Tiranë. Nga viti 2001 e në vazhdim, Florifarma është importuese e produkteve farmaceutike të linjave prestigjioze evropiane: Vitabiotics, Nuk, Aicore, Hairbust etj. Ajo

- funksionon gjithashtu si distributor dytësor, duke tregtuar të gjitha ilaçet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë.
- *Delta Pharma* operon si një distributor rajonal dhe një organizatë shitjesh e kontraktuar, që ofron një gamë të plotë shërbimesh për klientët. Me seli në Tiranë, ajo mbulon Shqipëinë, Kosovën, Bosnjën dhe Maqedoninë e Veriut. Delta Pharma është kompania më inovative, e teknologjisë së lartë dhe e orientuar drejt klientit, e fokusuar në shitjen e barnave novative, suplementeve ushqimore, pajisjeve mjekësore etj. Ajo gëzon një reputacion të jashtëzakonshëm si një partner efikas dhe i besueshëm nga bashkëpunëtorët e jashtëm dhe të brendshëm.
 - *Profarma* u krijua në vitin 1948, si një laborator i vogël në ambientet e spitalit të Tiranës, për prodhimin e disa ilaçeve, duke filluar nga produktet bazë, si uji i distiluar. Më vonë, laboratori u zhvillua më tej në një ndërmarrje të produkteve farmaceutike që u emërua Profarma. Preparatet e para farmaceutike të prodhuara ishin ekstraktet e lëngëta dhe ato të thata, të cilat më pas u përdorën nga farmacistët në mbarë Shqipërinë për të përgatitur preparate galenike, si: shurupe, solucione etj. Më tej, në 1956, për shkak të rritjes së kërkesës për ilaçe, u ndërtua një ndërmarrje e re me departamente të tjera prodhimi. Në vitin 2000, Profarma u privatizua nga një shoqëri aksionare. Ajo u fokusua në investime për përmirësimin e kushteve të punës, përditësimin e teknologjisë, si dhe blerjen e pasjisjeve bashkëkohore. Në vitin 2008, në partneritet me kompaninë gjermane Dermapharm AG, u nis projekti për ndërtimin e fabrikës farmaceutike që është sot, me standardet më të larta. Sot Profarma operon në tregun shqiptar dhe atë rajonal.
 - *Rejsi Farma* u themelua në vitin 1998. Ajo është një nga distributorët më të rëndësishëm farmaceutikë në tregun shqiptar, duke ofruar produkte me cilësi të lartë për farmacistë, spitalet, klinikat, qendrat shëndetësore dhe palët e tjera të interesit.
 - E themeluar në vitin 1994 me kapital privat, *Megapharm* është kompania e parë farmaceutike në Shqipëri. Ajo është e specializuar në importimin, eksportimin, shpërndarjen dhe shitjen me pakicë dhe shumicë të barnave, suplementeve ushqimore, pajisjeve mjekësore, produkteve dermatologjike dhe kozmetikës.

Megapharm i është bashkuar edhe tregut me pakicë si aksioneri kryesor i rrjetit Orange Pharmacies.

2. Metodologjia

Ky kapitull përshkruan metodat që janë përdorur për t'u kthyer pergjigje pyetjeve kërkimore të ngritura në fillim të studimit dhe gjithashtu mënyrën se si janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të përmbushur qëllimin dhe analizimin e tyre.

Në këtë punim është studiuar:

1. Si kanë ndryshuar disa nga raportet financiare për kompanitë farmaceutike shqiptare nga periudha para pandemisë së COVID-19, pra para vitit 2019, me atë gjatë saj.

2.1 Mbledhja e të dhënave


Të dhënat kryesore janë mbledhur nga pasqyrat financiare të disa prej kompanive farmaceutike shqiptare për periudhën 2015-2020, që janë publikuar online në website-in zyrtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), pra janë të dhëna sekondare. Pasqyrat financiare, në të cilat jemi bazuar për mbledhjen e të dhënave, janë: Bilanci kontabël dhe Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Lloji i të dhënave është sasior, sepse kemi të bëjmë me vlerat e zërave të paraqitur në këto pasqyra, të nevojshme për llogaritjen e raporteve financiare.

2.2 Përzgjedhja e kampionit

Përcaktimi i madhësisë së kampionit është një element shumë i rëndësishëm për studimin. Gjatë përcaktimit të tij, jemi bazuar në disa pika:

- Kompani farmaceutike që operojnë në shtetin shqiptar,
- Kompani farmaceutike që e kanë filluar aktivitetin e tyre të paktën prej 5 vjetësh,
- Kompani farmaceutike që kanë pasqyrat financiare të publikuara në faqen zyrtare të QKB.

Tabela 2-1. Modeli i vlerësimit të performancës së kompanive farmaceutike shqiptare.



2.3 Formulatat për analizën e raporteve

Për llogaritjen e raporteve financiare kemi përdorur disa formula, për të cilat jemi bazuar në literaturën e Analiza Financiare nga Fatbardha Molla (2018) dhe Baza Financë nga Kleida Tufi-Heta (2017-2018). Këto raporte janë aspektet më të rëndësishme të punimit tonë sepse vetëm nëpërmjet tyre mund të vlerësojmë ecurinë e kompanive që kemi përzgjedhur për studim. Janë disa formula, ku secila tregon një nga 4 aspektet e vlerësimit të performancës dhe gjendjes financiare të kompanive.

Raportet e likuiditetit

Raporti korent = Aktive korente/Detyrime korente

Raporti i shpejtësisë = (Aktive korente – Inventare)/Detyrime korente

Ditët e shitjes së inventarit = 365/(KMSH/Inventar)

Ditët e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme = 365/(Shitje/Llogari të arkëtueshme)

Raportet e menaxhimit të mjeteve

Raporti i qarkullimit të mjeteve = Shitje/Mjete totale

Raportet e menaxhimit të borxhit

Raporti i borxhit = Borxh total/Mjete totale

Raportet e përfitueshmërisë

Fitimi marzhinal = EAN/Shitje

ROA = EAN/Mjete totale

ROE = EAN/Kapital total


3. Analiza e rezultateve

Në këtë seksion ne paraqesim rezultatet nga analiza e të dhënave që kemi bërë. Ky seksion ndahet në disa kategori. Së pari do të shqyrtojmë performancën financiare të kompanive farmaceutike duke u bazuar te raportet e likuiditetit. Së dyti, do të paraqesim gjendjen e tyre bazuar te raportet e menaxhimit të asetëve. Së treti, do të bazohemi te raportet e menaxhimit të borxhit për të krahasuar ecurinë e këtyre kompanive ndër vite dhe së fundmi tek raportet e përfitueshmërisë.

3.1 Raportet e likuiditetit

- Raporti korent = AASH/DASH

Figura 3-1. Raporti korent.



Ky raport llogaritet duke pjesëtuar aktivet korente me detyrimet korente. Një vlerë shumë e lartë e këtij raporti nuk është e mirë për firmën sepse tregon që ajo ka më tepër likuiditet seç duhet, gjë që nuk është fitimprurëse. Nga grafiku vërejmë që përgjithësisht, të gjitha firmat, për periudhën 2015-2018, kanë pasur nivele të larta të raportit korent, që është si rezultat i niveleve të larta të inventarit dhe të llogarive të arkëtueshme. Në vitin 2019, kanë pësuar pak rënie, që ka ardhur nga rënia e llogarive të arkëtueshme, ndërsa në vitin 2020, kanë pësuar sërish rritje, që ka ardhur si rezultat i rritjes së llogarive të arkëtueshme, pra janë rritur shitjet me kredi të produkteve farmaceutike gjatë periudhës së pandemisë.

- Raporti i shpejtë = (AASH – Inventare)/DASH

Figura 3-2. Raporti i shpejtë.




Raporti i shpejtë është një matës më i mirë i likuiditetit të firmës sepse tregon në të vërtetë se sa likuide është. Raporti i shpejtësisë duhet të jetë nën 1, në mënyrë që firma të mos ketë likuiditet të tepërt. Nga grafiku vërejmë që Florifarma, Profarma dhe Megapharma, kanë raporte të shpejta më të ulët se 1 në të gjitha vitet, që d.m.th., se pjesën më të madhe të aktiveve afatshkurtra e kanë zënë inventarët. Ndërkohë Delta Pharma dhe

Rejsi Farma, kanë rënie nga raporti korent, megjithatë vazhdojnë të ngelen në nivele të larta, që d.m.th., që ka zëra të tjerë që kanë vlera të larta në aktivet afatshkurta, konkretisht llogaritë e arkëtueshme ose investimet. Në vitin 2020, raportet e shpejtësisë kanë pësuar rritje përgjithësisht, për arsyen që e përmendëm tek raporti korent, pra janë rritur shitjet nëpërmjet llogarive të arkëtueshme, që kanë rritur aktivet afatshkurtra, dhe pavarësisht që janë zbritur inventaret, rritja e tyre ka qenë më e lartë, duke bërë që të marrim raporte të tilla. E kundërta ndodh me Profarma, që në vitin 2020 raporti i shpejtësisë ka rënë, kjo për arsye se në vitin 2020 ka pasur nivele shumë të larta të inventarit, që mund të ketë ardhur si rezultat i pritjes së rritjes së kërkesës për produkte farmaceutike. Duke e zbritur këtë inventar nga aktivet afatshkurta, niveli i tyre ka rënë ndjeshëm në krahasim me detyrimet afatshkurtra, duke çuar kështu në rënie të raportit të shpejtë.

- Ditet e shitjes së inventarit = $365 / (\text{KMSH} / \text{Inventar})$


Figura 3-3. Ditet e shitjes së inventarit



Sa më të ulëta të jenë ditët e shitjes së inventarit, aq më mirë është për kompaninë, sepse nuk mban inventar të tepërt kot. Ajo që vërehet menjëherë nga grafiku janë ditët e shitjes së inventarit për kompaninë farmaceutike Profarma. Siç e përmendëm dhe më lart, kjo kompani mban nivele të larta të inventarit, që bën që ky inventar të vonojë të shitet. Në vitin 2020, ditët e shitjes janë rritur sepse inventari është rritur si rezultat i parashikimit të rritjes së kërkesës. Ndërsa për kompanitë e tjera, ditët e shitjes qëndrojnë brenda një intervali të pranueshëm çdo vit. Në vitin 2020, ditët e shitjes kanë rënë, sepse rritja e kostove ka qenë më e lartë në krahasim me rritjen e inventarit.

- Ditet e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme = $365 / (\text{Shitje} / \text{Llogari të arkëtueshme})$

Figura 3-4. Ditët e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme.




Siç e vërejmë nga grafiku, llogaritë e arkëtueshme kanë nivele më të ulëta të ditëve të mbledhjes, d.m.th., që mbledhen më shpejt. Kjo është në favor të kompanisë, sepse i arkëton shpejt mjetet monetare në rastet e shitjes me kredi. Në përlllogaritjen e këtij raporti, ne jemi bazuar tek shitjet totale, në mungesë të informacionit në lidhje me shitjet me kredi në pasqyrat financiare të kompanive. Ajo që vërejmë nga grafiku është trendi i rritjes së ditëve të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme, pra me kalimin e viteve, llogaritë e arkëtueshme janë rritur, duke bërë që të kemi qarkullim më të ulët të tyre, që rezulton në nivele më të larta të ditëve të mbledhjes. I njëjti trend ka vijuar edhe në vitin 2020, ku 3 firmat që kanë pasur rritje të këtij raporti, d.m.th. që kanë pasur rritje të llogarive të arkëtueshme, ndërsa Florifarma dhe Profarma që janë shoqëruar me rënie, ka ardhur respektivisht nga rritja e shitjeve (Florifarma) dhe zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme (Profarma).

3.2 Raportet e menaxhimit të mjeteve

- Raporti i qarkullimit të mjeteve totale = Shitje/Mjete totale

Figura 3-5. Qarkullimi i mjeteve totale.




Qarkullimi i mjeteve totale mat aftësinë e kompanive për të gjeneruar shitje nga përdorimi i asetëve (Kieso, Weygandt, Warfield, 2001). Ky raport merr në konsideratë të gjitha asetet, duke përfshirë, pronat, pajisjet dhe makineritë, investimet, inventarët, llogaritë e arkëtueshme, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tij etj. Një vlerë e lartë e këtij raporti tregon se firma po arrin fitime të larta.

Në këtë grafik shohim që ka pasur luhatje të qarkullimit të mjeteve totale, por vitet e fundit vërejmë një rënie graduale të këtij raporti. Kjo mund të ketë ardhur si rezultat i ndonjë strategjie në lidhje me çmimet, që ka bërë që të ulen shitjet ose nga rritja e aktiveve totale. Edhe në vitin 2020, vërejmë që ka rritje të këtij raporti për disa kompani dhe ulje për kompani të tjera. Nëse bazohemi te strategjia e çmimeve që përmendëm, është një arsye që qëndron, sepse gjatë vitit pandemik çmimet janë rritur, mund të themi se dy nga kompanitë që kanë pasur rritje (Florifarma dhe Delta pharma), kanë hartuar strategji më të mira, duke bërë kështu që të kenë rritje të kërkesës, dhe si rezultat, rritje të shitjeve dhe anasjelltas.

3.3 Raportet e menaxhimit të borxhit

- Raporti i borxhit = Borxh total/Mjete totale

Figura 3-6. Raporti i borxhit



Nga grafiku vërejmë që borxhi është luhatur shumë ndër vite. Megapharma është kompania me nivelin më të lartë të borxhit pas vitit 2016, ndër kompanitë që ne kemi zgjedhur për studim, gjë që nuk e favorizon shumë atë, pasi borxhi mbart risk të lartë. Sa për vitin 2020, për asnjërën nga kompanitë nuk ka pasur luhatje të mëdha të nivelit të borxhit dhe një nga arsyet mund të jetë frika që ka shkaktuar pandemia tek bizneset, edhe pse këto janë kompani farmaceutike dhe parashikimet të çojnë në rritje të kërkesës për produkte, sërish ekziston frika e falimentimit, e cila ka


bërë që firmat të mos marrin borxh, por ekziston edhe vështirësia për të gjetur kreditorë gjatë kësaj periudhe.

3.4 Raportet e përfitueshmërisë

- Fitimi marzhinal = EAN/Shitje

Fitimi marzhinal na ndihmon të kuptojmë se sa mirë mundet një kompani të konvertojë shitjet në fitim, duke i zbritur të gjitha shpenzimet. Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më fitimprurëse është firma.


Figura 3-7. Fitimi marzhinal



Si tek secila prej raporteve të tjera edhe fitimi marzhinal ka pasur luhatje ndër vite që mund të ketë ardhur si rezultat i ndryshimit të nivelit të çmimeve ose të kostove të produkteve. Pavarësisht që ka pasur luhatje më të mëdha, edhe fitim më të lartë ka pasur Profarma çdo vit, në krahasim me kompanitë e tjera. Në vitin 2019 ka pasur rënie të fitimit marzhinal për arsye të kostove të larta. Në vitin 2020, Florifarma dhe Delta pharma kanë pësuar rritje të fitimit marzhinal për arsye të rritjes së shitjeve, si rezultat i rritjes së kërkesës për produkte farmaceutike dhe të uljes së kostove që vërehet nga pasqyrat financiare të tyre. Profarma dhe Megapharma, që i përmendëm më lart kanë pasur ulje të shitjeve, ndoshta nga politikat e gabuara të çmimeve gjatë pandemisë dhe gjithashtu nga rritja e fitimit marzhinal na tregojnë që kanë pasur edhe ulje të kostove, duke çuar në një nivel më të lartë të të ardhurës neto/shitje, në krahasim me vitin e kaluar. E kundërta ka ndodhur me Rejsi Farma, e cila ka pësuar një rënie të fitimit marzhinal krahasuar me vitin 2019 për shkak të rritjes së kursit të euros, të situatës ekonomike të vendit për shkak të pandemisë dhe disa shpenzimeve të jashtëzakonshme të shoqërisë.

- $ROA = \text{EAN/Aktive totale}$


Figura 3-8. ROA



Ky raport mat aftësinë e kompanisë për të përdorur asetet e saj dhe gjithashtu mat efikasitetin e saj në gjenerimin e fitimeve. Raporti ka pothuajse të njëjtin trend si fitimi marzhinal për të 5-ta kompanitë. Deri në vitin 2017 trendi ka qenë në rritje, pra raporti EAN/Aktive totale është rritur. Pastaj në vitin 2018 ky raport ka rënë për shkak të rënies së fitimeve ose rritjes së aktiveve. Sërish në vitin 2020 shohim rritje të kthimit nga aktivet për Florifarma, Delta pharma, Profarma dhe Megapharma si rezultat i rritjes së fitimeve neto, ndërsa Rejsi Farma ka rënie të këtij raporti që ka ardhur si rezultat i rënies së të ardhurave neto që përmendëm më sipër.

- $ROE = \text{EAN/Kapital total}$

Figura 3-9. ROE



Në këtë raport firmat kanë pësuar luhatje gjithashtu gjatë viteve, që është ndikuar nga fitimi neto ose nga kapitali i pronarit. Ajo që na intereson është kuptimi se çfarë ka ndodhur në vitin 2020, ku shohim që kompanitë farmaceutike Florifarma, Delta pharma, Profarma dhe Megapharma kanë pësuar rritje të kthimit nga kapitali i investuar në kompani, që ka ardhur si rezultat i rritjes së fitimit neto. Ndërkohë Rejsi Farma edhe në këtë raport shfaqet njësoj si në 3 raportet paraardhëse që vërteton rënien e fitimit neto.

4. Konkluzione dhe rekomandime

Ky kapitull lidhet direkt me qëllimin e studimit. E gjithë analiza e bërë më sipër do të përmblihet në mënyrë që t'u japim përgjigje pyetjeve kërkimore të përcaktuara në fillim të punimit dhe për të përmbushur qëllimin e kësaj mikroteze.

Së pari kemi analizuar raportet e likuiditetit, që nga rezultatet e arritura kemi vërejtur se të gjitha firmat kanë qenë mjaft likuide gjatë periudhës 2015-2019 dhe madje disa më tepër krahasuar me raportin standard, i cili është mirë të jetë rreth 1 (F. Molla 2018), në mënyrë që të mos kenë likuiditet të tepërt që nuk sjell fitime. Pra, mund të themi, që detyrimet e tyre korente janë mbuluar mjaft mirë nga aktivet korente. Gjatë vitit 2020 nga pasqyrat financiare të këtyre kompanive kemi vërejtur një rritje të aktiveve afatshkurtra, konkretisht rritje të inventarëve ose llogarive të arkëtueshme, domethënë, që gjatë periudhës së përhapjes së pandemisë, firmat kanë prodhuar më tepër me pritjen se shitjet do të rriten dhe gjithashtu janë rritur shitjet me llogari të arkëtueshme.

Përsa i përket ditëve të shitjes së inventarit, ajo që vihet re është njëra nga firmat, Profarma, e cila ka nivele të larta të ditëve të shitjes së inventarit. Nga bilanci i saj shohim se kjo kompani mban nivele të larta të inventarëve dhe bën që ky inventar të vonojë të shitet. Në vitin 2020 ka pasur rritje të këtij raporti, d.m.th. që inventarët janë rritur në përputhje me pritjet për rritjen e kërkesës. Firmat e tjera kanë pasur luhatje brenda një intervali të pranueshëm ditësh brenda periudhës 2015-2019. Në vitin 2020 kanë pasur rënie të këtij raporti, që tregon një mirëmenaxhim të nivelit të inventareve në përputhje me kërkesën.

Ditët e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme janë rritur me kalimin e viteve, gjë kjo që ka ardhur nga rritja e llogarive të arkëtueshme. Megjithatë nuk vonojnë aq sa inventaret, por janë mbledhur më shpejt. Edhe në vitin 2020 janë rritur, me Profarmën me numrin më të lartë të ditëve, prej rreth 163 ditë, që ka ardhur si pasojë e rritjes së llogarive të arkëtueshme.

Më tej analiza jonë ka vijuar me raportet e menaxhimit të aseteve, për të kuptuar se sa shitje kanë gjeneruar firmat nga përdorimi i aseteve. Ajo që vihet re është një rënie e këtij raporti për kompanitë farmaceutike të marra në studim përgjatë viteve të fundit, që mund të ketë ardhur si rezultat i strategjive të gabuara të përcaktimit të çmimeve. Nga analiza e vitit 2020, vërejmë se firmat ndahen në firma, ku ky raport është rritur, d.m.th. kanë pasur rritje të shitjeve, dhe firma ku shitjet kanë rënë. Pika në të cilën mbështetemi për t'i dhënë një shpjegim kësaj është ajo e çmimeve, ku

firmat që kanë pasur rritje e kanë studiuar më mirë tregun dhe si rezultat kanë pasur rritje të shitjeve.

Ndër raportet e menaxhimit të borxhit, kemi zgjedhur vetëm raportin e borxhit total, që tregon ç'pjesë zë borxhi në aktivet e firmës. Duke tejkaluar periudhën 2015-2019, që ka pasur goxha luhatje, nëse fokusohemi vetëm tek viti 2020, ky raport nuk ka ndryshuar shumë, gjë që mund të ketë ardhur nga frika e falimentimit që ka ngjallur pandemia tek bizneset.

Së fundmi kemi analizuar raportet e përfitueshmërisë, ku kemi arritur në konkluzionet e përmbledhura në tabelën e mëposhtme për vitin 2020.

Tabela 4-1. Ecuria e shitjeve dhe fitimit neto për vitin 2020.

Florifarma	Rritje e shitjeve	Rritje e fitimit neto
Delta Pharma Al	Rritje e shitjeve	Rritje e fitimit neto
Profarma	Ulje e shitjeve	Rritje e fitimit neto
Megapharma	Ulje e shitjeve	Rritje e fitimit neto
Rejsi Farma	Ulje e shitjeve	Ulje e fitimit neto

Pra, për vitin 2020, firmat janë ndarë në 3 kategori duke u bazuar tek raportet e përfitueshmërisë. Florifarma dhe Delta Pharma kanë pasur rritje të shitjeve si rezultat i rritjes së kërkesës dhe ulje të kostove për shkak të mirëmenaxhimit të tyre duke u bazuar në raportet financiare vjetore, që ka çuar në rritje të fitimit neto.

Profarma dhe Megapharma kanë pasur ulje të shitjeve, për shkak të ndonjë strategjie të gabuar në lidhje me çmimet gjatë vitit 2020, duke bërë që kërkesa për produktet e tyre të bjerë, por kanë pasur rritje të fitimit neto, që ka ardhur nga mirëmenaxhimi i kostove të prodhimit dhe shitjes.

Rejsi Farma, ndryshe nga kompanitë e tjera, ka pësuar rënie të shitjeve dhe fitimit neto, për shkak të situatës ekonomike të vendit që ka ndikuar negativisht tek ajo dhe shpenzimeve të mëdha gjatë këtij viti.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi që, viti 2020, ka qenë një vit sfidues për të gjitha bizneset në botë, për ekonominë e çdo vendi. Kompanitë farmaceutike, ndryshe nga bizneset e tjera, kanë vazhduar punën drejt prodhimit dhe shitjes së ilaçeve, sepse njerëzit, më shumë se çdo herë, kanë kërkuar t'i blejnë. Mirëpo, jo të gjitha prej tyre kanë përfituar, duke pasur parasysh se konkurrenca është e fortë. Disa prej këtyre kompanive nuk kanë ditur të studiojnë mirë tregun, duke mos hartuar strategji të mira për rritjen e shitjeve. Por ka edhe kompani të tjera, si disa nga ato që kemi marrë në studim, që periudhën e vështirë të covid-19, ta përdorin në përfitimin e tyre.

Rekomandime

1. Gjetjet e këtij punimi rekomandojnë që firmat duhet të jenë më të kujdesshme me likuiditetin e tepërt, sepse siç e kemi përmendur, nuk sjell fitime për to. Megjithatë, ato duhet të mbajnë likuiditet të mjaftueshëm për të mbuluar detyrimet afatshkurtra, në të kundërt do të përballeshin me probleme financiare.
2. Nuk është shumë e preferueshme për kompanitë të orientohen drejt financimit nëpërmjet borxhit, sepse mbart shumë risk. Kjo vlen më së shumti për Megapharma, e cila financohet me rreth 94% borxh në vitin 2020.
3. Duhet të bëhet një studim i mirë i tregut në rastin e hartimit të strategjive të çmimeve, të studiohen konkurrentët dhe produktet zëvendësuese dhe gjithashtu kërkesat e konsumatorëve.

REFERENCA

- Dao, P. (2016). "Performance evaluation based on financial ratios".
- Deltapharma.
- Fidelity. "Company valuation ratios".
- Florifarma.
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. "SKK 2 – Paraqitja e Pasqyrave Financiare".
- Megapharm.
- Molla, F. (2018). Analiza financiare.
- Proclinical. "Why are pharmaceutical companies so important?".
- Profarma.
- Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Rejsifarma.
- Tufi, K. (2018). Baza Finance.

EMIGRACIONI DHE NDIKIMI I REMITANCAVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Aurora Kinka (Pulti)¹, Estela Lleshi²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik,
Departamenti Financë - Kontabilitet*

ABSTRAKT

Përgjatë gjithë historisë njerëzore dhe në të gjithë botën njerëzit për motive të ndryshme kanë lënë vendet e tyre të lindjes duke punuar dhe jetuar në vende të tjera. Shqipëria ka qenë një ndër vendet me hyrje të larta të remitancave përgjatë periudhës së tranzicionit postkomunist të saj, ku në fillimet e viteve 90’ u përball me emigrim masiv të qytetarëve të saj jashtë vendit. Remitancat, si produkti kryesor që rezultojnë nga emigracioni, po bëhen një aspekt i rëndësishëm i ekonomisë globale duke përfaqësuar një nga flukset më të mëdha ndërkombëtare të burimeve financiare. Analiza e ndikimit të remitancave në zhvillimin ekonomik të vendit të origjinës ka qenë shpesh objekt studimi dhe ekzaminimi prej shumë studiuesve.

Ky punim synon të vëzhgojë ndikimin e remitancave në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke përdorur të dhëna vjetore nga Banka Botërore gjatë periudhës 1996–2020. Më tej, pas rishikimit të literaturës empirike kushtuar ndikimit të remitancave në rritjen ekonomike, do të identifikohet në mënyrë empirike nëse ka marrëdhënie domethënëse midis remitancave dhe rritjes në vend. Rezultatet e analizës ekonometrike sugjerojnë që dërgesat e emigrantëve kanë një ndikim negativ në rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Fjalë kyçe: emigracioni, remitanca, rritje ekonomike, Shqipëri.

¹ Diplomuar në vitin 2004 në Bachelor Financë – Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe në 2008 ka marrë titullin Master Shkencor në Financë pranë fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2017 ka marrë gradën shkencore Doktor në fushën e Financës në Universitetin e Tiranës. Që nga viti 2004 është pedagoge pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe lektore e lëndëve “Bazat e financës”, “Manaxhim financiar”, “Financa e korporatave”.

² Diplomuar në vitin 2019 në Bachelor Financë – Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në 2021 ka marrë titullin Master Shkencor në Financë pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Immigration and the impact of remittances on the economic development of the country

ABSTRACT

Throughout human history and all over the world people for various motives have left their native places working and living in other countries. Albania has been one of the countries with high inflows of remittances during the period of its post-communist transition, where in the early 1990s it faced mass emigration of its citizens abroad. Remittances, as the main product resulting from emigration, are becoming an important aspect of the global economy representing one of the largest international flows of financial resources. The analysis of the impact of remittances on the economic development of the country of origin has often been the subject of study and examination by many scholars.

This paper aims to observe the impact of remittances on the economic growth of Albania, using annual data from the World Bank during the period 1996–2020. Furthermore, after reviewing the empirical literature on the impact of remittances on economic growth, it will be empirically identified whether there is a significant relationship between remittances and growth in the country. The results from econometric analysis suggest that remittances have a negative impact on economic growth of Albania.

Key words: emigration, remittances, economic growth, Albania.

I. Hyrje

Emigracioni është jo vetëm një çështje sociale, por gjithashtu një çështje politike dhe ekonomike. Ai është shndërruar në problemin më të mprehtë të shoqërisë shqiptare teksa numri i të larguarve, kryesisht të rinj, po vjen në rritje, duke e vënë në pikëpyetje zhvillimin e qëndrueshëm të vendit në të ardhmen. Ky punim paraqet informacione të përgjithshme lidhur me fenomenin e emigracionit në Shqipëri, analizës thelbësore lidhur me konceptin e remitancave, si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

Punimi do të trajtojë fillimisht faktorët që ndikojnë në dukurinë e emigrimit nga Shqipëria dhe do të analizohen si karakteristikat individuale të tilla, si: moshë, arsime etj., ashtu dhe karakteristikat e familjes së cilës i përket emigranti. Më tej do të paraqesim një tablo të detajuar të

emigracionit shqiptar dhe krahasimin me vendet e rajonit, të shprehur në shifra reale. Gjithashtu, të dhënat e vëzhguara nga raportime dhe anketime të ndryshme, tregojnë për një plagë të thellë që po krijohet viteve të fundit, pasi ata që dëshirojnë më tepër të largohen nga Shqipëria janë personat më të kualifikuar e më të arsimuar.

Analiza e fenomenit të emigracionit në Shqipëri dhe ndikimit të remitancave, si një produkt kryesor që vjen prej këtij, në zhvillimin ekonomik të vendit të origjinës ka qenë shpesh objekt studimi dhe ekzaminimi prej shumë studiuesve. Ky punim është përqendruar në një analizë të bërë nën këndvështrimin financiar. Edhe Shqipëria si çdo vend tjetër në zhvillim ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të saj, që jetojnë në vende tjera më të zhvilluara (kryesisht në BE dhe SHBA). Duke ditur numrin e lartë të të papunëve në Shqipëri, nga vitet '90 e tutje, kanë qenë remitancat ato që kanë siguruar kushtet e jetës për shumë nga qytetarët e Shqipërisë. Duke pasur parasysh se dërgesat e emigrantëve përbëjnë një element të rëndësishëm të të ardhurave kombëtare, si dhe komponentë mjaft të rëndësishëm në financimin e konsumit, rrjedhimisht me kontribut edhe në rritjen ekonomike, studimi i kësaj kategorie konsiderohet mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë.

II. Qëllimi dhe objektivat

Nëpërmjet këtij punimi synohet të kuptojmë arsyet pse shqiptarët zgjedhin të migrojnë në masë të madhe jashtë Shqipërisë, si dhe pasojat që lë pas emigracioni në Shqipëri, sidomos migrimi i kapitalit intelektual. Përsa i përket analizës së remitancave, si një produkt kryesor që vjen prej emigracionit, ky punim ka për qëllim të evidentojë efektet e përgjithshme në aspekte të ndryshme të ekonomisë, si dhe në vlerësimin e impaktit që kanë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Objektivat të cilat synohen me anë të këtij punimi janë:

- ✓ Të analizohet koncepti i emigracionit dhe i remitancave në linjat më thelbësore dhe të rëndësishme.
- ✓ Të identifikohen komponentët përbërës të remitancave.
- ✓ Të përcaktohen problemet më delikate me të cilat po përballet shoqëria shqiptare viteve të fundit, të lidhura me fenomenin e emigracionit.
- ✓ Të trajtohet rëndësia e remitancave të emigrantëve në ekonominë në zhvillim.
- ✓ Të identifikohet se cili është impakti që kanë remitancat në rritjen ekonomike të vendit.

- ✓ Të nxirren rezultate reale dhe të sakta nga analiza statistikore.

III. Pyetja kërkimore

Ky punim do t'i japë përgjigje pyetjes së mëposhtme:

- A ka ndikim niveli i remitancave në rritjen ekonomike në Shqipëri?

1. FENOMENI I EMIGRACIONIT

1.1. MIGRIMI NGA SHQIPËRIA: NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1.1. Fillesat e emigracionit shqiptar dhe faktorët nxitës

Pas viteve '90, Shqipëria u dominua nga cikle migruese, të cilat mund të konsiderohen intensive, të parregullta dhe evoluese. Shkëndija fillestare ishte rënia e regjimit komunist në vitin 1990, i cili, bashkë me zbrëthimin e ekonomisë së planifikuar në mënyrë qendrore shkaktoi një ndryshim demografik me një ritëm të paparë. Dhjetëra mijëra njerëz të dëshpëruar kaluan përtej kufirit malor në Greqi ose lundruan me anije për të përfunduar në Itali (Germezi 2008).

Kolapsi i një sërë skemash piramidale kombëtare të “kursimit” në fund të vitit 1996 dhe fillimi i vitit 1997 shkaktoi një rritje tjetër të emigrimit. Skemat piramidale, të cilat e kishin origjinën në një sistem të dobët të kreditit formal dhe një treg joformal të parregulluar nga qeveria, u ushqyen në masë të madhe nga dërgesat e emigrantëve. Në pikën më të lartë, mbi 2 milionë depozita u bënë në këto skema, ku njerëzit shitën gjithë pasuritë e tyre në mënyrë që të investonin me premtimin për të marrë deri në 40% kthime mujore të investimit (Carletto et al 2004).


Edhe pse vendimi për të migruar bazohet, përgjithësisht, në faktorë ekonomikë, psikologjikë, socialë dhe politikë, shumë ekonomistë janë përqendruar në diferencat e pagave dhe papunësisë. Nivelet zyrtare të papunësisë në Shqipëri, Greqi dhe Itali kishin tendencë të ishin të ngjashme në vitet '90, por diferencat në paga ishin të mëdha. Këto diferenca masive, të kombinuara me afërsinë gjeografike të vendeve, si dhe kontrollet relativisht të dobëta të kufijve, kanë kapërcyer pengesat psikologjike për të krijuar flukse të mëdha migrimi (Konica dhe Filer 2009).

1.1.2. Karakteristikat e emigracionit shqiptar

Vendi ynë gëzon praninë e një popullate të konsiderueshme migratore të shpërndarë në të katër anët e botës, ku sipas OKB-së (2017), numri i emigrantëve shqiptarë, që aktualisht jetojnë dhe punojnë jashtë vendit vlerësohet në rreth 1.15 milionë. Kjo popullatë migratore ka ardhur në rritje përgjatë viteve.

- Rreth 90% e emigrantëve shqiptarë jetojnë në kontinentin evropian, e pjesa tjetër në kontinentin amerikan;
- 99.5% (1,142,748 individë) në rajonet më të zhvilluara dhe vetëm 0.5% (5,396 individë) në ato më pak të zhvilluara.
- 93.2% (1,069,693 individë) në rajonet me të ardhura të larta, 6.8% (78,441 individë) në rajone me të ardhura mesatare dhe një përqindje shumë e vogël në vendet me të ardhura nën mesataren.

Figura 1. Vendet me numrin më të lartë të emigrantëve shqiptarë.



Burimi: OKB, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, Divizioni i Popullsisë (2017).


Në vitet '90, emigracioni në Shqipëri ka qenë fenomen i ndërmarrë në shumicën e rasteve nga meshkujt, por referuar të dhënave të vitit 2017, dallimet gjinore janë zbutur, duke ardhur në përafërsisht të njëjtat nivele (580,344 meshkuj dhe 567,800 femra). Emigrimi femëror është rritur si pasojë e bashkimeve familjare dhe mundësive më të mira jashtë vendit.

1.1.3. Krahasimi me vendet fqinje të rajonit

Të dhënat e EUROSTAT për vendet potenciale kandidate për në Bashkimin Evropian tregojnë se Shqipëria ka shënuar tkurrjen më të madhe të popullsisë nga migracioni neto në krahasim me të gjitha vendet e tjera të Ballkanit, për të dy vitet që janë marrë referencë, si në 2007-ën ashtu dhe në 2017-ën, teksa më shumë persona largohen, sesa kthehen. Shqipëria, së bashku me Kosovën dhe Malin e Zi është një nga tre vendet që raporton normë negative të migracionit neto për vitin 2017, por EUROSTAT thekson se kjo tendencë është shumë më e lartë në Shqipëri, me një migracion neto prej -5.2 për 1000 banorë, e ndjekur nga Kosova me rreth -3 për 1000 banorë dhe Mali i Zi me më pak se -2 . Për Turqinë norma neto e

migracionit ishte pozitive (1.6 për 1000 banorë), ndërsa për Maqedoninë, Bosnjën dhe Serbinë, flukset migratore pothuajse nuk kanë ndryshuar.

Figura 2. Ndryshimi i popullsisë, 2007 dhe 2017 (për 1000 banorë).




Note: ranked on the rate of total population change in 2017.

Burimi: EUROSTAT

1.1.4. Emigracioni shqiptar në shifra

Sipas të dhënave të INSTAT nga 1990-2020, numri i emigrantëve jashtë vendit ka arritur në 1.684 milionë persona, ose 59% e popullsisë banuese në vend, që sot janë 2,854,191, sipas EUROSTAT. Në total, sipas të dhënave të shqyrtuara janë rreth 4.5 milionë shtetas shqiptarë dhe rreth 37.4% e tyre jetojnë jashtë vendit. Të dhënat e publikuara nga INSTAT tregojnë se nga viti 2011, kur raportohen për herë të parë të dhënat, deri në 2020-ën, janë larguar nga vendi 423.7 mijë persona (emigrantë). Për të njëjtën periudhë janë kthyer 242.8 mijë imigrantë, duke bërë që migracioni neto për këtë periudhë të jetë -181 mijë persona. Të dhënat zyrtare të INSTAT tregojnë se gjatë vitit 2020, edhe pse në kushtet e kufizimeve ekstreme në lëvizje nga pandemia Covid-19, u larguan nga vendi 23,854 persona dhe u rikthyen vetëm 7170 persona, duke bërë që emigracioni neto (diferenca ndërmjet të larguarve dhe të kthyerve në vend) të ishte 16,684 persona.

Figura 3. Të larguarit nga vendi, të kthyerit dhe migracioni neto, 2011-2020.




Burimi: INSTAT (2021)

1.1.5. Pasojat që lë emigracioni në forcën e punës

Emigracioni po ndikon për keq cilësinë e popullatës në Shqipëri. INSTAT raportoi se popullsia në moshë pune 15-64 vjeç u tkurr me 16.2 mijë persona në raport me janarin 2020 ose me 0.8%. Por rënia më e fortë ishte në grupet e reja, ku popullsia në grupmoshën 15-29 vjeç shënoi tkurrje më të madhe me rreth 18 mijë persona. Reduktimi në grupet më të reja të popullsisë në moshë lidhet me dy faktorë themelorë: rënia drastike e lindjeve pas vitit 2000 dhe niveli i lartë i emigracionit në moshat e reja. Rënia e popullsisë po ushtron presion tek forca e punës, e cila është në një cikël tkurrës pa kthim për shkak të lindshmërisë së ulët, por emigracioni i lartë e ka përkeqësuar më shumë këtë trend.

Figura 4. Ndryshimi vjetor i popullsisë në moshë pune, sipas grupmoshës 15-64 vjeç, 1 janar 2021.



Burimi: INSTAT (2021)

2. RËNDËSIA E REMITANCAVE NË EKONOMI

2.1. REMITANCAT NË EKONOMITË NË ZHVILLIM

2.1.1. Roli i përgjithshëm i remitancave

Ngushtësisht të lidhura me emigracionin janë remitancat – para apo të mira të dërguara nga emigrantët pranë familjarëve të tyre në atdhe. Emigrimi ka kontribuar që remitancat të bëhen një burim kryesor i të ardhurave për shumë familje shqiptare dhe për ekonominë kombëtare. Roli i remitancave në promovimin e zhvillimit ekonomik ka marrë një vëmendje të madhe gjatë viteve të fundit (Worldbank, 2006). Një konsensus në zhvillim thotë që remitancat shërbejnë për të ulur varfërinë, por mund të përkeqësojnë pabarazinë e të ardhurave në përgjithësi. Ato duket se zvogëlojnë pjesëmarrjen e forcës së punës, veçanërisht në mesin e grave, por edhe për të rritur aktivitetin sipërmarrës (Ozden dhe Schiff, 2007). León-ledesma dhe Piracha (2004) kanë zbuluar në mënyrë të ngjashme se remitancat rrisin investimet, punësimin dhe produktivitetin në vendet postkomuniste të Evropës Lindore.

2.1.2. Përcaktuesit e remitancave

Në përgjithësi, niveli i përgjithshëm i remitancave në një vend emigracioni përcaktohet nga faktorë të tillë si numri i emigrantëve në familje, të ardhurat e tyre, prirja e tyre për të kursyer, shkalla e papunësisë, stimujt e siguruar nga vendet e emigracionit në mënyrë që të maksimizojnë fluksin e dërgesave, si dhe ato joekonomike siç është statusi i familjes së tyre. Sipas Funkhouser (1995), emigranti do të dërgojë sasinë e parave në familjen e tij/saj që barazon dobinë marxhinale nga një rritje e konsumit nga marrësit me dobinë margjinale të humbur nga ulja e konsumit të vetë emigrantit. Në përgjithësi, sa më të larta të jenë të ardhurat e emigrantit jashtë vendit (të krijuara nga statusi i punës dhe përvoja) dhe sa më e fortë të jetë marrëdhënia e emigrantit me ata që mbeten prapa, aq më i lartë do të jetë niveli i dërgesave të parave. Por nga ana tjetër, ka vlera të shpeshta zero ku emigrantët nuk dërgojnë fonde në shtëpi.

2.1.3. Efektet e remitancave në Shqipëri

Qindra mijëra familje, në të gjitha rajonet e vendit, kanë qenë në gjendje të dalin nga varfëria falë, pjesërisht ose tërësisht, shtimit të dërgesave të parave në buxhetin e familjes. Por ndikimi nuk ka qenë krejtësisht përfitues ose joproblematik.

→ Efektet në tregun shqiptar të punës

Nëse koha e lirë është një e mirë normale, pjesëmarrja në forcën e punës të anëtarëve të mbetur të shtëpisë mund të zvogëlohet për shkak të rritjes së të ardhurave të familjes që vijnë nga remitancat. Rezultatet e studimit

sugjerojnë që pjesëmarrja në fuqinë punëtore e burrave nuk ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga ekzistenca e emigrantëve nga familja ose sasia e dërgesave të marra. Rritja e dërgesave të parave, megjithatë, i bën gratë dukshëm më pak të rrezikuara për të punuar (Konica dhe Filer 2009).

→ **Efektet në sektorët e industrisë**

Remitancat, përgjithësisht, kanë luajtur një rol të madh në financimin e importeve dhe kanë mbështetur zhvillimin e shpejtë të sektorëve të ndërtimit dhe shërbimeve. Ndikimi në sektorët bazë të prodhimit - bujqësia dhe industria - ka qenë shumë më i vogël. Si rezultat, remitancat kanë qenë mekanizmi kryesor që çoi në ekstremin e ekonomisë shqiptare, që do të thotë se konsumi i brendshëm tejkalon shumë kapacitetin e prodhimit kombëtar për të përmbushur nevojat e popullsisë. (Gedeshi and J. G. Ditter, 2000)

→ **Efektet në kursin real të këmbimit**

Ka shumë studime që mbështesin argumentin se një rritje në hyrjet e dërgesave të emigrantëve shkakton një vlerësim të kursit real të këmbimit dhe përfundimisht, një humbje të aftësisë konkurruese të eksporteve të vendit. Duke analizuar monedhën shqiptare, mund të themi se Leku është mbiçmuar ndjeshëm në 15 vitet e fundit. Rritja e dërgesave të emigrantëve rrit sasinë e monedhës së huaj që hyn në tregun valutor për t'u këmbyer me Lek, duke rritur kërkesën e këtij të fundit. Me një monedhë shqiptare më të fortë blihen më pak mallra në tregun shqiptar nga emigrantët duke dekurajuar remitancat gjë që ul kërkesën për Lek në tregun valutor (Leskaj & Kotorri, 2011). Deficiti i llogarisë rrjedhëse të vendit ka qenë shumë më i vogël se ai i tregtisë, pikërisht për shkak të pranisë së remitancave (Germenji, 2005). Sipas Égert (2009), remitancat mund të ndikojnë në kursin e këmbimit nëpërmjet efekteve neto të huaja, nëpërmjet efekteve të kërkesës në shërbime (nëse nuk shpenzohen për konsum sesa investime) dhe nëpërmjet rritjes ekonomike.

→ **Efektet pozitive**

Remitancat janë të qëndrueshme dhe kundërciklike për ekonominë pranuese. Ato ofrojnë një mekanizëm ndërkombëtar për ndarjen e rrezikut, lehtësojnë kostot e autonomisë së politikës monetare të humbur dhe rrjedhimisht, rrisin qëndrueshmërinë e një kursi fiks të këmbimit. Ato mbështesin të ardhurat e familjes, mbrojnë ekonominë në zhvillim nga efektet anësore të globalizimit dhe janë gjithashtu një formë sigurimi për vendet në zhvillim kundër goditjeve ekzogjene. Remitancat janë "të pakthyeshme", që do të thotë se ato nuk rezultojnë në kërkesa për aktivet, detyrimet e shërbimit të borxhit ose detyrime të tjera kontraktuale. Për më tepër, ato mund t'i merren një vendi ex post pa shkaktuar pasiguri të

shtëpisë ose paqëndrueshmëri të të ardhurave, siç bëjnë investimet e huaja (Singer, 2010).

2.2. IMPAKTI I REMITANCAVE NË RRIJTJEN EKONOMIKE

Dërgesat e emigrantëve shqyrtohen si një faktor i mundshëm furnizimi për rritjen ekonomike në kuptimin që ato mund të sigurojnë burime (në valutë) për financimin e investimeve në vendet e emigrimit. Problemi kryesor është se dërgesat e emigrantëve vendosen nga personat që i marrin ato, domethënë të afërmit e emigrantëve. Nëse dërgesat e parave shpenzohen për konsum ato vështirë se mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik. Për më tepër, ato mund të kenë një efekt negativ në bilancin e pagesave nëse financojnë kryesisht importet duke krijuar kështu një efekt “bumerang” (Nikas dhe King, 2005).

2.2.1. Ndikimi i remitancave në rritjen ekonomike

Ekzistojnë mendime të ndryshme mbi ndikimin e dërgesave të emigrantëve në rritjen ekonomike. Ndër vite, shumë studime janë kryer për të vërtetuar lidhjen negative apo pozitive të remitancave me rritjen ekonomike në vendet me ekonomi në zhvillim.

→ Ndikim pozitiv

Ka mjaft dëshmi empirike që remitancat kontribuojnë në rritjen ekonomike, përmes ndikimit të tyre pozitiv në konsum, kursime ose investime. Në këtë drejtim, Adams dhe Page; Acosta et al. dhe Banka Botërore argumentoi se dërgesat e emigrantëve ndikojnë pozitivisht në bilancin e pagesave në shumë vende në zhvillim, si dhe rrisin rritjen ekonomike, nëpërmjet implikimeve të tyre të drejtpërdrejta për kursimet dhe investimet në kapitalin njerëzor dhe fizik dhe efektet indirekte përmes konsumit (Meyer & Shera, 2017).

Ratha (2003) arrin në përfundimin se dërgesat e emigrantëve rrisin nivelin e konsumit të familjeve rurale, të cilat mund të kenë efekte thelbësore të shumëzuara, sepse ato kanë më shumë gjasa të shpenzohen në mallra të prodhuara në vend. Giuliano dhe Ruiz-Arranz kishin punuar në grupin e të dhënave prej më shumë se 100 vendeve në zhvillim nga vitet 1975–2002 dhe zbuluan se dërgesat e emigrantëve mund të rrisin rritjen ekonomike vetëm në vendet më pak të zhvilluara financiarisht.

→ Ndikim negativ

Lipton, Ahlburg dhe Broën argumentuan se dërgesat e emigrantëve minojnë produktivitetin dhe rritjen në vendet me të ardhura të ulëta, sepse ato shpenzohen lehtësisht për konsum që ka të ngjarë të dominohen nga mallrat e huaja sesa në investimet prodhuese.

Sidoqoftë, Barajas et al., vuri në dukje se sa më shumë të jetë e integruar një ekonomi me tregjet financiare botërore dhe sa më i zhvilluar të jetë sistemi financiar vendas, aq më pak ka të ngjarë që të ardhurat nga remitancat të stimulojnë investimet duke lehtësuar kufizimet e kredisë. Për më tepër që një studim i kryer nga Glytsos për të hetuar ndikimin e dërgesave të emigrantëve në konsum, investime, importe dhe prodhim për tetë vende, përfshirë Algjerinë, Egjiptin, Greqinë, Jordaninë, Marokun, Portugalinë, Sirinë dhe Tunizinë për periudhën 1969–1998, vuri në dukje se efekti i rritjes së dërgesave të emigrantëve është i pjesshëm dhe në disa vite vërehet ndikimi negativ i remitancave në rritje.

Chami dhe Jahjah zbuluan se dërgesat e emigrantëve kanë ndikim negativ në rritjen e të ardhurave për frymë. Studimi raportoi tre fakte të stilizuara: *së pari*, se një "pjesë e konsiderueshme, dhe shpesh shumica" e dërgesave të emigrantëve shpenzohen për konsum; *së dyti*, që një pjesë më e vogël e fondeve të remitancave shkojnë për kursime ose investime; dhe *së treti*, mënyrat në të cilat remitancat zakonisht ruhen ose investohen - në strehim, tokë dhe bizhuteri - "nuk janë domosdoshmërisht produktive" për ekonominë në tërësi (Meyer & Shera, 2017).

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë punim për të vlerësuar ndikimin e remitancave tek rritja ekonomike është modeli i regresionit linear të shumëfishtë. Përdorimi i kësaj teknike statistikore na ndihmon për të modeluar lidhjen ndërmjet disa variablave shpjegues të cilët i quajmë ndryshe të pavarur dhe një variabli të varur. Në model janë përdorur të dhëna vjetore, seri kohore të të gjithë variablave të marrë në studim, për një periudhë nga viti 1996 deri 2020, pra numri i vëzhgimeve është 25. Për hulumtimin e këtij punimi janë shfrytëzuar burime sekondare dhe të dhënat, në lidhje me të gjithë variablat e modelit, janë të aksesueshme online dhe janë mbledhur nga publikimet e të dhënave të Bankës Botërore "World Development Indicators". Për marrjen e rezultateve është përdorur software statistikor SPSS statistics 20.0.

Ndërtimi i modelit ekonometrik është bazuar në punimin e Meyer dhe Shera (2017) për ndikimin e remitancave në rritjen ekonomike. Ky studim (Meyer & Shera, 2017) ka vëzhguar ndikimet e dërgesave të emigrantëve në rritjen ekonomike, duke përdorur grupin e të dhënave të panelit të gjashtë vendeve me remitanca të larta, si: Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Moldavia, Rumania dhe Bosnjë -Hercegovina gjatë periudhës 1999–2013. Prioriteti i këtij punimi është të analizojë, nëse dhe si, niveli i

remitancave në Shqipëri mund të japë efekt në rritjen ekonomike, prandaj për këtë qëllim më poshtë jepet modeli minimal i rritjes ekonomike si një mjet për të treguar lidhjet ndërmjet variablave:

$$GDP = \beta_0 + \beta_1 P_TRANSF + \beta_2 GSCAP_F + \mu$$

Rritja ekonomike, e matur si PBB për frymë (GDP), shprehur në US\$ (dollar amerikan), është variabli i varur, ndërkohë që variablat e pavarur (X_i) janë Transfertat personale në milion US\$³ (P_TRANSF), të cilat përfaqësojnë dërgesat e emigrantëve dhe Formimi bruto i kapitalit fiks në milion US\$ (GSCAP_F), e përdorur si një përfaqësues për investime në kapitalin fizik. β_0 dhe μ janë përkatësisht intercepti i modelit dhe termi i gabimit.

3.1. REZULTATET EMPIRIKE TË ANALIZËS

3.1.1. Statistika përshkruese

Statistikat përshkruese të të dhënave për variablat e modelit ekonometrik na japin një tregues të vlerave tipike të zgjedhjes sonë.

Tabela 1. Statistika përshkruese të variablave.

Variablat	N	Mesatarja	Devijimi standard
PBB për frymë	25	3183.52	1590.63
Transfertat personale	25	974.39	363.21
Formimi bruto i kapitalit fiks	25	2651.14	1198.27

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS (2021).

Siç vihet re nga tabela e mësipërme, N=25; që do të thotë, se për të gjithë variablat e vlerësuar, të dhënat janë të disponueshme në të gjithë shtrirjen kohore nga 1996-2020, pra nuk kemi të bëjmë me mungesa të dhënash në asnjë prej viteve të marra në studim. Të paraqitura në tabelë janë edhe mesataret e secilës prej variablave, si dhe devijimet standarde përkatëse.

³ Të dhënat rreth variablave shpjegues originalisht janë marrë, nga databaza statistikore e BB, të shprehura në 1 njësi të US\$, por për lehtësi studimi ato janë konvertuar në milion US\$.

Sipas analizës përshkruese rezultoi se përgjatë periudhës kohore nga 1996 deri 2020, rritja ekonomike ishte mesatarisht rreth 3183.52 US\$ për frymë, transfertat personale ishin mesatarisht rreth 974.39 milion US\$ dhe formimi bruto i kapitalit fiks, për Shqipërinë, ishte mesatarisht rreth 2651.14 milion US\$.

3.1.2. Modeli i regresionit të shumëfishtë

Software “SPSS statistics”na ndihmon që të përcaktojmë lidhjen që ekziston mes variablave të marrë në studim. Disa versione të ekuacionit (1) janë testuar në mënyrë që të merret një model i cili jep rezultate të fuqishme dhe i përshtatet më së miri të dhënave. Rezultatet e nxjerra të këtij modeli paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. Vlerësimi i lidhjes së rritjes ekonomike me remitancat dhe tregues të tjerë.

Variablat	Koeficientët	Gabimi standard	p (Sig.)
Konstantja	747.588	429.461	0.096
P_TRANSF	-3.689	1.468	0.020
GSCAP_F	2.275	0.445	0.000
Numri i vëzhgimeve	25		
R	0.921		
R²	0.849		
R² i rregulluar	0.835		

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS (2021)

Nga analiza e modelit linear të regresionit dyvariabëlsh, vëmë re se koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 , matës i madhësisë së përshtatjes së të dhënave, na tregon se 84.9% e variacionit të rritjes ekonomike shpjegohet nga variablat e zgjedhur si shpjegues (P_TRANSF dhe GSCAP_F), një vlerë mjaft e lartë duke marrë parasysh që treguesi R^2 merr vlera nga 0 në 1.

Për të provuar vlefshmërinë e modelit të regresionit dyvariabëlsh, duhet të përdoret një test global që hulumton nëse të gjithë variablat e pavarur kanë

koeficientë regresioni të barabartë me 0. Ngrehmë hipotezat për të vlerësuar rëndësinë e modelit sipas tabelës ANOVA.

H_0 = Modeli është jo i rëndësishëm statistikisht (koeficientët janë të gjithë të barabartë me zero).

H_1 = Modeli është i rëndësishëm statistikisht (ekziston të paktën një koeficient i ndryshëm nga zero)

Për të testuar hipotezën e pavlefshme i drejtohem testit F. Sipas tabelës ANOVA shohim se $F_{\text{vrojtuar}} = \text{MSS e ESS} / \text{MSS e RSS}$ është 61.730 e krahasuar me F_{kritike} me alfa 0.05 dhe shkallë lirie $k-1 = 3$ dhe $n-k = 21$ (ku k është numri i parametrave në ekuacion, që duhen vlerësuar) në tabelë është një vlerë e caktuar, shihet në tabelat përkatëse të statistikës.

Nqs $F_{\text{vrojtuar}} > F_{\text{kritike}}$ atëherë H_0 bie poshtë dhe pranohet hipoteza alternative H_1 . Nga tabela përkatëse e statistikës për shpërndarjen e Fisherit, shohim se $F_{\text{kritike}}(3,21) = 3.07$, që do të thotë $61.730 > 3.07$, pra modeli është i rëndësishëm statistikisht, ekziston të paktën një koeficient në ekuacionin tonë që i jep rëndësinë e duhur modelit.

Ose një mënyrë tjetër është: N.q.s. p (sig.) e statistikës $F < \alpha$ (alfa) atëherë H_0 hidhet poshtë. Shohim që vlera p është $0.000001 < 0.05$ që është alfa, pra mund të themi plotësisht që hipoteza H_1 qëndron dhe modeli është statistikisht i rëndësishëm.

Nga tabela e gjeneruar nga SPSS në bazë të të dhënave tona, mund të shkruajmë ekuacionin:

$$\text{GDP} = 747.588 - 3.689 \text{ P_TRANSF} + 2.275 \text{ GSCAP_F} \quad (1)$$

Në bazë të ekuacionit mund të bëjmë disa parashikime dhe shpjegojmë:

Intercepti i modelit i barabartë me 747.588 na tregon se nëse të gjithë variablat shpjegues (Transfertat personale dhe Formimi i kapitalit fiks bruto) janë zero në një moment të caktuar kohe, atëherë do të kishim një rritje ekonomike për frymë prej 747.588 njësi (US\$).

Koeficienti i P_TRANSF na tregon se nëse Transfertat personale rriten me 1 njësi (1 milion US\$), në kushtet kur Formimi bruto i kapitalit fiks mbetet konstant, atëherë si rezultat rritja ekonomike do të ulej me 3.689 njësi (US\$ për frymë).

Koeficienti i GSCAP_F na tregon se me ndikimin e Transfertave personale të mbajtur konstant, një rritje me 1 njësi (1 milion US\$) të Formimit bruto të kapitalit fiks, na rezulton se rritja ekonomike do të rritej me 2.275 njësi (US\$ për frymë).

Koeficienti i korrelacionit, R, prej 0.921 ka tendencë drejt 1, që tregon që modeli i vlerësuar i regresionit për afron shumë mirë të dhënat e vëzhgimit, me besueshmëri të lartë.

Këto parashikime bëhen në bazë të ekuacionit, tani do përpiqemi të përcaktojmë për secilin nga variablat e pavarur, individualisht, nëse është i rëndësishëm statistikisht ose jo.

Fillimisht ngrejmë hipotezat:

H₀: $\beta_1 = 0$ variabli P_TRANSF është jo i rëndësishëm, pra themi se nuk është shpjegues për variablin rritja ekonomike.

H_a: $\beta_1 \neq 0$ variabli P_TRANSF është i rëndësishëm, pra themi se është shpjegues për variablin rritja ekonomike.

Nga tabela shohim që vlera p e P_TRANSF është $0.020 < 0.05$ (alfa), atëherë H₀ bie poshtë dhe qëndron hipoteza alternative, pra variabli P_TRANSF është i rëndësishëm statistikisht.

H₀: $\beta_2 = 0$ variabli GSCAP_F është jo i rëndësishëm, pra themi se nuk është shpjegues për variablin rritja ekonomike.

H_a: $\beta_2 \neq 0$ variabli GSCAP_F është i rëndësishëm, pra themi se është shpjegues për variablin rritja ekonomike.

Nga tabela shohim që vlera p e GSCAP_F është $0.000 < 0.05$ (alfa), atëherë H₀ bie poshtë dhe qëndron hipoteza alternative, pra variabli GSCAP_F është i rëndësishëm statistikisht.

Konkludojmë se të dy variablat shpjegues të përfshirë në model kanë rëndësi statistikore, pra modeli na rezulton i rëndësishëm.

Konkluzione

- ✓ Që nga viti 1990 emigrimi nga Shqipëria ka marrë përmasa epike. Shqiptarët, për shkak të mungesës relative të burimeve dhe mundësive brenda vendit, kanë udhëtuar dhe janë vendosur jashtë vendit për punë dhe jetesë.
- ✓ Për vitin 2020, INSTAT raportoi se grupmosha me tkurrjen më të madhe të popullsisë ishte 15-29 vjeç me rreth 18 mijë persona. Për më tepër, shifrat tregojnë se viteve të fundit fenomeni “Brain Drain” apo migrimi i personave më të kualifikuar ka shënuar një rritje të ndjeshme. Kjo ka bërë që bizneset në të gjithë vendin të ndiejnë vështirësitë që po krijon mungesa e punonjësve.
- ✓ Emigrimi ka kontribuar që remitancat të bëhen një burim kryesor i të ardhurave për shumë familje shqiptare dhe për ekonominë kombëtare. Kontributi i remitancave në rritjen ekonomike gjatë periudhës kohore të analizës, 2010-2017, vlerësohet mesatarisht në rreth 5.6% të nivelit të PBB-së së vendit. Kjo dëshmon për impaktin e rëndësishëm të këtyre flukseve në dinamikën dhe ekuilibrin makroekonomik në vend.

- ✓ Nga Analiza e Regresionit Linear dyvariabëlsh rezultoi se ka një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis “remitancave” dhe “rritjes ekonomike”, pra remitancat kanë ndikim në rritje. Rritja ekonomike shpjegohet në një masë 84.9% nga niveli i remitancave dhe formimi bruto i kapitalit fiks në Shqipëri.
- ✓ Koeficienti i vlerësuar i remitancave është statistikisht i rëndësishëm me një shenjë negative që do të thotë se remitancat zvogëlojnë rritjen ekonomike për Shqipërinë. Ky përfundim rezulton në përputhje me literaturën e rishikuar për arsytet se pse remitancat mund të kenë një ndikim negativ në rritjen e të ardhurave për frymë, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Rekomandime

1. Proceset bashkëkohore të globalizimit rrisin lëvizshmërinë dhe çojnë në procesin e "Brain Drain", mirëpo ky fakt duhet mësuar për të përmirësuar aktivitetin shkencor, politikën e migrimit dhe punësimit duke promovuar shndërrimin e këtij problemi në "qarkullimin e trurit", apo "Brain Gain", i cili kontribuon në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Krijimi i kushteve të favorshme për ardhjen e personelit të kualifikuar duhet të jetë një përparësi e shtetit (Julia et al 2014).
2. Një përfitim në drejtim të përfshirjes financiare. Duke pasur parasysh që familjet pritëse të remitancave janë relativisht më pak të përfshira në sektorin financiar, ofrimi i produkteve specifike financiare për këto kategori do të ndihmonte në zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë. Nëse kjo arrihet, përfitimet ekonomike rriten edhe më tej për shkak të efekteve multiplikative.
3. Kanalizimi i fluksit të remitancave përmes kanaleve joformale të dërgimit bën që kontributi në rritje i remitancave të vlerësohet më i ngushtë. Një fenomen i tillë ndikon në shmangien e kanaleve zyrtare të transferimit, duke nxitur dërgesa në formë fizike, të cilat ndikojnë në sasinë e parasë jashtë sistemit. Instancat përkatëse qeveritare duhet të marrin masa për formalizimin e kanaleve të transferimit dhe ngushtimin e hapësirave për dërgesa informale.

Referencat:

- AIIS. (2005). *Turning the Tide. Albanian Brain Drain*. Tirana
- Bayangos, V., & Jansen, K. (2011). *Remittances and competitiveness: The case of the Philippines*. *World Development*.39(10),pp.1834-1846.
- Begu, D. (2014). REMITANCAT. <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2346/>

- Beine, M., Docquier, F., & Rapoport, H. (2001). Brain drain and economic growth: theory and evidence. *Journal of development economics*, 64(1), 275-289.
- Bourdet, Y., & Falck, H. (2003). Emigrants' Remittances and Dutch Disease in Cape Verde, *International Economic Journal*, 20(3), pp. 267-284
- Carletto, C., Davis, B., Stampini, M., Trento, S., & Zezza, A. (2004). *Internal Mobility and International Migration in Albania*. ESA (FAO) Working Paper. No. 04-13.
- Corden, W. M. (1984). Booming sector and Dutch disease economics: survey and consolidation. *Oxford Economic Papers*, 36(3), 359-380.
- DeSoto, H., Gordon, P., Gedeshi, I., & Sinoimeri, Z. (2002). Poverty in Albania. A Qualitative Assessment. Technical Paper No. 520. Washington, DC: World Bank.
- Docquier, F., & Marfouk, A. (2006). International Migration by Educational Attainment (1990-2000), in Ozden, C. and M. Schiff (ed.) *International Migration, Remittances and the Brain Drain*. London: Palgrave-Macmillan.
- Égert, B. (2009). Dutch disease in former Soviet Union: Witch-hunting?
- EUROSTAT. (2021). *Population change - Demographic balance and crude rates at national level*. Eurostat.
- Funkhouser, E. (1995). "Remittances from International Migration: A Comparison of El Salvador and Nicaragua," *The Review of Economics and Statistics*, 77, 137-146.
- GEDESHI, I., & DITTER, J. G. (2000). Dix ans de transition économique albanaise de l'autarcie à l'extraversion: L'Albanie: Dix ans après. *CEMOTI. Cahiers d'études sur la Méditerranée orientale et le monde turco-iranien*, (29), 121-138.
- Germenji, E. (2005, February). Summary of the session on the remittances and productive investments in Albania. In: *IOM, Workshop on the National Strategy for Migration* (pp. 21-22)
- GERMENJI, E. (2008). Highly Skilled Migration from Albania: An Assessment of Current Trends and the Ways Ahead ETLEVA GERMENJI* and ILIR GEDESHI*** Katholieke Universiteit Leuven, Belgium.
- Holzner, M. (2006). *Real exchange rate distortion in Southeast Europe* (No. 068). wiiw Balkan Observatory Working Papers.
- Hoxha, B. (2020). Emigracioni neto, 424 mijë të ikur nga vendi për 2011-2020, sa janë kthyer. *Revista Monitor*.
- INSTAT, UNFPA, & UN Women. (2014, October). *Perspektiva Gjinore në Shqipëri, Analiza gjinore Census 2011*. INSTAT.
http://www.instat.gov.al/media/2332/perspektiva_gjinore_n_shqip_ri.pdf
- INSTAT. (2020). *Diaspora e Shqipërisë në Shifra*. INSTAT.
- INSTAT. (2021). *Popullsia me 1 Janar 2021*.
- Julia, K., Ricaud, C., Anastasia, K., & Zhao, Y. (2014). Current trends of realization of the intellectual capital and problems of intellectual migration. *Procedia Economics and Finance*, 14, 326-332.
- Kapur, D and McHale, J (2005) 'Give Us Your Best and Brightest: The Global Hunt for Talent and Its Impact of the Development World'. Washington, DC: Center for Global Development.
- Konica, N., & Filer, R. K. (2009). Albanian emigration: Causes and consequences. *South-Eastern Europe journal of economics*, 7(1), 75-98.
- León-Ledesma, M., & Piracha, M. (2004). International migration and the role of remittances in Eastern Europe. *International Migration*, 42(4), 65-83.

- Leskaj, B., & Kotorri, A. (2011). *Paraaja dhe Banka. Cikël leksionesh*, Tiranë (pp. 118-119)
- Lopez, H., Bussolo, M., & Molina, L. (2007). Remittances and the real exchange rate. *World Bank Policy Research Working Paper*, (4213).
- MacMillen, M. J. (1982). The economic effects of international migration: a survey, *Journal of Common Market Studies*, 20(3), 1982, pp. 245 – 267 (pp. 262 – 266).
- Meyer, D., & Shera, A. (2017). The impact of remittances on economic growth: An econometric model. *Economia*, 18(2), 147-155.
- Nikas, C., & Blouchoutzi, A. (2014). Emigrants' remittances and the "Dutch Disease" in small transition economies: the case of Albania and Moldova. *Revista Română de Statistică*, 1(1), 45-65.
- Nikas, C., & King, R. (2005). Economic growth through remittances: lessons from the Greek experience of the 1960s applicable to the Albanian case. *Journal of Southern Europe and the Balkans Online*, 7(2), 235-257
- Özden, Ç., & Schiff, M. (2007). *International migration, economic development and policy*. Washington, DC: World Bank and Palgrave Macmillan.
<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/6766>
- Ratha, D. (2003). Workers' remittances: an important and stable source of external development finance. *Global development finance*.
- Ratha, D. (2004). Enhancing the Developmental Effect of Workers' Remittances to Developing Countries, *Global Development Finance: 169-173*. Washington DC: World Bank.
- Singer, D. A. (2010). Migrant remittances and exchange rate regimes in the developing world. *American Political Science Review*, 104(2), 307-323.
- United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Population Division. (2017). *Trends in International Migrant Stock: The 2017 Revision* (United Nations database, POP/DB/MIG/Stock/Rev.2017).
- World Bank. (2006). *Global Economic Prospects 2006: Economic Implications of Remittances and Migration*, Washington, DC: The World Bank.
- <https://euronews.al/al/programs/2020/12/01/18-mije-studente-shqiptare-neper-bote-94-nuk-duan-te-kthehen-ne-vend/>
- <https://www.monitor.al/anketa-e-madhe-me-studentet-79-duan-te-emigrojne/>
- <https://www.monitor.al/anketa-e-madhe-me-studentet-79-duan-te-emigrojne/>
- https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Remitancat_Revista_11930.pdf
- <https://euronews.al/al/programs/2020/11/10/emigrantet-shqiptare-sjellin-rreth-1-1-miliarde-dollare-cdo-vit/>
- <https://top-channel.tv/2021/06/11/emigrantet-sollen-169-milione-euro-nga-janari-deri-ne-mars-17-milione-euro-me-shume-se-nje-vit-me-pare/>
- <https://www.monitor.al/shifrat-e-eurostat-shqiperia-me-tkurrjen-me-te-madhe-te-popullsise-nga-emigracioni-ne-rajon/>
- <https://euronews.al/al/programs/2020/11/10/shqiperia-me-diasporen-me-te-madhe-ne-bote-57-e-shqiptareve-jetojne-jashte-vendit/>

KRIPTOMONEDHAT NË SHQIPËRI NJOHJA DHE PËRDORIMI I MONEDHAVE DIGJITALE NË VENDIN TONË

Kleida Tufi Heta¹, Gersa Ruqi²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financës,
Financë-Bankë⁶*

ABSTRAKT

Aktualisht jemi duke përjetuar pikun e zhvillimit të teknologjisë. Zhvillimi i teknologjisë ka prekur të gjitha aspektet e jetës së njeriut, duke përmendur këtu edhe sistemin e pagesave. Njerëzit kanë krijuar një treg të monedhave dixhitale, i cili po zhvillohet çdo ditë e më shumë. Në shumë vende të botës kriptomonedhat po përdoren si mjet pagese për mallra apo shërbime të ndryshme. Po Shqipëria, duke qenë një vend me ekonomi në zhvillim, sa

¹ *Kleida TUFİ HETA* është pedagoge me kohë të plotë pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” që nga viti 2005. Ajo jep mësim në lëndët Baza Finance, Financë Ndërkombëtare në ciklin e parë të studimeve dhe Drejtim Financiar, Drejtim Portofoli e Modelim Financiar në ciklin e dytë të studimeve. Ajo gjithashtu ka dhënë mësim lëndën Corporate Finance në Butler University, IN, USA (2012) dhe International Finance në Sandhills Community College, NC, USA (2014).

Ajo është diplomuar në degën Financë-Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës (2005) dhe ka përfunduar studimet për Master Shkencor në Financë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomisë (2008). Në 2016 merr gradën Doktor Shkencash në fushën e ekonomisë në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu”. Janar-maj 2009 është specializuar për mësimdhënie dhe kërkim shkencor në fushën e financës dhe ekonomisë në Butler University, IN, USA (në bazë të programit JFDP).

Ajo është pjesëmarrëse në mjaft konferenca brenda dhe jashtë vendit si dhe autore e disa botimeve shkencore. Ka kryer trajnime të vazhdueshme (si në Massaryk University (2018), Brno, Çeki; Universita degli studi Guglielmo Marconi, Rome, Itali (2018); Universiteti i Beogradit (2019) etj. dhe që nga 2010 mban edhe titullin Kontabël i Miratuar.

² *Gersa Ruqi* është diplomuar me rezultate të shkëlqyera në programin bachelor Financë-Kontabilitet pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (2019) dhe Master shkencor në Financë-Bankë (2021). Ka spikatur si një studente mjaft aktive dhe e përfshirë në projekte e konkurse të ndryshme gjatë ciklit të parë e të dytë të studimeve.

është koherente në lidhje me këtë zhvillim të ri të sistemit të pagesave në botë?

Ky punim synon të studiojë se sa njihen kriptomonedhat në Shqipëri. Analiza e studimit mbështetet në krijimin dhe shpërndarjen e një pyetësoi online mbi kriptomonedhat, në individë të ndryshëm. Përpos realizimit dhe analizimit të pyetësorit, ndër të tjera, studimi synon të analizojë se si përdorimi i monedhave dixhitale do të ndikojë në sistemin e pagesave në vend dhe në ekonominë e vendit në tërësi.

Pas kërkimeve të realizuara për këtë studim, u arrit në përfundimin se aktualisht, Bitcoin po përdoret në Shqipëri. Studimi paraqet dhe informacione mbi kriptomonedhën e parë shqiptare si dhe synon të paraqesë situatën ekonomike në Shqipëri në lidhje me një perspektivë të ardhshme të zhvillimit të tregut të kriptomonedhave në vend. Ky studim do të jetë një ndihmë për studiuesit e ardhshëm të kriptomonedhave, përtej teorisë.

Fjalë kyçe: Kriptomonedha, rrjeti peer to peer, kriptografi, Bitcoin, blockchain, mining.

Cryptocurrencies in Albania awareness and usage of digital currencies in our country

ABSTRACT

We are currently experiencing the peak of technology development. Technology evolution has affected all aspects of the human life, including the payment system. People have created a digital currency market, which is developing every day, more and more. In many countries in the world, cryptocurrencies are being used as a payment for various goods or services. What about Albania, a country with a developing economy, how is it adopting this new form of the payment system?

This paper is aiming to study how much are cryptocurrencies known in Albania. The analysis of this study is based on an online questionnaire about cryptocurrencies, to different individuals. Among other things, in addition to conducting and analyzing the questionnaire, this study is going to analyze how the process of adopting digital currencies will affect the payment system in our country's economy.

Results showed that Bitcoin is operating in Albania. This study is going to present also the first Albanian cryptocurrency. In general, this thesis is

analysing the economic situation in Albania, in relation to a tangible situation in the near future, and it will serve the future researchers to study the process of adopting cryptocurrencies, beyond simple theory.

Keywords: Cryptocurrencies, peer to peer network, cryptography, Bitcoin, blockchain, mining.

I. Hyrje

Shpeshherë në studimin e literaturave teorike gjatë ciklit studimor, jemi hasur me analizën e zhvillimit në kohë të parasë, si funksion i kryerjes së pagesave; duke nisur që nga kohët e hershme ku pagesat bëheshin nga shkëmbimi mall me mall e deri në etapën e fundit të monedhave digjitale. Duke e parë këtë, si një evolucion drejt së ardhmes, shumë prej nesh, e kemi anashkaluar dhe nuk e kemi kuptuar që aktualisht po jetojmë në etapën e zëvendësimit të parasë me monedhat digjitale, që njihen ndryshe si kriptomonedha.

Kriptomonedhat janë një formë digjitale e parasë, të krijuara nga individë privatë, të cilat nuk janë të garantuara nga organet ligjore apo autoritare. Ato konsiderohen si një pasuri financiare, pronësia dhe transfertat e pronësisë të të cilave, garantohet nga një teknologji e decentralizuar kriptografike. Infrastruktura e funksionimit të një kriptomonedhe, është një sistem elektronik pagesash i decentralizuar, i cili është i disponueshëm për publikun dhe i rregulluar nga një protokoll elektronik i hartuar privatisht, që ndryshe quhet *blockchain*. Pranimi i këtij protokollit rregullator elektronik nga ana e agjentëve, të cilët operojnë infrastrukturën, rregullohet nga motive financiare që garanton vetë protokollin për përdoruesit. Ndër këto motive mund të përmendim të ardhurat financiare për agjentët operues të sistemit dhe dobishmërinë e përdorimit të këtij sistemi pagesash për individët.

Ekzistojnë dy pikëpamje në lidhje me fenomenin e kriptomonedhave; e para është besimi se i gjithë ky zhvillim i tregut të kriptomonedhave është vetëm një “flluskë” e momentit dhe një mashtrim; dhe nga pikëpamja tjetër kemi të bëjmë me një teknologji të decentralizuar *blockchain*, si një inovacion i rëndësishëm që do të rezultojë në shndërrimin e disa prej këtyre monedhave në asete të qëndrueshme me vlerë.

Sot, kriptomonedhat po zënë gjithnjë e më shumë një vend të rëndësishëm në ekonomi. Ndërsa tregu në rritje i tyre ka potencialin të revolucionarizojë mënyrën se si paratë shkëmbehen, përfshirja e tyre në vendet globale është

e mbushur me sfida dhe gracka të mundshme. Duke qenë se monedhat virtuale nuk njihen zyrtarisht si mjete të pagesës së mallrave dhe shërbimeve, zhvillimi i sistemeve të standardizuara për përdorimin e tyre është kritik. Që monedhat të jenë të qëndrueshme, duhet të përcaktohet statusi i tyre ligjor. Aktualisht sistemet rregullatore janë në rritje, me qasje të panumërta që janë ndërmarrë nga qeveri të ndryshme. Masat aktuale rregullatore janë në fillimet e tyre dhe vazhdojnë të zhvillohen më tej me zgjerimin e kësaj industrie.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është të studiojë dhe analizojë zhvillimin dhe adoptimin e teknologjisë së re të një sistemi të decentralizuar, pra kriptomonedhave, në Shqipëri.

Pyetje kërkimore:

- Sa njihen kriptomonedhat në Shqipëri?
- Në çfarë mase dhe në çfarë mënyre përdoret ky treg i kriptomonedhave në vendin tonë?
- Sa besim kanë shqiptarët në zhvillimin dhe adoptimin e këtij tregu në vend?
- Çfarë qëndrimi kanë mbajtur autoritetet në lidhje me këtë teknologji?
- A është populli shqiptar në dijeni të kriptomonedhës së parë shqiptare, Albcoin?

Për përmbushjen e qëllimit të këtij studimi janë formuluar objektivat e mëposhtme:

- ♦ Të paraqesë një analizë të përgjithshme të tregut të kriptomonedhave aktualisht.
- ♦ Të identifikojë masën në të cilën individët shqiptarë janë njohur dhe adoptuar me tregun e kriptomonedhave në përgjithësi si dhe kriptomonedhën shqiptare në veçanti.
- ♦ Të tregojë masat e marra nga organet ligjore mbi legalizimin e tregut të kriptomonedhave në vend.

II. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për të realizuar këtë studim është pyetësori. Popullata që përfshihet në këtë pyetësor konsiston në çdo individ të panjohur, rastësor, të cilit i është mundësuar akses në plotësimin e pyetësorit, nëpërmjet shpërndarjes online, platformës Google Form. Këto

individë, janë targetuar si njohës dhe përdorues të teknologjisë, duke qenë se dhe tema e trajtuar në këtë studim lidhet drejtpërdrejt me njohjen e teknologjisë. Ky pyetësor është shpërndarë nëpërmjet një linku, i cili kryesisht ka targetuar kryesisht individë banues në zonën e Shkodrës, Tiranës dhe Durrësit. Pyetësi është plotësuar nga 458 individë në total, gjatë një periudhe kohore 2- mujore, maj-qershor 2021. Analiza e këtyre të dhënave konsiston në një analizë përshkruese, për të kuptuar në aspektin e përgjithshëm se sa njihen kriptomonedhat në vendin tonë.

Gjithashtu për të realizuar këtë studim, është ndërmarrë një burim të dhënash sekondare nga Statista dhe Coindesk, dy web-faqe të cilat merren me përshkrimin e statistikave të ecurisë së tregut të kriptomonedhave si dhe një intervistë e realizuar me një nga pjesëtarët stafit të menaxhimit të projektit të kriptomonedhës së parë shqiptare, Albcoin. Rezultatet e kësaj interviste janë kryesisht të dhëna rreth ideimit dhe ecurisë së projektit të kriptomonedhës Albcoin.


III. Rezultatet e analizës së zhvillimit të kriptomonedhave

Blockchain, një listë të dhënash të regjistruara që përdorin kriptografinë për të ndërvepruar me njëra-tjetrin dhe përmbajnë të dhëna transaksionale, është një teknologji që ka zënë një vend të rëndësishëm në botën e biznesit. Të dhënat e *blockchain* kanë për qëllim të jenë rezistente ndaj modifikimit dhe veprojnë si një regjistër i sigurt i transaksioneve. Popullariteti gjithnjë e më rritje i kësaj teknologjie, ka bërë që të rriten shpenzimet si dhe investimet e kompanive në lidhje me adoptimin e saj. Shpenzimi për adoptim dhe zhvillim të teknologjisë *blockchain*, në botë, pritet të rritet nga 4.5 miliardë dollarë në vitin 2020 në rreth 19 miliardë dollarë deri në vitin 2024, sipas Statista (maj 2021)³. Në 2018 **EOS**, një infrastrukturë e sistemit të decentralizuar të *blockchain* që mundëson zhvillimin e aplikacioneve të decentralizuara, gjeneroi një investim prej 4.2 miliardë dollarësh amerikanë në ofrimin e monedhës fillestare (ICO), duke e bërë atë ICO-në më të madhe të *blockchain* deri më tani.

Në grafikun e mëposhtëm kemi të paraqitur investimet në kompanitë *blockchain*, në miliardë dollarë amerikanë, në rang të kompanive amerikane dhe atyre globale.

³ Blockchain - Statistics & Facts (Maj 2021) - <https://www.statista.com/topics/5122/blockchain/>

Figura 3-1. Investimet mbi kompanitë Blockchain, në SHBA dhe në rang global.



Burimi: Statista, 2020

Një përdorim i madh i teknologjisë *blockchain* që ka tërhequr vëmendjen më të madhe janë kriptomonedhat, ku më i njohuri ndër to është Bitcoin. Që nga tremujori i parë i vitit 2021, *blockchain* i **Bitcoin** ishte me madhësi rreth 330 gigabyte dhe tregu i Bitcoin kapi mbi një trilion dollarë amerikanë në të njëjtën kohë (Statista 2021). Megjithatë Bitcoin është pa dyshim monedha digjitale më e njohur, kriptomonedhat e tjera të tilla si Ethereum dhe Ripple (XRP), gjithashtu kanë zënë pjesë të konsiderueshme të tregut.

Një rikujtesë e pasigurive që rrethon industrinë e kriptomonedhave janë dhe rastet e **mashtimeve**. Banka qendrore e Turqisë kohët e fundit ndaloi përdorimin e kriptomonedhave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, pasi **Thodex**, një shkëmbim kriptomonedhash turke doli jashtë funksioni (offline) dhe CEO i saj u zhduk, duke lënë mijëra investitorë të shqetësuar se fondet e tyre janë vjedhur. Në platformë justifikojë një mbyllje e përkohshme, duke adresuar një "luhatje anormale në llogaritë e kompanisë", por ndërkohë, themeluesi i Thodex ka fluturuar në Shqipëri, duke marrë me vete 2 miliardë dollarë të fondeve të investitorëve. Ky rast mashtrimi në tregun e kriptomonedhave, dhe të tjerë, i bën investitorët që të humbin besimin në sigurinë e këtij sistemi teknologjic.

Më tej në analizën e të dhënave primare kemi rezultatet në vijim. Pyetësi është plotësuar gjithsej nga 458 individë të ndryshëm, gjatë një periudhe kohore 2- mujore, maj-qershor 2021, ku ndër to mbizotëron mosha **21-25 vjeç** (65.9% të të anketuarëve), **niveli arsimor i lartë** (40.8%) dhe **master** (40.2%), dhe fakulteti i studimit **Ekonomik** (38.2%) dhe **Shkenca natyrore** (11.8%).

Metoda e mbledhjes së të dhënave është nëpërmjet këtij pyetësi i cili është i ndarë në katër sesione. **Sesioni i parë** konsiston në studimin se sa

njihen kriptomonedhat në Shqipëri ku rezulton se 90% ose ndryshe 412 individë e të anketuarëve janë njohur me termin “kriptomonedhë” apo “monedhë digjitale”, një përqindje e konsiderueshme e cila tregon se individët shqiptarë janë koherentë me termat. Pjesa më e madhe e të anketuarëve, prej 33.6% apo 154 individë, janë përgjigjur se janë njohur me kriptomonedhat nga postimet në mediat sociale (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube), një rezultat ky i pritshëm duke qenë se mediat sociale zënë pjesën më të fuqishme të reklamimit në këto kohë, nisur nga zhvillimi mëse i avancuar i teknologjisë. Në vijim, 22.9% e tyre (105 individë) rezultojnë të kenë dëgjuar për kriptomonedhat në TV, në programe të ndryshme televizive apo lajme, duke qenë se muajt e fundit, zhvillimi masiv i tregut të kriptomonedhave nuk ka mbetur pa u trajtuar dhe nga mediat televizive në Shqipëri. Në fund të këtij sesioni të anketuarit pyeten nëse janë në dijeni të funksioneve që ka një kriptomonedhë dhe kemi një rezultat të konsiderueshëm prej 18.3% të cilët përgjigjen se nuk e dinë se çfarë funksioni ka një kriptomonedhë dhe 33% të cilët përgjigjen se nuk janë të sigurt për mënyrën se si funksionon një kriptomonedhë, rezultat ky që na tregon se një pjesë e konsiderueshme e popullit shqiptar janë të njohur me kriptomonedhat, por vetëm në aspektin e njohjes së termit dhe jo qëllimit të krijimit të tyre apo funksionit të tyre. **Sesioni i dytë** fokusohet në nivelin e përdorimit të kriptomonedhave në vend: ku rezulton se 90% e të anketuarëve rezulton se nuk kanë investuar ndonjëherë në kriptomonedha duke argumentuar se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë shumë informacion për mënyrën se si funksionojnë, për të mirat dhe rreziqet e investimit mbi to; e të tjerë që mendojnë se kriptomonedhat janë një investim riskoz, nuk kanë të ardhura të lira të cilat mund t'i përdorin në investime, nuk i shohin kriptomonedhat si një opsion i mirë investimi etj. Më tej, rezultatet e pyetjes se cila kriptomonedhë i duket të anketuarëve si mundësia më e mirë e investimit, pjesa më e madhe e tyre shprehen se nuk janë në dijeni, duke na treguar një mungesë informacioni ndaj kriptomonedhave dhe zhvillimit të secilës prej tyre; dhe 37.3% e të anketuarëve zgjedhin Bitcoin, nisur nga fakti se është dhe kriptomonedha me kapitalizim tregu më të madh. **Sesioni i tretë** konsiston në analizën e besimit që kanë shqiptarët në zhvillimin e kriptomonedhave i cili ndahet në dy aspekte:

1. Fakti që kriptomonedhat nuk janë aset fizik, janë monedha virtuale, të paprekshme.
2. Fakti që kriptomonedhat nuk janë të rregulluara dhe garantuara nga ana ligjore nga autoritetet përkatëse.

Nga ky sesion na rezulton se të anketuarit i frikëson më shumë fakti se kriptomonedhat nuk janë të rregulluara dhe të garantuara nga shteti, sesa fakti që kriptomonedhat nuk janë monedha fizike të prekshme. **Sesioni i katërt** i cili studion se sa njihet kriptomonedha e parë shqiptare Albcoin, rezulton se kemi një përqindje të konsiderueshme të të anketuarëve, 61.8% të cilët shprehen se nuk janë në dijeni se ekziston një kriptomonedhë autentike shqiptare; dhe 34.3% e të anketuarëve të cilët shprehen se e kanë dëgjuar se është krijuar një kriptomonedhë shqiptare, por nuk kanë shumë informacion mbi të. Në fund të këtij sesioni të anketuarit vendosen përballë një zgjedhjeje, duke u pyetur nëse do të ndiheshin më të sigurtë në blerjen dhe mbajtjen e një kriptomonedhe të huaj apo në blerjen dhe mbajtjen e kriptomonedhës shqiptare, Albcoin. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 274 të anketuar nga 458 gjithsej dhe përgjigjet kanë qenë kryesisht më të larta në investimin dhe mbajtjen e një kriptomonedhe të huaj në raport me atë shqiptare.

Në lidhje me rregullimin e tregut të kriptomonedhave në vendin tonë, në Shqipëri është botuar në Fletoren Zyrtare, ligji “*Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë*”⁴, i cili legjitimon kriptomonedhat. Në këtë mënyrë, Shqipëria, bëhet një nga të paktat vende të Evropës që legalizon dhe rregullon kuadrin ligjor për monedhat virtuale. Projektligji adreson çështje që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, duke kërkuar nga çdo titullar licencë-krijimin e një sistemi të sigurt dhe të mbrojtur nga risqet, për të monitoruar transaksionet në përputhje me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, nëpërmjet hartimit të politikave për parandalimin e pastrimit të parave dhe angazhimit të punonjësve me përvojën e duhur për raportimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave. Ndalimet dhe kërkesat që parashikohen në këtë ligj zbatohen mbi të gjitha veprimet e cילו personi juridik ose fizik, të cilat përbëjnë abuzim tregu në lidhje me tokenët dixhitalë/monedhat virtuale.

Raporti i fundit i “Moneyval”⁵ ka vërejtur se nuk është bërë asnjë përmirësim në drejtim të pastrimit të parave në Shqipëri. Sipas raportit të fundit të publikuar, asetet virtuale dhe kazinotë, vazhdojnë të mbeten vende me risk të lartë për zhvillimin e këtij aktiviteti në vendin tonë.

Tregu i monedhave virtuale në Shqipëri mendohet të jetë sa gjysma e buxhetit të shtetit, afro 2 miliardë euro, e cila do të thotë që mesatarisht nga

⁴ Ligji nr. 66/2020, datë 21.05.2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë".

⁵ The Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering Measures and the Financing of Terrorism, Council of Europe - MONEYVAL

28% e të ardhurave kombëtare (buxheti i shtetit), gati 15 % e Prodhimit të Brendshëm Bruto, është sektor informal, sipas Selami Xhepa⁶, në një intervistë për Top Story.

Aktualisht, në disa faqe zyrtare shit-blerje në Shqipëri, individë të ndryshëm shesin pajisjet e prodhimit të Bitcoin, apo i këmbejnë me pajisje të tjera. Ndërkohë ka edhe faqe të tjera informuese, të cilat paraqesin benefitet e pranimit të këtij tregu, në kontekstin e përfitimeve ekonomike për shtetin.

Sipas burimeve anonime, për Top Story, aprovohet se qyteti që ka prodhimin më të madh të bitcoin dhe kriptomonedhave të tjera, është **Durrësi**, duke qenë se ka më tepër mundësi për ndërtesa të lira, gjithashtu edhe **Malësia e Madhe**, ku tunelet e ushtrisë përdoren si ferma për mbajtjen e aparaturave të prodhimit, në mënyrë që ftohja e tyre të bëhet në mënyrë natyrale, pa rritur kostot e energjisë elektrike. Të njëjtat burime konfirmojnë se prodhuesi më i madh në Shqipëri është një person i afërt me një politikan të rëndësishëm dhe se 30% e prodhuesve janë drejtorë të OSHEE, të cilët kanë akses në energji elektrike.

Sistemet e decentralizuara të pagesave, apo teknologjia *BlockChain* që qëndron pas kriptomonedhave ka adhuruesit e saj edhe në Shqipëri dhe Kosovë. Në të dyja vendet janë krijuar tashmë monedhat e para dixhitale të quajtura **AlbCoin (ALBC)** dhe **KosovaCoin**. Në një intervistë të siguruar me një nga të pjesëtarët e stafit në menaxhimin e rrjetit të kriptomonedhës ALBC, ai shprehet se krijuesit, të cilët kanë preferuar të mbeten anonim, kanë punuar për tre vite me radhë që të krijojnë dhe hedhin në treg këtë monedhë. Sipas krijuesve, shprehet ai, për të krijuar një kriptomonedhë, nuk mjafton vetëm ndërlidhja midis aftësive të programimit të sistemeve të regjistruara të shpërndarë dhe njohja e sistemeve ekonomike, por duhet dhe një kapital i konsiderueshëm financiar, i cili shërben si garanci vlere për projektin, në mënyrë që edhe vetë kriptomonedha të ketë një vlerë të sajën në treg.

Albcoin është përfshirë në tregun e kriptomonedhave në dhjetor të vitit të kaluar dhe është hedhur në treg me një kapital fillestar të investuar. Pra, që në hedhjen e saj në treg, kjo kriptomonedhë ka pasur çmimin 0.19\$. Në grafikun më poshtë shohim dhe ecurinë mujore të çmimit të kriptomonedhës.

⁶ Selami Xhepa- Ekspert Ekonomie UET.

Figura 3-2 Ecuria mujore e çmimit të Albcoin.

Burimi: *Blockspot.io (qershor 2021)*

Aktualisht kjo kriptomonedhë po hedh hapa të vegjël dhe të sigurt në zhvillimin e saj, pa bërë shumë bujë. Strategjia fillestare e saj është që të ndihmojë shqiptarët në zhvillimin e një sistemi të ri pagesash, por kjo nuk përjashton të huajt nga blerja dhe përdorimi i kësaj kriptomonedhe.

IV. Përfundime

Mbështetur në analizën e të dhënave mund të themi se individët shqiptarë nuk janë shumë optimistë mbi të ardhmen e zhvillimit dhe adoptimit të kriptomonedhave, sepse vetëm 15% e të anketuarëve janë shprehur se kanë besim në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kriptomonedhave. Pjesa tjetër janë të ndikuar kryesisht nga fakti që kriptomonedhat nuk janë të garantuara nga shteti dhe kjo i bën që ato të humbasin vlerën në besimin e tyre.

Tregu i kriptomonedhave po zhvillohet dhe përparon çdo ditë e më shumë, prandaj dhe shumë vende në botë kanë pranuar të adoptojnë dhe të përshtasin teknologjinë e kriptomonedhave në sistemin e tyre të ekonomisë, si. p.sh.: Mbretëria e Bashkuar, Singapori, Indonezia, Kanada, Filipina, Zvicra, Gjermania, Australia, Holanda, Tajlanda, Korea e Jugut (Mondaq, mars 2021). Edhe vendi ynë ka ndërmarrë hapat e parë të përfshirjes së kësaj teknologjie në ekonomi, duke botuar në Fletoren Zyrtare, ligjin “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”. Kriptomonedha Albcoin është kriptomonedha e parë autentike shqiptare, e krijuar nga individë shqiptarë të cilët duan të ndihmojnë vendin e tyre në përshtatjen e kësaj teknologjie të re. Kjo kriptomonedhë është e mirëprojektuar, pasi është krijuar në rrjetin Ethereum, nga ku merr sigurinë

dhe garancinë e transaksioneve të saj. Duke qenë se krijuesit e saj kanë vite që punojnë në krijimin e këtij projekti, ato nuk dëshirojnë që t'i bëjnë një reklamim masiv kësaj kriptomonedhe, në mënyrë që të mos krijohet një "fluskë" momentale, ku më pas çmimi i saj të bjerë dhe njerëzit të humbasin besimin në Albcoin. Kjo është dhe arsyeja që shumica e të anketuarëve kanë rezultuar se nuk e njohin këtë kriptomonedhë, dhe për më tepër nuk kanë besim në zhvillimin e saj, duke qenë se dhe mungesa e informacionit për të është e ndjeshme.

REFERENCA

- Albcoin (Qershor 2021), The First Albanian Cryptocurrency, Faqja zyrtare e Albcoin, marrë nga web: <https://albcoin.org/>
- Baur, Aaron W. (2015), "Cryptocurrencies as a Disruption? Empirical Findings on User Adoption and Future Potential of Bitcoin and Co", Conference paper.
- Chiu J, Bank of Canada & Victoria University of Wellington (Prill 2017), "The Economics of Cryptocurrencies– Bitcoin and Beyond", Bank of Canada Working Paper.
- CoinMarketCap (24 Maj 2021), "Today's Cryptocurrency Prices by Market Cap", marrë nga web: <https://coinmarketcap.com/>
- Ergocun G. & Cicek D. (Prill 2021), "Turkey opens probe into cryptocurrency platform Thodex", Anadolu Agency, marrë nga web: <https://www.aa.com.tr/en/economy/turkey-opens-probe-into-cryptocurrency-platform-thodex/2216920>
- Farrell, R. (2015), "An Analysis of the Cryptocurrency Industry", Wharton Research Scholars, University of Pennsylvania.
- Giancarlo Giudici, Alistair Milne & Dmitri Vinogradov (Shtator 2019), "Cryptocurrencies: market analysis and perspectives", Journal of Industrial and Business Economics.
- Kapoor, R. (2016), "Regulating the Bitcoin Ecosystem", Delft University of Technology, Master Thesis.
- Kuvendi i Shqipërisë (Ligji Nr. 66/2020 në datën 1 shtator 2020), Për Tregjet Financiare të Bazuar në Teknologjinë e Regjistruar të Shpërndarë, Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare.
- Law, I. (Mars 2021), "Worldwide: Global Cryptocurrency Regulatory Landscape", Mondaq, marrë nga web: <https://www.mondaq.com/india/fin-tech/1044546/global-cryptocurrency-regulatory-landscape>
- Liu Y, Tsyvinski A, Xi Wu (Maj 2019), "Common Risk Factors in Cryptocurrency", National Bureau of Economic Research.
- McConnell, K. (2015), "Best Practice for Bitcoins - Regulatory, Legal and Financial Approaches to Virtual Currencies in a Hesitant, Global Environment", Master thesis.
- Mensah, E. (Qershor 2020), "Financially Ever After: A Thesis on Cryptocurrency and the Global Financial Economy", Research paper, marrë nga web: <https://ssrn.com/abstract=3640175>

- Muça, Rudina (Janar 2021) “Ekskluzive – Po pastrohen para me Bitcoin/ Politikanë dhe kriminelë po i përdorin në Shqipëri”, Intervistë nga Top Channel, marrë nga web: <https://top-channel.tv/2021/01/28/ekskluzive-po-pastrohen-para-me-bitcoin-politikane-dhe-kriminele-po-i-perdorin-ne-shqiperi/>
- Nakamoto, S. (2008), “Bitcoin: A Peer-to-Peer Electronic Cash System”, Bitcoin.org.
- Sotiropoulou, A. & Dominique Guegan (2017), "Bitcoin and the challenges for financial regulation", Panthéon-Sorbonne University (Post-Print and Working Papers).
- Spengelink, H. (2014), “The adoption process of cryptocurrencies”, University of Twente, Master Thesis.
- Top Story (prodhues), Habilaj E. (autor) (Mars 23, 2021), “Bitcoin në Shqipëri”- Si po pastrohen paratë e drogës, nëpërmjet monedhave virtuale”, dokumentar i Top Channel, marrë nga web: <https://www.youtube.com/watch?v=khzbB--Hd4I>
- Walton, J. (2014), “Cryptocurrency Public Policy Analysis”, Research paper, marrë nga web: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2708302

ISSN 2411 - 4960

*Doli nga shtypi maj, 2022– tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*